



FAKULTETI JURIDIK

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

**”EFEKTËT JURIDIKE QË SHKAKTOHEN NGA VONESA E
DEBITORIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË, NË THEKS
TË VEÇANTË NË TERRITORIN E GJYKATËS THEMELORE
NË GOSTIVAR NGA VITI 2015 E KËNDEJ”**

Mentori :
Prof. dr. ADNAN JASHARI

Kandidati:
VJOLLCA ZENDELI

TETOVË, 2018

PËRMBAJTJA

HYRJJE.....	5
--------------------	----------

<u>KREU I</u>	<u>7</u>
----------------------------	-----------------

I.NË PËRGJITHËSI PËR DETYRIMET.....	7
--	----------

1 Kuptimi.....	7
2.Karakteristikat.....	11
2.1.Detyrimet si marrdhënie me karakter juridik.....	12
2.2.Detyrimet si marrdhënie me përmbajtje të caktuar.....	12
2.3.Detyrimet si marrdhënie me karakter pasuror.....	12
2.4.Detyrimet si marrdhënie me karakter relativ.....	13
2.5.Detyrimet si marrdhënie midis subjektëve të caktuara.....	13
3.Vetitë e detyrimëve të plotfuqishme.....	13
4.Klasifikimi i detyrimëve.....	15
5.Shuarja e detyrimëve.....	22

<u>KREU II.....</u>	<u>50</u>
----------------------------	------------------

II.EFEKTET E DETYRIMËVE.....	50
-------------------------------------	-----------

1.Kuptimi.....	50
2.Shkaktimi i efektëve kur detyrimi çënohet nga kreditori.....	51
3.Shkakimi i efektëve kur detyrimi çënohet nga debitori.....	52
4.Padia pauliana.....	52
4.1.Kuptimi.....	52
4.2.Zhvillimi historik.....	54
4.3.Veprimet që mund të kundërshtohen.....	54
4.4.Palët.....	55
5.E drejta e ndaljes.....	56
5.1.Kuptimi.....	56
5.2.Kushtet.....	56
5.3.Efektet.....	56

KREU III.....57

III NË PËRGITHËSI PËR VONESËN E DEBITORIT.....57

1.Kuptimi.....	57
2.Karakteristikat.....	59
2.1.Detyra e debitorit duhet të arrijë pë përmbushje.....	59
2.2.Kreditori duhet të paraqes vëretje.....	59
2.3.faji i debitorit.....	59
3.Pasojat nga vonesa e debitorit.....	60
3.1.Pagesa e kamatës.....	60
3.2.Kthimi i frytëve.....	61
3.3.Rezikui humbjes së sendit.....	61
3.4.Shpërblimi i dëmit.....	61
4.Shuarja e vonesës së debitorit.....	64
4.1.Shuarja me përmbushje.....	65
4.2.Shuarja me zgjatjen e afatit për përmbushje.....	73
4.3.Shuarja me tërheqjen e vëretjes së paraqitur debitorit.....	73

KREU IV.....75

IV. EFEKTET JURIDIKE TË SHKAKTUARA NGA VONESA E DEBITORIT NË BAZË TË VENDIMËVE TË ANALIZUARA NË TERRITORIN E GOSTIVARIT.....75

1.Analiza e vendimëve të shqiptuara në vitin 2015.....	75
2.Analiza e vendimëve të shqiptuara në vitin 2016.....	75
3.Analiza e vendimëve të shqiptuara në vitin 2017.....	75

PËRFUNDIMET.....82

LITERATURA.....84

BURIMET TJERA/ BURIMET NGA INTERNETI.....85

Shkurtesat:

LMD - Ligji për Marrëdhënie e Detyrimeve

LMD I RM-së - Ligji për Marrëdhënie e Detyrimëve të Republikës së Maqedonisë

LMD I KS-së - Ligji për Marrëdhënie e Detyrimëve të Republikës së Kosovës

LMD I SH - Ligji për Marrëdhënie e Detyrimëve të Republikës së Shqipërisë

KC - Kodi Civil.

KCSH - Kodi Civil i Shqipërisë.

HYRJE

E drejta e detyrimëve përfshin një lëmi të gjërë të së drejtës, nga e cila dalin të drejtat dhe detyrimët për pjesëmarësit në ato marrëdhënie. Ku si pasojë e mospermbushjes së tyre krijohen efektet juridike nga vonesa e palëve. Andaj në këtë punim hulumtues kamë bërë elaburimin e këtyre çështjeve, duke e ndarë këtë punim në katër kapituj, ku çdo njëri prej tyre shqyrton çështje të caktuara në korniza të kësaj teme.

Kreu i parë përmban çështjet e përgjithshme të detyrimëve, duke filluar nga kuptimi edhe atë nga zanafilla e detyrimëve nga e Drejta Romake, recipimi në Kodet Civile, emertimi, mendimet rrethë detyrimëve, duke vazhduar me karakteristikat e detyrimëve, si marrëdhënie me karakter juridik, me përmbatje të caktuar, me karakter pasuror, midis subjektëve të caktuar. Duke vazhduar me klasifikimi e detyrimëve të paraqitura në këtë ndarje: sipas karakterit juridik ku dallojmë: detyrime civile dhe natyrale, sipas lëndës së ekzekutimit dallojmë detyrime pozitive dhe negative, sipas asaj se a dorezohet sasi e caktuar parash a sendesh të caktuara dallojmë: detyrime ne para dhe jo ne para, sipas saktësisë së detyrimit dallojmë: detyrime individuale dhe gjenetike, sipas shumëllojshmërisë së lëndës dallojmë: detyrime kumulative, alternative dhe fakultative, sipas shumëllojshmërisë së subjektëve dallojmë: detyrime të përkohshme suksesive, dhe me pretime të përhershme, sipas asaj se cili subjekt e ekzekuton detyrimin dallojmë: detyrime thjesht personal dhe jopersonale. Dhe në fund të kreut të parë kamë paraqit mënyren e shuarjes së detyrimëve, të cilat janë: mënyra vullnetare e shuarje së detyrimëve, në këtë ndarje hynë: shuarja e detyrimëve me permbushje(pagesa), me kompensim, me faljen e borxhit, me përtërirje, me konfondim. Mënyrat e shuarjes së detyrimëve kundra vullnetit të subjektëve kemi këtë ndarje: shuarja e detyrimëve përshkak të pamundësisë për permbushje, me kalimin e kohës, me denoncim, me vdekjen e debitorit ose kreditorit dhe me parashkrim.

Në kreun e dytë kamë parapar efektet e detyrimëve, kuptimin, shkaktimin e efektëve kur detyrimi cënohet nga kreditori, dhe debitori, më tej kamë bërë përshkrimin e padisë e cila shërben për kundërshtimin e veprimeve ligjore: padia pauliana, kuptimi, zhvillimi historik i saj si dhe veprimet që mund të kundërshtohen. Duke e perfunduar këtë kapitull me të drejtën e ndaljes, kuptimi, efektet që krijon kjo e drejtë si dhe kushtet për permbushje.

Ndërsa kreu i tretë përmban material për vonesën e debitorit në përgjithësi, kuptimi, kushtet që çojnë debitorin në vonesë duke filluar nga detyra e debitorit të arrijë për permbushje, kreditori të paraqes vëretje, si the debitori të jetë fajtor. Duke vazhduar me pasojat që krijohen nga vonesa e debitorit të cilat janë: pagesa e kamatës, kthimi i frytëve, rreziku i humbjes së sendit, dhe shperblimi i demit. Duke e përfunduar këtë kapitull me shuarjen e vonesës së debitorit, si shuarja para afatit për permbushje, si dhe me tërheqjen e vëretjes së paraqitur debitorit.

Dhe në kreun e fundit, kamë bërë hulumtimin e efekteve të shkaktuara nga vonesa e debitorit në bazë të vendimeve të analizuara në teritorin e Gostivarit, edhe atë analiza e vendimeve të shqyrtuara në vitin 2015-2017. Situatat gjyqësore ku kreditori ka paralajmëru dhe nuk e ka paralajmëruar debitorin, të drejtat e kreditorit nga vonesa e debitorit, ku jamë fokusuar në disa çështje të caktuara edhe atë: sa është numri që kanë bërë pages të borxhit në tërësi, me kamat ligjore dhe shpenzimet e procedurës,sa është numri që kanë bërë pages të borxhit në tërësi, ku shpenzimet e procedurës i kanë paguar secila pal vet, sa është numri që kanë bërë pages me këste, plus kamata ligjore ,plus shpenzimet e procedurës, më tej pages me këste pa kamat ligjore, pages në këste sipas dakordimit të palëve, sa është numri në ato raste ku ka pas tërheqje të padis përshkat të kompetencës së gjykatës, përshkak të mos ekzistimit të firmës në regjistrin tregtar, sa është numri i rateve gjyqësore në rastet e mos prezencës së debitorit ose të kreditorit në seancat gjyqësore, mos prezenca e asnjërës pal në gjykat, më tej kamë paraqit numrin e vendimeve gjyqësore në të cilat ka pas munges të informacionit bazë,rastet ku ka pas tërheqje të padis përshkak të përseritjes së procedurës, mos pages të taksave gjyqësore. Pik tjetër e hulumtimit është: personat pjesëmarrës në ato vendime gjyqësore, pra sa është numri i vendimeve gjyqësore ku padisë është person juridik dhe i padituri është person juridik, sa është numri i vendimeve gjyqësore ku paditës është person juridik ndërsa i padituri person fizik, sa është numri i vendimeve gjyqësore ku paditës është person fizik dhe i padituri person fizik, dhe sa është numri i vendimeve gjyqësore ku paditës është person fizik ndërsa i padituri person juridik.

KREU I

I.NË PËRGJITHËSI PËR DETYRIMET

1. KUPTIMI

E drejta obligatore romake është trashëgimi më i rëndësishëm dhe më i përsosur juridik i Romës dhe përpunim i saktë i të gjitha marrëdhënieve esenciale midis pronarëve të zakonshëm të mallit: shitjes dhe blerjes, huapërdorjes, huasë, kontratës dhe detyrimëve tjera. Për shkak të këtyre cilësive e drejta obligatore romake, edhe pse në formë diçka të ndryshuar e të plotësuar, është recipuar në Kodin Civil Frëng dhe në kodet e tjera borgjeze të tipit kontinental. E drejta obligatore romake është pjesë e së drejtës pronësore (Jus quod res pertinent) që vepron inter vivos.

Për nga cilësia e përmendur, e drejta obligatore nuk dallonte nga e drejta reale, pasi edhe e drejta reale është pjesë e së drejtës pronësore që vepron inter vivos. Në bazë të dispozitave të së drejtës reale, konstituohet pushteti i drejtëpërdrejt i titullarëve të autorizimëve realo-juridike mbi sendet, kurse për shkak të ekzistimit të detyrimit të të gjithëve që ta respektoj autorizimin e konstituuar realo-juridik, edhe pushteti indirekt mbi të gjithë personat. Dispozitat e të drejtës obligatore shërbejnë për qarkullimin e pasurisë krahas me bashkëpunimin aktiv të personave të detyruar.

Në bazë të dispozitave të së drejtës obligatore u konstituua pushteti aktiv i kreditorëve mbi debitorët: kreditorët kanë të drejtë që prej debitorëve të kërkojnë vlera pasurore. Cilësia e të drejtës obligatore që të veprojnë vetëm midis personave ose palëve të caktuara saktë theksohet si veprim inter partes, prandaj e drejta obligatore rregullon marrëdhëniet pronësore inter vivos, që veprojnë inter partes dhe që shfaqen si jus in persona aktivë ose si e drejtë e kreditorëve që të kërkojnë veprime pronësore nga debitorët e caktuar saktë.¹

Nga burimet e së drejtës romake janë dy definicione për kuptimin e detyrimëve. Njëri nga autori anonim që gjendet në Institucionet e Justinianit ku është thënë: "Detyrimi është lidhja juridike në bazë të së cilës, sipas të drejtës sonë civile jemi të detyruar diçka të paguajmë". Ky përkufizim nuk është i plotë, sepse nisët nga ana e kreditorin, kurse sikundër dihet në detyrim është edhe debitori si dhe fakti se në detyrim ai gjithnjë duhet të paguajë nuk është i saktë, sepse ka raste kur detyrimi krijohet edhe duke mos dhënë kundërvlerë për atë çka kemi marrë. Definicioni i dytë për detyrimin është nga kazuisti i dalluar Paulus i cili ka thënë: "Esenca e detyrimit nuk është në atë që neve dikush të na bëjë posedues ose të krijojë servitute: por që tjetrin ta obligoj ndaj nesh në ndonjë dhënie, bëje ose mosbërje". Mendimi i parë quhet: dualist, kurse mendimi i dytë quhet monist. Sipas mendimit dualist: në marrëdhëniet e detyrimit ekzistojnë dy lloje të marrëdhënieve juridike, që ju përgjigjen shprehjen "debitum" dhe "obligatio".

¹ Dr. Ivo Puhani, E Drejta Romake, botim i pestë, Prishtinë, 1989, fq. 282-283.

Marrëdhënia e parë ose elementi i parë "debitum" është detyrim i debitorit që të përmbush borxhin si dhe detyra e kreditorit që me kohë këtë veprim ta pranoj. Kurse elementi i dytë "obligatio" është përgjegjësia e debitorit nëqoftë se nuk përmbush borxhin e vet, pra cënon detyrimin e vet.

Ndërsa sipas mendimit monist: për kuptimin e detyrimëve, miret se detyrimi është marrëdhënie juridike midis debitorit dhe kreditorit në bazë të së cilës kreditori është i autorizuar që të kërkoj nga debitori diçka të dorëzoj, të bëjë, ose të mos bëj, ndërsa debitori duhet ti përmbahet kësaj.² Eksperienca e së drejtës private romake njih një gamë të gjerë të marrëdhënieve juridike të detyrimit. Termi më i përhapur, veçanërisht në të drejtën Justiniane, është ai "obligation".

Me detyrim kuptohet çdo marrëdhënie juridike në të cilën një subjekt (i quajtur debitor) është i detyruar kundrejt një subjekti tjetër (të quajtur kreditor) për të përmbushur një detyrim të caktuar, në rast mospërmbushjeje të të cilit ai përgjigjet me pasurinë e tij.

Detyrimi ka si funksion të sigurojë një subjekti (kreditorit) bashkëpunimin e një personi tjetër të pa varur prej tij (debitorit) për përmbushjen e një interesi të vet, kurse funksioni i të drejtave reale konsiston në qëllimin për të atribuar subjektëve përdorimin e pasurive pavarësisht nga bashkëpunimi i personave të tretë: në këtë dallim përse i përket funksionit qëndron dhe dallimi mes marrëdhënieve reale dhe marrëdhënieve të detyrimit.

Në periudhë arkaike, është e natyrshme që detyrimi, për shkak të egzistencës së një ekonomie bujqësore dhe blektorale të mbyllur, të bazuar në vetëmjaftueshmërinë e mjetëve të prodhimit të grupit familjar, problemet e jetës në marrëdhëniet mes njerëzve të gjenin zgjidhje në rregullat e veçanta juridike që kishin të benin me personat dhe sendet në familjet e veçanta dhe në varësinë ndaj personit i cili kishte pushtetin në familje, të përmbante një fenomen të rrallë dhe përjashtues i destinuar që të zhvillohet dora-dorës me supërimin e strukturës familjare dhe zhvillimin e marrëdhënieve tregtare.³

Termi "obligation" mundë të përdoret në dy kupime:

-Në kuptimin e gjërë: detyrimi paraqet marrëveshje juridike ndërmjet dy ose më shumë subjektëve, në mbështetje të cilëve një subjekt (kreditor) ka të dejtë të kërkojë prej subjektit tjetër (debitorit) që ai të kryej diçka ose të heqë dorë nga kryerja e ndonjë veprimi, të cilik ka të drejt ta bëjë.

-Në kuptimin e ngushtë: fjala detyrim do të thotë borxh-detyrë e debitorit, por shikuar nga aspekti i kreditorit, detyrimi do të thotë e drejtë për të kërkuar-kërkesë. Fjala detyrim përdoret për tu përcaktuar edhe me shkresë, me të cilën konstatohet se debitori ka detyrë të caktuar ndaj kreditorit. Në këtë kuptim detyrimi është: dëftesë për borxhin. Kjo dëftesë për borxhin shpesh quhet shkresë detyruese. Detyrime quhen edhe letrat me vlerë, letrat e prurësit, të cilat jepen me rastin e regjistrimit të huave publike.⁴

² Prof.dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimëve, botimi dytë, Prishtinë, 2002, fq. 39-40.

³ Prof. Ken Dhima, E Drejta Romake, botimi I parë, Titanë, 2007, fq. 586.

⁴ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 41.

Sipas Kodit Civil të Shqipërisë: detyrimi është marrëdhënie juridike, me atë të së cilës një person(debitori)detyrohet të japë diçka ose të kryej ose të mos kryejë një veprim të caktuar në dobi të personit tjetër(kreditorit), i cila ka gjithëashtu te drejtë të kërkoj ti jepet diçka ose te kryej os të mos kryehet veprimi,(neni 419 I KCSH).

Termi “obligation” i referohet zakonisht, në periudhën klasike, vetëm marrëdhëniet të detyrimit të njohura nga ius civile dhe vetëm në fundë të periudhës klasike shtrihet më tej për të treguar edhe marrëdhëniet e detyrimit të njohura nga e drejtë pretoriane. Edrejta e detyrimëve është pjesë e së drejtës pronësore(ius quod ad res pertinent) që vepron inter vivos. Juristët romakë e përcaktonin marrëdhënien e detyrimit si marrëdhënie midis kreditorit, i cili ishte i autorizuar të kërkonte dhënien e diçkaje, kryerjen apo mos kryerjen e ndonjë veprimi, debitori i cili me kërcënim sanksionesh të së drejtës së detyrimit ishte i detyruar ta plotësonte kërkesën e kreditorit.

Marrëdhëniet e detyrimit si marrëdhënie midis kreditorëve dhe debitorëve, në bazë të cilës kreditorë ishin të autorizuar, ndërsa debitorët të detyruar për ndonjë : dare ,facere apo non facere duhet të konstituohet patjetër me ndonjë fakt të rëndësishëm juridik, i cili sipas dispozitave juridike do të shërbente si shkak i krijimit ose si burim i marrëdhëniet të detyrimëve. Faktet më të shpeshta juridiko-relevante që shërbenin si burime të detyrimëve ishin kontrata dhe deliktet. Në çdo marrëdhënie detyrimi duhej të egzistonte tre elemente kryesore:

- Kreditori dhe debitori ose subjektet e marrëdhëniet të detyrimeve.
- Detyrimi i debitorit dhe e drejta e kreditorit për dare facere ,non facere dhe praestare.
- Fakti i rëndësishëm juridik që lind marrëdhënien e detyrimit.⁵

Në çdo marrëdhënie obligatore duhet të egzistoj patjetër subjektet e obligatës ose personat në dobi të të cilëve ishte konstituuar obligate. Personat në favor të të cilëve figuronin obligatat quheshin subjekte aktive të obligatave ose kreditor(reus credenda, reus stipulandi, creditor). Personat mbi të cilët binin ngarkimet obligatore quheshin debitor(reus debendi, reus promittendi, debitor).

Zotësinë e plotë aktive dhe passive obligatore e kishin qytetarë romak sui juris, që kishin zotësi veprimi. Zotësi aktive obligatore, zotësi për të qenë kreditor në marrëdhëniet obligatore, kishin edhe personat e mitursui juris, si dhe qytetarë tjerë pa zotësi veprimi. Zotësia pasive obligatore e personave pa zotësi veprimi rregullohej me dispozitat mbi tutorinë dhe kujdestarinë. Personat alie juris dhe skllëvërit janë trajtuar si vegla të vullnetit të atër familjasit. Në atë status mund të lidhnin të gjitha punë juridike të fitimit: *adquiratur nobis non solum per nosmet ipsos, sed etiam per eos, quos in potestate manu mancipiove habemus*, ose mund të ishin subjekte aktive të marrëdhëniet obligatore. Aktivitetet e këtyre personave i shërbenin drejtpërdrejtë atër familjasit i cili mbi ta ushtronte pushtetin atënor.

Në raste të veçanta , prej kohë së të drejtës klasike , personave alien juris dhe skllëvërve ju njoh edhe zotësia obligatore edhe aktive edhe passive që dihet edhe si:

- Actions adjecticiae, qualitatis,
- Actions noxales dhe
- Obligations naturals.⁶

Në periudhën qarkullimit të gjallë ekonomik përkatësisht nga fundi i republikës dhe fillim të principatës ,atër familjasit e bënë zakon që punët e rëndësishme tregtare ,bankiere dhe punë tjera ekonomike ti kryejnë me ndimën e personave alien juris dhe skllëvërve. Meqë personat

⁵ Prof. Ken Dhima, E Drejta Romake, botimi I parë, Tiranë, 2007, fq. 587.

⁶ Dr. Ivo Puhani, E Drejta Romake, botimi I pestë, Prishtinë, 1989, fq. 285-286.

alien iuris mund të kryenin veprime juridike të cilat shkaktonin fitim pa kurrfarë pengesash, patres familias me veprimtarinë e këtyre personave dhe skllëvërve mund të bëheshin “locupletiores” ose më të pasur , nuk mund të detyroheshin që ti paguajnë borxhet që kishin bërë ata vetë.

-Actiones adiecticiae qualitatis: ishin padit e dhena kreditorëve për aktivet e krijuara në bazë të kontratave të lidhura me personat alieni iuris dhe skllëvërit, të cilëve patres familias ua kishi besuar ose administrimin e lirëtë ndonjë pjese të pasurisë ose kryerjen e veprimëve juridike të përcaktuara sakt. Në disa actions adiecticiae, patres familias përgjigjeshin në shumën e plotë të detyrimëve të marra. Patres familias u përgjigjeshin kreditorëve të personave dhe të skllëvërve gjer në lartësinë e pasurisë së veçuar në bazë të të ashtuquajturave : action de peculino, action de in rem verso, action treitoria.

-Actio de peculino:shërbente për mbrojtjen e kreditorëve lidhur me veprimet juridike të lidhura me personat alieni iuris dhe me skllëvërit të cilët paterfamiljasi uakishte besuar peculium që atë ta administronin lirisht.Në administriminë e peculium, masë e veçuar të vlerave – personat alieni iuris dhe skllëvërit ishin të autorizuar që të lidhnin të gjitha veprimet juridike, me përjashtim të dhënjes së dhuratave.Actio de peculio mund të përdorë derinjë vit pas vdekjes ose liritimit të skllëvërit. Kur paguheshin borxhet sipas action de peculio, paterfamiljasi kishte ius retentionis , pra kishte të drejtë të zbriste aktivet që i kishte vetë ndaj peculium.

-Actio de in rem : shërbente për mbrojtjen e kreditorëve që kishin hyrë në marrëdhëniet juridike me personat alieni iuris dhe me skllëvërit, të cilëve nuk iu ishte besuar peculium.

-Actio tributoria : përdorej për mbrojtjen e kreditorëve të cilët kishin lidhur marrëdhënie juridike me personat alieni iuris dhe me skllëvërit , nëse personat alieni iuris dhe skllëvërit me dijeninë e paterfamiljasit drejtonin ndonjë dyqan tregtar apo zejtar.Gjerë në shumën e plotë të detyrimëve të mara nga patres familias u përgjigjeshin kreditorëve të personave alieni iuris dhe skllëvërve në bazë të të ashtuquajturave: action exercit, actio institoria, actio quod iussu.

-Actio exercitoria: shërbente për mbrojtjen e kreditorëve në veprimet juridike të lidhura me personat alieni iuris dhe skllëvërve, të cilëve paterfamiljasi ua kishte besuar komanden e ndonjë anijeje dhe ushtrimin e të gjitha punëve në lundrim dhe tregtinë tej detare.

-Actio institoria: lindte përgjegjësinë e pakufizuar të paterfamiljasit. Institori ishte personi i cili sipas urdhërit dhe në emër të paterfamiljasit drejtonte ndonjë ndërmarrje tregtare, zejtare,bankiere etj. Duke caktuar institorin apo kryepunëtorin, paterfamiljai e autorizonte që të lidhte të gjitha punët juridike që ishin të domësdoshme për punë e drejt të ndarjes.

-Actio quod iussu: shërbente për mbrojtjen e kreditorëve që kishin hyrë në ndonjë veprim juridik me personat alieni iuris ose me skllëvërit në bazë të urdhërit kategorik të paterfamiljasit, të dhënë personave alieni iuris ose me skllëvërit ,në bazë të urdhërit kategorik të paterfamiljasit të dhënë personave alieni iuris apo skllëvërve për lidhjen e veprimit juridik.⁷

-Actiones noxales: qysh në dispozitat e ligjit të XII Tabelave ,personat alieni iuris dhe skllëvërit kishin zotësi pasive detyrimore,kur me veprime antiligjore kishin dëmtuar ndonjëperson.Kur këta persona kishin bërë delikt me dijeninë e paterfamiljasit ose sias urdherit të tij , paterfamiljasi konsidrohet si kryesi i drejtpërdrejtë i deliktit dhe ishte direct përgjegjës për zhdëmtim. Kur këta persona e kishin bërë deliktin pa dijeninë e paterfamiljasit apo kundër vullnetit të tij,aplikohej parimi mbi të ashtuquajturën përgjegjësi noksale. Sipas rregullave mbi përgjegjësinë noksale, paterfamiljasi ishte i detyruar ose ta shpërblente dëmin që e kishin shkaktuar personat alieni iuris ose skllëvërit ose ta dorëzonte delikuentët personit të dëmtuar, në mënyrë ta paguaj borxhin.Nga detyrimi për ta shpërblyer dëmin për shkat të deliktëve të

⁷Prof. Ken Dhima, E Drejta Romake, botimi parë, Tiranë, 2007, fq. 588-589.

personave alieni iuris ishin të çliruar ata të patres familias, që kishin pushuar ta ushtronin patriam potestatem mbi delekuentin.⁸ Kur në të drejtë klasike u stabilizuan plotësisht parimet mbi përgjegjësinë e pater familiasit për detyrimet e personave alieni iuris dhe skllëvërve të marra në rastet e të ashtuquajturave actions adjecticiae qualitatis, në të drejtën romake mbizotëroi mendimi se nga shkaqet e drejtësis së vëtet duhet tju njihen disa zotësi obligatore passive këtyre personave edhe në rastet kur disa punë të caktuara juridike i kishin lidhur pa lejen paraprake.

Detyrimet natyrore ose obliguese ,paraqitnin një lloj të vacant të obligatave, sepse nuk kishin mbrojtje të plot juridike, nuk mund të mbroheshin as me padi civile as me pretoriane. Pasojat themelore juridike e detyrimëve natyrale lindte pas pagimit vullnetar të borxhit natyral: debitori që kishte paguar vullnetarisht borxhin natyral nuk mund ta perdorte conditio indebiti si mjet për restituimin e prestimit të bërë. Detyrimet natyrale: mund të përtriheshin (novatio) mund të merreshin në konsiderim përkitazi me kompenzimin, mund të shërbenin si bazë për vendosjen e garancis personale apo reale të kreditorëve.

Përveç detyrimëve të personave alieni iuris dhe të skllëvërve si detyrime natyrale trajtoheshin edhe detyrimet e personave pa zotësi verimi të mara pa lejen e tutorëve apo kujdestarëve.⁹ Është theksuar që midis karakteristikave themelore të detyrimëve është detyrimi i debitorit për ti siguruar kreditorit një sjellje të caktuar. Kjo do të thotë, që nëse kjo sjellje nuk realizohet apo nuk i siguron kreditorit rezultatin e parashikuar, debitori pergjigjet dhe mundet për këtë shkak të thyret në gjykim nga kreditori për të dënuar dhe për të pësuar pasojat që shoqërojnë dënimin. Në rastet e përfshira nën këtë emër futet egzistenca e një borxhi, që percakton papërshtatshmërinë e saj që kryhet për përmbushjen e detyrimit : nuk ka veçse përgjegjësi , në mënyrë të atillë që i mungon kreditorit e drejta për të ngritur padi në gjykim kundër debitorit për ta detyruar atë që ta përmbush detyrimin. Egziston vetë ndonjë element i detyrimit , ndërsa mungonin elementet e tjerë, dhe nuk egziston kështu një obligation “civilis” apo një obligation në kuptimin juridik.

2. KARAKTERISTIKAT

E drejta e detyrimëve si degë e vaçantë e së drejtës rregullon marrëdhëniet e detyrimëve. Marrëdhëniet e detyrimëve janë marrëdhënie juridike ndërmjet debitorit dhe kreditorit, ku kreditori ka të drejt të kërkojë nga debitori një berje, mosbërje dhe premtim, kurse debitori kësaj duhet ti përmbahet. Kuptohet se detori duhet ta respektojë këtë kërkesë, derisa e drejta e kreditorit dhe autorizimet e tij ushtrohen ashtu sikundër kërkojnë rregullat e kësaj dege të së drejtës.

Nga përkufizimet e lartpërmendura kemi këtë ndarje :

- Detyrimet si marrdhënie me karakter juridik,
- Detyrimet si marrdhënie me përmbajtje të caktuar,
- Detyrimet si marrdhënie me karakter pasuror,
- Detyrimet si marrdhënie me karakter relativ,
- Detyrimet si marrdhënie midis subjekteve të caktuara.

⁸ Prof. Ken Dhima, E Drejta Romake, botimi parë, Tiranë, 2007, fq. 590.

⁹ Dr. Ivo Puhan, E Drejta Romake, botimi I pestë, Prishtinë, 1989, fq. 289.

2.1.Detyrimet si marrëdhënie me karakter juridik

Detyrimet janë marrëdhënie juridike, që do të thotë se janë të rregulluara në mbështetje të rregullave juridike. Kjo karakteristik rrjedh qysh nga Institucionet e Justinianit, në të cilat detyrimet janë quajtur marrëdhënie juridike-*Obligatio est vinculum juris*. Karakteri juridik i detyrimit do të thotë: që marrëdhënie e krijuar ndërmjet pjesëmarësve jo vetëm që është rregulluar sipas së drejtës, por edhe gëzon mbrojtje juridike ose sanksion juridik, dmth: se pjesëmarësi i detyrimëve ka të drejtë të përdor mjete dhune për realizimin e të drejtave të veta. Mjet tipik për mbrojtjen e detyrimëve (si marrëdhënie juridike-civile) është: *actio civilis* – action, me të cilën kreditori kërkon të vërtetohet ekzistimi i së drejtës së tij në marrëdhëniet e detyrimëve, me të cilën urdhërohet debitori që në afat të caktuar ta përmbush detyrën e vet ndaj kreditorit. Mjete tjera juridike janë:

-kundërshtimi-*exceptio*,

-kthimi në gjendjen e mëparshme- *restitution in integrum*.

Këto detyrime që gëzojnë sanksion, janë detyrime civile. Ekzistojnë edhe detyrime të cilat nuk gëzojnë sanksion juridik, që nuk mund të realizohen me mjete juridike, këto quhen: detyrime natural.¹⁰

2.2.Detyrimet si marrëdhënie me përmbajtje të caktuar

Nga kuptimi i marrëdhënies të detyrimëve rrjedh se detyrimet janë me përmbajtje të caktuar. Kjo përmbajtje e detyrimëve është konkrete dhe e vërtetë. Nga çdo marrëdhënie detyrimëve u krijohen të drejta dhe detyra si debitorit ashtu dhe kreditorit. Këto të drejta dhe detyra janë përmbajtja e çdo detyrimi. Kjo përmbajtje krijon sjelljet debitorit dhe kreditorit, sepse debitori duhet të kryej diçka, ose të mos kryej, ose të pësojë në dobi të kreditorit i cili kërkon diçka nga ai. Parimisht çdo marrëdhënie e detyrimit e ka përmbajtjen e vet dhe duhet ta ketë.

Përmbajtja e saj ndikon që të caktohet se për çfarë lloj detyrimi është fjala, psh: kur detyra e njëres pale përbëhet nga dorëzimi i sendit të caktuar në pronësi të tjetrit, atëherë kemi të bëjmë me kontratën e shitjes, që i krijon obligim pale tjetër të dorëzojë çmimin, ose një send tjetër nëse është nëpyetje kontrata mbi këmbim. Përmbajtja e detyrimit në të gjitha të drejtat nacionale dhe siat rregullave të unifikuara duhet të jenë në harmoni me: dispozitat kushtetuese, dispozitat imperative dhe me rregullat morale, sepse në të kundërtën shkakton efekte juridike.¹¹

2.3.Detyrimet si marrëdhënie me karakter pasuror

Parimisht çdo marrëdhënie e detyrimëve mund të vlerësohet me para. Karakteri pasuror dhe mundësia e vlerësimit me para janë raste që dominojnë në marrëdhëniet e detyrimëve, kurse marrëdhëniet që nuk mund të vlerësohen me para më pak gjejnë shprehje, por gëzojnë mbrojtje juridike. Karakteri material i marrëdhënies të detyrimëve paraqitet në ato raste kur:

¹⁰ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 42.

¹¹ Prof.dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimëve, botimi dytë, Prishtinë, 2002, fq. 117-118.

mosekzekutimi i detyrës nga ana e debitorit do ti shkaktoj ndonjë dëm kreditorit dhe do ta detironte debitorin që të bëjë dëmshpërblimin i cili bëhet me para.¹²

Këto marrëdhënie në disa raste shkaktojnë rritjen e pasurisë-shitja, kurse në disa raste shkaktojnë zvogëlimin e pasurisë-dhurata, ose ka raste në marrëdhëniet e detyrimëve kur marrëdhëniet nuk kanë karakter pasuror, por ajo si e tillë është e mjaftueshme për mbrojtje sipas rregullave të së drejtës së detyrimëve. Me fjalë tjera duhet thënë se në marrëdhëniet e detyrimëve nuk ka marrëdhënie juridike që në një mënyrë ose në një tjetër nuk mund të vlersohet në të holla.¹³

2.4.Detyrimet si marrëdhënie me karakter relativ

Parimisht marrëdhëniet e detyrimëve krijohen midis debitorit dhe kreditorit. Marrëdhëniet e krijuar krijojnë efekte midis tyre-inter partes. Sipas kësaj marrëdhënie detori ka obligim ndaj kreditorit, për këtë arsye edhe thuhet se marrëdhëniet kanë karakter relativ që dallohet nga marrëdhëniet që kanë karakter absolut- erga omnes.Sipas rregullave të së drejtës së detyrimëve kreditori është i autorizuar që të kërkojë nga debitori të përmbushë detyrimin e vet.Ai parimisht nuk mund ti drejtohet personit të tretë ,sepse nuk është në marrëdhënie juridike me të.Kjo veçori mbrohet sepse shton sigurinë juridike në qarkullim. Nëse do të lejohet që kreditori t'u drejtohet edhe personave të tretë pa arsye, atëherë do të shkaktohej pasiguria e caktuar juridik

2.5.Detyrimet si marrëdhënie midis subjekteve të caktuara

Detyrimi është marrëdhënie juridike ndërmjet personave të caktuar.Në këtë marrëdhënie nevojitet të egzistojnë së paku dy persona, të cilët kanë role të caktuara.Një personë në këtë marrëdhënie juridike, paraqitet në rolin e tij, që ka të drejtë të kërkojë që personi tjetër ti japë një gjë, të veprojë ,apo të mos veprojë.Ky person quhet: kreditor .Personi tjetër paraqitet në rolin e atij që obligohet që ti japë, të veprojë ose të ,mos veprojë quhet:debitor.

Në të drejtën e sotme të detyrimëve fjala kreditor dhe debitor përdoren për të përcaktuar subjektet e marrëdhënies të detyrimëve,pa marrë parasysh se si janë krijuar.Në marrëdhëniet e detyrimëve të krijuara pas shkakut të demit,personi i dëmtuar është kreditor, e dëmtuesi debitor, ndërsa në marrëdhëniet e detyrimëve të krijuara nga pasurimi pa bazë, personi i varfëruar është kreditor ,ndërsa personi i pasuruar debitor.

3.VETITE E DETYRIMEVE TE PLOTËFUQISHME

Marrëdhëniet e detyrimëve mund të krijohen në raste të caktuara dhe situata të ndryshme. Krijimi i tyre është i shumëllojshëm sepse në këtë degë të së drejtës egzistojnë shumë fakte relevante që mundësojnë sajimin e tyre.Për këtë arsye thuhet se jeta e njerëzve është e thurur me

¹² Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 45.

¹³ Prof.dr. Alajdin S.Alishani, E Drejta e Detyrimëve, botimi i dytë, Prishtinë, 2002, fq. 121.

marrëdhëniet e detyrimëve, dhe kjo pa marrë parasysh në janë marrëdhëniet e përgjithshme midis pjesëmarësve apo jonë marrëdhënie që mundësojnë qarkullimin e pasurisë prej një subjekti në subjektin tjetër. Që të realizohet kalimi i pasurisë prej një subjekti në subjektin tjetër pjesëmarësit krijojnë marrëdhënie të ndryshme të detyrimëve. Marrëdhëniet që krijohen midis tyre duhet të jenë të plotëfuqishme.

Detyrimi ose marrëdhënia e detyrimit për të qenë e plotëfuqishme duhet të plotësojë këto kushte:

- Detyrimi duhet të jetë i mundshëm,
- Detyrimi duhet të jetë i caktuar, dhe
- Detyrimi duhet të jetë i lejuar.¹⁴

3.1.Detyrimi duhet të jetë i mundshëm.

Detyrimi është i mundshëm në qoftë se debitori obligohet për diçka që është e mundshme që të bëhet. Qysh në të Drejtën Romake ka egzistuar rregulla: *impossibilum nulla est obligatio* dhe *ultra posse nemo tenetur*. Pra nuk ka detyrim në qoftë se debitori, obligohet për diçka që është e mundshme që të bëhet. Çdo pamundësi për ekzekutim nuk ka pasoja për plotëfuqishmërinë e detyrimëve.

Sipas natyrës pamundësia mund të jetë :

- Pamundësia objektive
- Pamundësia subjektive,
- Pamundësia fillestare,
- Pamundësia e mëvonshme,
- Pamundësia e natyrës fizike,
- Pamundësia juridike.

-Pamundësia objektive: do të kuptohet kur detyrimi është i atillë që askush nuk do të mund të ekzekutojë. Pamundësia objektive për ekzekutim do të ketë si pasojë që të mos krijohet detyrimi i plotëfuqishëm. Pamundësia subjektive: do të kuptohet kur detyrimi është i atillë që debitori i caktuar nuk mund ta ekzekutojë, por mund ta ekzekutojnë personat tjerë. Pamundësia subjektive nuk do të ketë si pasojë pavlefshmërinë e detyrimit, por debitori, i cili ka premtuar të kryejë diçka që nuk mund ta bëjë, është i detyruar që kreditori tja paguaj dëmin, të cilin ky kishte për ta pësuar, për shkak se debitori nuk e ka ekzekutuar detyrën që e ka marrë.

-Pamundësia fillestare: do të kuptohet kur detyrimi ka qenë një natyrë të atillë, atëherë kur debitori e ka marrë obligimin që të ekzekutojë. Për arsye të pamundësisë fillestare nuk mund të ekzekutohet detyrimi i plotëfuqishëm, madje edhe sikur më vonë të bëhet i mundshëm.

-Pamundësia e mëvonshme: do të kuptohet kur detyrimi në momentin e krijimit ka qenë i mundshëm, por në momentin e ekzekutimit është bërë i pamundshëm. Në këtë rast patjetër do të kushtohet kujdes shkakut pse ekzekutimi i detyrimit është bërë më vonë i pamundshëm.

Në qoftë se debitori do të jetë fajtor për pamundësinë për ekzekutim, detyrimi krijon efekt dhe debitori është i detyruar që në vend të detyrimit të përparshëm, të cilin nuk mund ta përmbushte tja paguaj dëmin kreditorit.

-Pamundësia fizike: do të kuptohet kur detyrimi nuk mund të ekzekutohet sepse sendi, që ka pasur për tja dorëzuar kreditorit, është zhdukur. Detyrimi në atë rast nuk ekziston më.

¹⁴Prof.dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimëve, botimi I dytë, Prishtinë, 2002, fq. 123.

-Pamundësia juridike: do të kuptohej kur detyrimi nuk mund të ekzekutohet për shkak juridike.¹⁵

3.2.Detyrimi duhet të jetë i caktuar ose i caktueshëm.

Në të drejtën e detyrimëve është rregull se detyrimet duhet të jenë të caktuara, i caktua është detyrimi në qoftë se debitori dhe kreditori i dinë të drejtat dhe detyrat e tyre. Themi kështu sepse në marrëdhëniet e detyrimëve kërkohet që detyrimi në mënyr precise duhet të jetë i caktuar dhe kjo duke patur mundësi që të përshkruhet ose të precizohet qartë psh: të dorëzohen 100 tonelata gurë, nga prodhimi i 2001. Detyrimi i caktuar sipas rregullës duhet të jetë i konkretizuar. Detyrimi është i konkretizuar kur është individualizuar lënda e tij.

Me individualizimin e detyrimit mundësohet fare lehtë që ai të dallohet nga detyrimet tjera. Në marrëdhëniet e detyrimëve është rregull që detyrimi midis subjekteve të caktuara duhet të jetë caktuar në momentin e krijimit të tij. Parimisht caktimin e detyrimit e bejnë palët ose pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimëve, si dhe në rastet e caktuara këtë mund ta bej edhe personi i tretë. Në të drejtën nacionale si dhe rregullat e unifikuara është shumë me rëndësi që detyrimi të jetë i caktuar, sepse kjo rrethanë krijon siguri më të madhe juridike në qarkullim.

3.3.Detyrimi duhet të jetë i lejuar.

Detyrimi, sipas rregullave të kësaj dege të së drejtës, për të krijuar efekte juridike, duhet të jetë i lejueshëm. Themi se detyrimi është i lejueshëm nëse është në përputhje me rregullat e kësaj dege të së drejtës, ose me rregullat e sistemit juridik të vendit. Në bazë të kësaj rregulle mbrohen rregullat e së drejtës së detyrimëve, rregullat e çdo sistemi juridik, rregullat e dokëve dhe rregullat e moralit shoqëror.

Sipas këtyre rregullave detyrimi është i palejuar ku është në kundërshtin me dispozitat kushtetuese, dispozitat imperative, doket, rregullat e moralit shoqëror. Në marrëdhëniet e detyrimëve, detyrimi është në kundërshtim me ligjin, nëse cënon barazinë e pjesëmarrësve në raste dhe situatë të ndryshme: në qoftë se keqpërdor të drejtat e veta, nëse vepron në kundërshtim me rregullat e drejtshmëris dhe mirëbesimit.¹⁶

4. KLASIFIKIMI I DETYRIMËVE

Marrëdhëniet e detyrimeve janë të shumta dhe të llojllojshme. Prandaj për ti studiuar më mirë, doktrina juridike në të drejtën nacionale bën ndarjen ose klasifikimin e tyre. Kjo ndarje bëhet me të vetmin qëllim që të mbarështrihen sa më mirë dhe të kuptohen rrjedhat e te gjitha

¹⁵ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, botimi I dytë, Prishtinë, fq. 21.

¹⁶ Prof.dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimëve, botimi dytë, Prishtinë, 2002, fq. 127.

detyrimëve në qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimëve. Kurë me kujdes analizohen ndarjet e detyrimëve që janë bërë dhe që po bëhen, mund të vërehet lehtë se kemi shumë ndarje në këtë lëmi.

Kriterët për ndarjen janë të ndryshme :

-Sipas karakterit juridik dallojmë:

- 1.Detyrime civile,
- 2.Detyrime natyrale.

-Sipas lëndës së ekzekutimit dallojmë :

- 1.Detyrime positive,
- 2.Detyrime negative.

-Sipas asaj se a dorëzohen sasi të caktuara parash ose sendesh të caktuar dallojmë:

- 1.Detyrimet me para,
- 2.Detyrimet jo me para.

-Sipas saktësisë së detyrimit dallojmë:

- 1.Detyrime individuale ,
- 2.Detyrime gjenetike.

-Sipas shumëllojshmërisë së lëndës dallojmë :

- 1.Detyrimi kumulativ,
- 2.Detyrime alternative,
- 3.Detyrime fakultative.

-Sipas shumësisë së subjekteve dallojmë:

- 1.Detyrime solidare aktive,
- 2.Detyrimet solidare pasive.

-Sipas kohëzgjatjes së prestimeve .:

- 1.Detyrime të perkohëshme,
- 2.Detyrime suksesive,
- 3.Detyrime me pretime të përhershme.

-Sipas asaj që cili subjekt e ekzekuton detyrimin dallojmë:

- 1.Detyrime thjesht personale,
- 2.Detyrime jopersonale.

Rëndësia kryesore e ndarjes së detyrimëve qëndron në faktin se shumë më lehtë mund të studiohen, dhe të kuptohet çdo ceshtje që ajo inicon. Madje, ndarja e tyre lejon mundësin që këto marrëdhënie të detyrimëve të rregulohen më mirë dhe të avancohen edhe më tepër në një mendësin eksistuese.

Në fund duhet thënë se ndarja e detyrimëve vë në pah edhe faktin e dallimeve evidente që ekzistonë midis tyre ngarkes për disa detyrime zbatohen rregulla të caktuara të së drejtës së detyrimëve, kurse për ndarje tjetër të detyrimëve zbatohen rregulla krejt tjera, që përndryshe nuk mund të zbatohen në detyrimet tjera.¹⁷

¹⁷ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 47.

1. Ndarja e detyrimëve sipas karakterit juridik.

Kjo ndarje e detyrimëve bëhet sipas saj se a thua detyrimi mund të realizohet me mjete juridike apo jo. Në qoftë se detyrimi mund të realizohet me mjete të dhunshme, atëherë detyrimet janë: civile, ndërsa në qoftë se nuk mund të realizohet me mjete juridike, atëherë detyrimi quhet : detyrim natyral. Detyrimet civile sipas rregullave të së detyrimëve në qoftë se nuk realizohen në mënyrë vullnetare, atëherë atom mund të realizohen me mjete juridike para organit përgjegjës. Nëse debitori nuk e përmbush detyrimin e vet, atëherë titullari i së drejtës ose kreditori ka të drejtë që me anë të padis, ose me anë të kundërshtimit të realizoj kërkesën e vet.

Që të realizoj të drejtën e vet ai duhet këtë ta vërtetojë para organit kompetent dhe të deshmtoj se me të vërtet ai ka kërkesë të caktuar ndaj debitori. Detyrimet natyrore janë ato detyrime që nuk mund të realizohen me mjete juridike nëse nuk përmbushen në mënyrë vullnetare nga ana e debitorit. Nuk duhet haruar faktin se këto detyrime fare nuk kanë sanksion, sepse nëqoftë se detyrimi i parashkruar është mbushur, konsiderohet se është përmbushur detyrimin që ka ekzistuar, e jo se nuk ka ekzistuar. Detyrimet natyrore mbështetjen e kanë: në rregullat e rendit juridik, në rregullat e dokeve të mira dhe në rregullat e moralit.¹⁸

2. Ndarja e detyrimëve sipas lëndës se ekzekutimit.

Detyrimet pozitive janë ato, në cilat debitori është i detyruar të sillet aktivisht, të ndërmar ndonjë veprim, bërje ose mosbërje pra in faciendo. Detyrimi pozitiv ekziston: për blerësin-që tia paguaj shitësit çmimin e shitjes, për shitësin-që tia dorëzoj sendin blerësit.

Detyrime negative: janë detyrimet të cilat përbëhen nga fakti i mosveprimit ose pësimit (in non faciendo, pati). Kështu ndodh: kur një subjekt i detyrohet tjetrit se nuk do të ndërtoj ndonjë objekt banimi në tokën e vet, ose kur një subjekt obligohen ndaj tjetrit që ai mund të kaloj nëpër tokën e tij.¹⁹

3. Ndarja e detyrimëve sipas asaj se a dorëzohen sasi e parash ose sendesh të caktuar.

Detyrimi është në para, në qoftë se lënda e prestimit është dorëzimi i një sasi të caktuar të parave, kurse jo në para, në qoftë se lënda e prestimit është dorëzimi i ndonjë sendi tjetër në qarkullim. Edhe pse detyrimet jo në para janë më të shumëllojshme se ato në para, detyrimet në para kanë rëndësi më të madhe në qarkullimin juridik, sepse paratë janë vlerë e përgjithshme ekuivalente dhe mjet i përgjithshëm i pagesës. Ky konstatim mund të vërtetohet nga e dhëna se detyrime jo në para mund të vlerësohet në para, gjë që edhe skelja e detyrimëve të këtilla do të ketë si pasojë dëmshpërblimin që zakonisht shprehet në para, dhe se edhe paraja është mall, ku blehet si vlerë numizmatike. Për arsye të rëndësisë së madhe të parave në të drejtën e qarkullimit juridiko-ekonomik, detyrimet në para në të drejtën tonë janë rregulluar me normat imperative më shumë se sa detyrimet jo në para.

¹⁸ Prof.dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimëve, botimi dytë, Prishtinë, 2002, fq. 129-130.

¹⁹ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 48.

Detyrimet në para më së shumti paraqiten si të përbëra: debitori obligohet për pagimin e sasisë së caktuar të parave si detyrë kryesore e përveç asaj, ekziston detyra e pagimit të kamatës si detyrë aksesore. Pagimi i kamatës është karakteristik për detyrimet në para dhe përfaqëson specifitetin e tyre.²⁰ Pra: kur detyrimi ka një shumë monetare, debitori është i detyruar të paguaj numrin e njësive monetare për të cilat është deklaruar detyrimi, nëse me ligj është përcaktuar dëbica tjetër, (neni 383, LMD, i RM-së).

4. Ndarja e detyrimëve sipas saktësisë të detyrimit.

Detyrime individuale: janë ato në të cilat debitori ka borxh të përmbush prestimin e caktuar, dorëzimin e sendit të caktuar ose kryerjen e veprimit të caktuar. Lëndë e detyrimit individual është sendi individualisht i caktuar (res in specie), i cili është i pazëvendësueshëm. Në qoftë se sendi humbet për shkak të fuqisë madhore, ose qarkullimi i tij do të ndalohej me norma imperative-ligjore, debitori do të lirohet nga detyra.

Detyrime gjenetike: janë ato detyrime lënda e prestimit e të cilave është caktuar sipas llojit (res in genere), ashtu që detyrimi mund të përmbushet pas dorëzimit të çfarëdo sendi të atij lloji të sendit i cili është lëndë e detyrimit, psh kur debitori është i detyruar të dorëzojë 100 kg grurë. Lëndë e detyrimëve gjenetike, si rregull, është sendi i zëvendësueshëm, e që me rastin e humbjes së një sasi të sendëve të gjinisë së njëjtë, debitori nuk do të lirohet prej detyrës, sepse ekzistonë sasi të tjeratë sendëve të gjinisë së njëjtë.²¹

5. Ndarja e detyrimëve të përbëra prej me shumë objektesh.

Detyrimet kumulative: janë detyrime me shumë lëndë. Kjo ndarje e detyrimëve bëhet duke marrë parasysh shumësin e sendëve që duhet të dorëzohen nga ana e debitorit, kreditorit. Detyrimet kumulative ekzistojnë kur debitori i ka borxh sende të ndryshme të shumta kreditorit, dhe detyrimi konsiderohet se është përmbushur kur ai ia dorëzonë atij të gjitha ato sende. Madje detyrim, kumulativ kemi kur debitori duhet të dorëzojë kreditorit një televizor, sasi të caktuar të hollave, kur duhet të kryejë një punë të caktuar, kur duhet në rastin konkret të mos veproj, ose të japë shërbim të caktuar. Veçoria kryesore e këtyre detyrimëve qëndron në faktin se debitori është i obliguar që detyrën e vet ta përmbush kumulativisht. Për këtë arsye është rregull që kreditori është i autorizuar në këto detyrime të kërkojë nga debitori të dorëzojë të gjitha sendet e detyrimit kumulativ. Detyrimet kumulative duhet të dallohen nga borxhet kumulative. Ky rast i marrëdhënieve të detyrimëve ekziston kur shitësi ka obligim në këtë marrëdhënie të dorëzojë sendin, të garantojë për mungesat juridike dhe fizike të sendëve, ose rasti kur i pasuruari të pasurimi pa bazë ka obligim të kthejë atë çka është pasuruar, të paguaj kamatën ose të kthejë frytet në qoftë se ka qenë i pandërgjegjshëm.²²

Detyrime alternative: janë ato detyrime në të cilat detyrimi përbëhet prej shumë lëndë, ku debitori është i obliguar të dorëzojë njërin prej tyre dhe të konsiderohet se obligimi është

²⁰ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, botimi i dytë, Prishtinë, fq. 26.

²¹ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 50.

²² Prof.dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimëve, botimi i dytë, Prishtinë, 2002, fq. 148-149.

përmbushur.(neni 391 i LMD-RM-së).Në këto detyrime është me rëndësi çështja e zgjedhjes së lëndës për përmbushje.

Të drejtën e zgjedhjes e kanë :

- kreditore,
- debitore ose
- personi i tretë.

-Nëse e drejta e zgjedhjes i takon kreditorit, dhe ai nuk do të mbrojë zgjedhja para afatit të caktuar për përmbushje, debitori mund ta ftoj atë të ekzekutojë zgjedhjen dhe vendosjen e një afati kohor të përshtatshëm për të cilin e drejta e zgjedhjes ka skaduar mbi debitorin,(neni393,aline,2, LMD së RM-së).

-Debitori ka të drejt të zgjedh për aq kohë sa në procedurën e detyrueshme ekzekutimi i njërit prej objekteve që i detyrohet nuk do të jetë tërësisht ose pjesërisht i dorëzohet kreditorit sipas zgjedhjes së tij,(po i njëjti nen, aline 1).

-Nëse zgjedhja duhet të kryhet nga një palë e tretë dhe personi nuk e bën këtë, secila palë mund të kërkojë që zgjedhja të kryhet nga gjykata,(neni,394,LMD-së,i RM-së).

Kjo varet nga vullneti i pjesëmarrësve ose nga ligji.Zgjedhja është shprehja e njëanshme e vullnetit , e cila mund të jepet qoftë me gojë , me shkrim heshtazi.Zgjedhja duhet të bëhet në kohë, dhe duhet të njohet pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit.Zgjedhja e bërë njëher është përfundimtare dhe nuk mund të revokohet.Sipas natyrës, zgjedhja paraqet shprehjen e njëanshme të vullnetit, në të cilin detyrimi alternativë shëndrohet në detyrim të thjeshtë dhe bënë koncentrimin në lëndën e zgjedhur. Nëqoftë se një nga lëndët e borxhit asgjësohet me fajin e debitorit, kurse e drejta e zgjedhjes do të takonte kreditorin,ky mund të kërkojë ose lëndën e ngelur, ose shpërblimin me para për lëndën e humbur.

Detyrimet fakultative janë ato detyrime: kreditori në obligimet fakultative mund të kërkojë nga debitori vetëm lëndën e detyrimit, jo edhe lëndë tjetër,me të cilën debitori nëse dëshiron mundet ta përmbush detyrimin e tij,(LMD, RM-së ,neni 398,aline.1).

Kur objekt i detyrimit bëhet i pamundur për shkak të një ngjarje për të cilën debitori nuk është përgjegjës, kreditori mund të kërkojë vetëm kompensimin, por debitori mund të lirohet nga detyrimi duke i dhënë objektin për të cilin ai është i autorizuar, të jap atë në vend të objektit që është borxh, (po i njëjti nenë ,aline,2).

Detyrimet fakultative mund të sajohen në bazë:

- të kontratës,
- ligjit dhe
- testamentit.

-Detyrimet fakultative në bazë të kontratës ekzistojnë kur te një kontratë njëra palë është e obliguar të dorëzojë një send të paluajtshëm, por ajo në bazë të vetë kontratës është e autorizuar që të përmbush detyrimin e vet duke dorëzuar një send të luajtshëm.

-Në bazë të ligjit detyrimi fakultativ ekziston te dëmtimi pa masë, kur personi i dëmtuar është i autorizuar sipas rregullave të së drejtës së detyrimëve që të kërkojë anulimin e kontratës, mirpo pala tjetër mund të përmbushë detyrimin e vet duke kthyer atë që e ka marrë ose duke e plotësuar deri në vlerën e vërtet të sendit.Te detyrimet fakultative debitori ka borxh një sendë të caktuar, por ekzistojnë shumë lëndë me të cilat detyrimi mund të përmbushet. Kjo rregull ka qenë e njohur në të drejtat e vjetra(una res est in obligation,sed plures res sub in solution).Me këtë mundësi debitori mund të shërbehet derisa kreditori në procedurën e ekzekutimit ose të përmbushimit nuk e refuzon në tërësi ose pjesërisht lëndën e detyrimit.Kurë është paraparë sipas kontratës ose dispozitave të ligjit që kreditori mund të kërkojë nga debitori

në vend të lëndës së borxhit ndonjë send tjetër të ketij detyrimi, atëherë debitori është i obliguar ta dorëzojë nëse këtë e kërkon kreditori.

-Kur lënda e detyrimit fakultativ bëhet e pamundëshme nga ngjarja për të cilën debitori, nuk përgjigjet, kreditori mund të kërkojë vetëm shpërblimin e dëmit, meqenëse debitori mund të lirohet nga detyra duke dorëzuar lëndën për të cilën është i autorizuar në vend të lëndës së borxhit. Por, nëse lënda e ketij detyrimi bëhet e pamundëshme me fajin e vet debitorit, atëherë kreditori mund të kërkojë vetëm shpërblimin e dëmit, meqenëse debitori mund të lirohet nga ky obligim duke dorëzuar lëndën për të cilën është i autorizuar.²³

6. Ndarja e detyrimëve me shumë subjekt.

Detyrimet solidare ose marrëdhëniet e pandashme bashkëdetyrimore ekzistojnë atëherë kur në anën e kreditorëve ose në anën e debitorëve kishte shumë persona, kurse çdonjeri nga kreditorët kishte të drejtë ta nxirrte tërë aktivin (in solidum) kurse çdonjeri nga debitorët kishte detyrim që ta paguaj tërë borxhin. Këto detyrime mund të krijohen sipas ligjit, kontratës ose testamentit. Detyrimet solidare ndahen në:

- aktive dhe
- passive,

sipas asaj se a ka më shumë subjektë në anën e kreditorit apo të debitorit.

-Detyrimet solidare aktive: janë ato në të cilat ka shumë kreditorë dhe një debitor, në të cilat secili kreditor është i autorizuar të kërkojë pagimin e tërë detyrimit dhe kur merr kërkesën një kreditor, detyrimi shuhet edhe për kreditorët tjerë. Solidariteti aktiv krijon efekt të dyfishtë:

Efekti në marrëdhëniet midis kreditorëve dhe njërit debitor, dhe

Efekti në marrëdhëniet midis kreditorëve, pasi që realizojnë pagesën për kërkesën e tyre.

-Efekti midis shumë kreditorëve dhe një debitori: Në detyrimet solidare aktive ka aq kërkesa sa ka kreditor, por çdo kreditor ka të drejtë të kërkojë pagimin e kërkesës në tërësi dhe në rast se paguhet, detyrimi shuhet ndaj kreditorëve tjerë. Debitori ka të drejtë të bëjë pagesën cilin do nga kreditorët. Çdo njëri nga kreditorët është i autorizuar që të ndërmarë të gjitha ato veprime me të cilat mbrohen mbrohen intereset e kreditorëve të tjerë.

-Efekti midis kreditorëve pasi që marrin pagesën: Në rast se paguhet kërkesa ndaj njërit kreditor, detyrimi shuhet edhe për kreditorët tjerë. Kreditorët mund ta ndajnë kërkesën e paguar në pjesë të barabarta.

-Detyrimet solidare pasive: janë detyrime të përbëra, në të cilat ekzistojnë shumë debitorë e një kreditorë, dhe secili debitorë është i detyruar që të paguaj tërë detyrimin dhe pas pagimit detyrimi shuhet edhe për debitorët tjerë solidar. Edhe solidariteti pasiv mund të krijohet në bazë të ligjit, kontratës dhe testamentit. Si raste të rëndësishme të detyrimëve solidare pasive janë: kur prindërit dhe femijët përgjigjen solidarisht për dëmin e shkaktuar nga i mituri: përgjegjësia e të miturit dhe mbrojtësit, ku ka shumë nënshkrues të kambialit, kur ka shumë persona (dëmtues) e shkaktojnë një dëm etj.

-Efektet e solidaritetit pasiv: detyrimet solidare pasive krijojnë dy lloj efektesh:

²³ Prof.dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimëve, botimi dytë, Prishtinë, 2002, fq. 148-149.

-Efekti në marrëdhëniet midis shumë debitorëve dhe një kreditori: në detyrimet solidare passive kreditori mund të kërkojë pagimin e borxhit nga çdo debitor. Kur njëri nga debitorët solidare paguan borxhin në tërësi, të gjithë debitorët tjerë solidar lirohen nga detyrimi. Efektet e detyrimëve solidare passive krijojnë efekte kur shkaktohet ndonjë rast i shuarjes së tyre, konkretisht në këto raste: kompensimi, falja e borxhit, konfondimi, vonesa e kreditorit, pohimi i borxhit, parashkrimi i kërkesave.

Kompesimi: është rrafshim i kërkesave kur në një marrëdhënie të detyrimit, si debitori, ashtu edhe kreditori kanë të drejta dhe detyrime të ndërvetshme. Efekti i vaçant i detyrimëve solidare passive shprehet në rast se falet borxhi, që është e drejt e kreditorit që ta fal borxhin në tërësi, pjesërisht, kolektivisht ose individualisht. Nëse ndodh përtrirja (novatio), që krijohet ndërmjet një kreditori dhe një debitori, detyrimi shuhet edhe ndaj debitorëve tjerë.

Në konfondim (konfusio), në rastin kur në një subjekt bashkohet cilësia e kreditorit dhe e debitorit, detyrimi zvogëlohet për atë sa ka pasur borxh debitori që ka fituar vetitë e kreditorëve. Nëse bëhet akt pajtimi midis kreditorëve dhe debitorit solidar, aktpajtimi nuk ka kurrfarë efekti juridik ndaj debitorëve tjerë. Nëse paraqitet vonesa e kreditorit ndaj një debitori solidar, kreditori është në vonesë edhe ndaj debitorëve të tjerë solidar. Nëse bie në vonesë njëri prej debitorëve, vonesa e atij debitori nuk ka efekt ndaj debitorëve tjerë solidarë.

Parashkrimi i kërkesave: të detyrimëve solidare passive rastet kur nuk rrjedhin rregullat e parashkrimit, ose është ndërprerë rrjedhja e rregullave të parashkrimit ndaj një debitori, atëherë rregullat e parashkrimit rrjedhin edhe ndaj debitorëve të tjerë solidar. Vdekja e njërit debitor solidar: nuk do të sjellë ndërprerjen e solidaritetit. Në vend të debitorit të vdekur do të vijë trashëgimtarët e tij, ashtu që kreditori mund të kërkojë vetëm pjesën proporcionale të detyrimit, e jo edhe në tërësi.

-Efekti në marrëdhëniet midis debitorëve pas kryerjes së pagimit: pas pagesës së bërë nga njëri debitor, detyrimi shuhet edhe për debitorët tjerë. Në këtë rast barra e borxhit të paguar duhet të ndahet ndërmjet debitorëve solidar. Ata mund ta ndajnë borxhin në pjesë të barabarta, ose sipas marrëveshjes së tyre.²⁴

Rëndësia e këtyre detyrimëve: Detyrimet solidare aktive kanë më pakë rëndësi se detyrimet solidare passive. Detyrimet solidare aktive nuk janë mjete të sigurimit të ekzekutimit të detyrimëve, sikundër janë detyrimet solidare passive. Reziku i insolvensës është shumë më i madh në detyrimet solidare aktive, sepse ketu një debitor përgjigjet për kërkesat e kreditorëve. Madje në detyrimet solidare aktive ekziston rreziku që borxhi i njëjtë të përmbushet dy herë, ngase në këto marrëdhënie ka shumë kreditorë. Këto dobësi eventuale të detyrimëve solidare aktive nuk duhet të jenë alibi për vlerën e tyre në qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimëve.²⁵

7. Ndarja e detyrimëve sipas kohezgjatjes së prestimëve.

-Detyrime të përkohëshme: janë ato në të cilat debitori detyrohet ta përmbush detyrimin në një çast. Detyra e debitorit përbëhet prej një bërje ose lëshimi, psh: detyra e shitësit që të dorëzojë sendin në pronësi të blerësit, detyra e blerësit që të paguaj çmimin.

²⁴ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 53-54.

²⁵ Prof.dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimëve, botimi dytë, Prishtinë, 2002, fq. 171.

-Detyrime suksesive: janë ato detyrime të përhershme në të cilat debitori detyrohet që veprimin ta përmbush në interval të caktuar.psh: pagimi i qirasënë kontratën mbi shfritëzimin e banesës.

-Detyrime me prestime të përhershme : janë ato në të cilat debitori është i detyruar që kreditorit ti bëjë, ose mos bëjë diçka brenda një kohe të gjatë. Kështu ndodh në kontratat e shitjes kur çmimi paguhet në kiste:dhënia e rentës jetësore në kontratën mbi mbajtjen e përjetshme.

8. Ndarja e detyrimëve sipas subjektit që e ekzekuton detyrimin.

-Detyrime thjeshtë personale(obligations intuit personae) janë ato që lidhen për cilësit personale të debitorit, të cilat është i detyruar ti kryejë vetë debitori, e jo ndonjë subjekt tjetër në vend të tij, psh:detyra e subjektit të autorizuar që të lidhë kontratën mbi autorizimin.Këto detyrimi nuk mund te cedohen(barten)ose të trashëgohen.

-Detyrime jopersonale janë ato të cilat nuk janë të lidhura për subjektin e debitorit dhe ato mund ti përmbush edhe dikush tjetër në emër dhe në vend të debitorit,psh kontata mbi shitjen, detyrën e shitësit që ti dorëzojë sendin blerësit mund ta bëjë edhe dikush tjetër në vend të tij.²⁶

5. SHUARJA E DETYRIMËVE

Secila marrëdhënie detyrimore realizohet për krijimin e efekteve të caktuara.Pas krijimit të këtyre efekteve detyrimi shuhet. Andaj, sipas rregullave ,marrëdhënia e detyrimit nuk krijohet për të ekzistuar një herë e përgjithmon ,por për të krijuar efekte juridike dhe pas kësaj të shuhet.²⁷Detyrimet pushojn(shuhem)kur plotësohen,si dhe në raste tjera të përcaktuara me ligj,(ligji për Marrëdhënie Detyrimore, neni 284,aline,1).

Marrëdhënia obligatore ishte marrëdhënie midis kreditorit dhe debitorit , në bazë të së cilës kreditori kishte të drejtë të kërkojë, ndërsa debitori kishte detyrë ta kryej prestimin e caktuar.Marrëdhënia e aktivitetit dhe e borxhit shuhej në atë moment kur ndërpritej e drejta e kreditorit që të kërkojë , ose bile detyrimi i debitorit që ta kryej prestimin që kishte borxh. Kjo bëhet me fakte juridike të cilat konsideroheshin si mënyra të shuarjes së marrëdhënieve të detyrimëve obligatore:omnia quae jure constituunter contrario jure pereunt.²⁸ Me detyrim sajohet marrëdhënia midis dy, apo më shumë personave, e cila nuk është me karakter të përhershëm. Ajo ka për tu shuar, pasi që ka aritur efektin e caktuar.

Me përmbushjen e detyrimit, detyrimi shuhet.Mirpo, përveç me përmbushje, detyrimet mund të shuhen edhe me mënyra tjera.Ekzistojnë ndarje të ndryshme të mënyrave të shuarjes së detyrimëve.Na duket, se mund të aprovohet ndarja e shuarjes së detyrimëve sipas ndikimit të vullnetit të pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimit në atë shuarje.²⁹

Mënyrat e shuarjes së detyrimëve janë:

²⁶ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 55.

²⁷ Prof.dr. Alajdin.S.Alishani, E Drejta e detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 667.

²⁸ Dr. Ivo Puhani, E Drejta Romake, Prishtinë, 1989, fq. 394.

²⁹ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 237.

1.Mënyra vullnetare(me dëshirë) e shuarjes së detyrimëve:

- Shuarja e detyrimëve me përmbushje(pagesa),
- Shuarja e detyrimëve me kompensim(compensation),
- Shuarja e detyrimëve me faljen e borxhit(remissio),
- Shuarja e detyrimëve me përtërirje(novation),
- Shuarja e detyrimëve me konfondim(confusion).

2.Mënyrat e shuarjes së detyrimëve kundër vullnetit të subjektëve të tyre.

- Shuarja e detyrimëve për shkak të pamundësisë së përmbushjes,
- Shuarja e detyrimëve me kalimin e kohës,
- Shuarja e detyrimëve me denoncim,
- Shuarja e detyrimëve me vdekjen e debitorit ose kreditorit,
- Shuarja e detyrimëve me parashkrim(prescriptio).

Të gjitha këto raste të shuarjes së detyrimëve mundësojnë që detyrimi të mos krijojë më efekte juridike, por efektet shuhen meqë marrëdhënia e detyrimit ngel si fakt.Përndryshe shuarja e detyrimëve me përmbushje është shuarja më normale e tyre, kurse ka raste kur kjo shuarje është jonormale, sepse shuhet nën ndikimin e rrethanave të ndryshme.Doktrina juridike kur shqyrton rrjedhën e shuarjes së detyrimëve në të drejtat nacionale bën grupimin e tyre në rastet kur shuarja shkaktohet në bazë të vullnetit të pjesëmarrësve, kurse në rastin tjetër kjo shuarje bëhet në kundërshtim me vullnetin e tyre.Ka shkenctar tjerë që rastet e shuarjes prap i ndajnë në dy grupe:

- Në grupin e parë bën pjesë shuarja e detyrimëve me përmbushje nga ana e debitorit, kurse
- Në grupin e dytë bën pjesë shuarja për shkak të mospërmbushjes së tij.

Lidhur me këtë ka të tjerë që theksojnë duke vënë në pah se detyrimet shuhen me përmbushje ose me mospërmbushje.Ne do të përkrahim qëndrimin se detyrimet mund të shuhen me vullnetin e pjesëmarrësve ,në kundërshtim me vullnetin e tyre ose me urdhër të ligjit.³⁰

Rregullat për shuarjen e detyrimëve pothuajse pa përjashtimë i parashohin LD dhe KC-të e të drejtave të ndryshme nacionale,(LMD nenet 284-309. KCSH nenet:455-475,508-529).

Këto rregulla parashohin edhe të drejta tjera nacionale, gjë që është edhe normale, sepse ato kanë vlerën e tyre teorike dhe praktike.Te këto rregulla nuk duhet haruar faktin se detyra shuhet kur përmbushet, meqenë se ajo shuhet edhe në rastet e parapara sipas ligjit.Me shuarjen e detyrës kryesore shuhet edhe dorzania, pengu dhe të drejtat tjera aksesore ,(neni 284,alineja,2).

Terminologjia për shuarjen e detyrimëve nuk është unike, sepse përdoren emërtime të ndryshme.Pos termit”shuarja e detyrimëve” përdoren edhe emërtimet siç janë :” mbarimi ose shuarja e detyrimit”,“shuarja e marrëdhënies së borxhit”,“shuarja e marrëdhënies judidiko-detyruese” dhe “extinction des obligation” në kuptim të shuarjes së detyrimëve.

Këto emërtime në esencë kanë domethënie të njëjtë, mirpo kanë nuancë se si kuptohen dhe cfarë domethënie konkrete kanë .Këto gjëra nuk duhet të lihen pas dore sepse emërtimi i saktë duhet të ketë saktësi profesionale dhe gjuhësore.Tani për tani ne do të përcaktohem i për emërtimin”shuarja e detyrimëve”,sepse na duket se është term më i qëlluar.

5.1. Shuarja e detyrimëve me përmbushje(pagesa).

Pagesa është mënyrë e zakonshme e kryerjes së detyrimëve e cila sjell në zhdukje borxhin.Nën pagesë duhet të kuptohet jo vetëm, si në gjuhën e përditshme ,mënyrë e pagesës së

³⁰ Prof.Dr. Alajdin Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 667.

një shumë parash, por edhe cilado mënyrë e kryerjes së një detyrimi. Është e sakt se shprehja nuk përdoret shumë për shërbimet, respektivisht ish detyrimet të bëhet madje edhe nëse , teknikisht, mund të përdoret shprehja e përgjithshme sipas së cilës kreditori duhet të paguaj borxhin e vet. Posaçërisht, për shërbime , mënyra konkrete e kryerjes është shumë e ndryshueshme varësisht nga marrëveshja, sepse kreditori duhet të bëjë sakt atë që është i detyruar ta bëjë. Rregullat e përgjithshme të pagesës janë më shumë të përshtatura në detyrimet ti dërgohet diçka debitorit, e madje edhe, më saktë, në detyrimet monetare.³¹

Duke trajtuar mënyrën e tillë të shuarjes së detyrimëve, do ti shqyrtojmë veçmas këto çështje:

- 1.Kuptimi
- 2.Natyra juridike e pagesës,
- 3.Subjektet e pagesës,
- 4.Lënda e pagesës,
- 5.Koha e përmbushjes,
- 6.Vendi i pagesës,
- 7.Efekti i pagesës, dhe
- 8.Vërtetimi i pagesës.

5.1.1.Kuptimi.

Pagesë do të thotë përmbushje, ekzekutimi i detyrimit. Pagesa si mënyrë e shuarjes së detyrimëve ka kuptim më të gjërë, se sa domethënia e saj në bisedën e përditshme. Ajo nuk do të thotë vetëm dorëzimi i shumës së caktuar të parave, e cila është lëndë e borxhit, por edhe kryerja e çdo veprimi tjetër, i cili mund të paraqesë përmbatjen e detyrimit (dorëzimin e ndonjë sendi tjetër, kryerja e ndonjë veprimi faktik apo juridik , mosbërja, abstenimi, pësimi). Në çdo rast përmbatja e pagesës është caktuar me përmbatjen e borxhit nga i cili rrjedh detyrimi.

Që veprimi i borxhliut të ketë domethënie e pagesës duhet që ajo të jetë ndërmarrë me qëllim që të bëhet shuarja (përfundimi) e detyrimit. Nëse te borxhliu nuk do të ekzistonte vullneti për pagesë , veprimi i ndërmarr do të ketë domethënie tjetër. Aty tani, do të ekzistonte qëllimi i debitorit që me kreditorin të krijojë ndonjë marrëdhënie të re detyrimi, e jo që të shuhet detyrimi ekzistues.³² Për këtë rast të shuarjes së detyrimëve në të drejtën nacionale ekzistojnë rregullativa: (LMD nenet: 285, 286).

Nga kjo rregullativë rrjedh padishim se ekzistojnë rregulla të përgjithshme lidhur me përmbushjen e detyrimëve, por rregulla që janë specifike të cilat edhe karakterizojnë këtë rast të shuarjes së detyrimëve. Nga kjo rregullativë gjithashtu rrjedh se potencohet shuarja e detyrimëve në këtë mënyrë ose sipas ligjit, sepse në këtë mënyrë kontribuohet së tepërmi për rregullsitë e shumta në qarkullim dhe në rrjedhën normale të tyre.

Sa i përket praktikës gjyqësore duhet thënë se pa ndonjë problem zbatohen rregullat e përmbushjes së detyrimëve në trajta dhe situata të ndryshme juridike. Kështu që mund të thuhet se ekzistojnë një traditë rreth zbatimit të qëlluar të rregullave të përmbushjes së detyrimëve.

³¹ Muriel Fabr-Manjan, E Drejta Obliguese, Shkup, 2007, fq. 586.

³² Dr, Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 238.

Mund të thuhet, gjithashtu, se ka raste kur gjyqtarët bënë interpretimin e gabueshëm të rregullave të përmbushjes së detyrimëve. Në këtë drejtim ekziston një praktik gjyqësore shumë e pasur e cila deshmton rrjedhën e mirë të zbatimit të këtyre rregullave.³³

5.1.2. Natyra juridike e përmbushjes.

Për natyrën juridike të përmbushjes së detyrimëve në doktrinë nuk ekziston qëndrim unik. Sipas një mendimi përmbushja e detyrimit ka karakter të punës së dyanshme juridike. Kështu është sepse debitori e ofron përmbushjen kurse kreditori e pranon atë, ndaj në këtë mënyrë shuhet detyrimi. Kjo teori është përkrahur në doktrinën juridike gjermane. Përndryshe ky mendim nuk përkrahet, sepse përmbushja e detyrimit nuk është punë e dyanshme juridike si dhe fakti se pranimi i përmbushjes nuk mund të krahasohet me kontratën. Kjo aq më tepër kur dihet se përmbushja e detyrimit mund të bëhet edhe pa pranimin e kreditorit, pa bashkëpunimin e tij, si dhe kundër vullnetit të tij. Në këto raste kryesore është kreditori të marrë atë çka kërkuar.

Ndërkaq, sipas mendimit të dytë përmbushja e detyrimit është një akt real që përfshinë dëshirën e debitorit që ta përmbush detyrimin animus solvendi. Pra, te përmbushja parimisht vlen deri te pajtimi i vullnetit të debitorit (solvensit), dhe të kreditorit (accipiensit). Por, duhet thënë se këto elemente nuk janë esenciale për përmbushjen e detyrimit, sepse te përmbushja kryesore është që detyrimi të realizohet dhe kështu debitori të lirohet nga obligimi që ka ndaj kreditorit.³⁴

5.1.3. Subjektet e pagesës.

Në pagesën e borxhit marrin pjesë dy persona: ai person që e paguan borxhin dhe, ai person kujt i bëhet pagesa.

-Ai person që e paguan borxhin: pagesën, sipas rregullës, e kryen borxhliu personalisht, ose nëpërmjet përfaqësuesit të vet. Ai është i autorizuar të ekzekutojë pagesën dhe që ta shtyjë kreditorin që të marrë pagesën. Nëse kreditori do ta refuzonte marrjen, do të ndodhë vonesa e kreditori. Që pagesën ta bënte në mënyrë plotëfuqishme debitori duhet që të posedoj aftësinë e plotë punuese. Nëse pagesën do ta ekzekutonte debitori me aftësi të kufizuar punuese, ose debitori plotësisht i paaftë për punë, kujdestari i tij mund të kërkojë kthimin e pagesës. Por, ka dhe situatë kur kujdestari i tij nuk mund të kërkojë kthimin e pagesës edhe kur pagesa e ekzekutuar do të jetë e vlefshme, edhe pse atë e ka ekzekutuar personi pa aftësi punuese.

Ajo do të jetë, nëse do të plotësohen këto kushte:

-Nëse borxhi është i padyshimt (i vërtetë) dhe

-Nëse ka arritur për pagesë.

Për borxhin e aritur dhe të padyshimtë pagesën e vlefshme mund ta bëjë edhe debitori pa aftësi punuese, sepse kjo do të jetë në interes të tij. Shtyerja e pagesës mund të sjellë krijimin e detyrave të reja pagesën e kamatës, shpenzimet kontraktuale. Ka raste, kur pagesën mund ta bëjë vetëm borxhliu, e askush tjetër në vend të tij. Kështu ndodh nëse detyra do të krijohej duke marrë parasyshë personalitetin e debitorit, ose kur është fjala për detyrën e mosbërjes (mosveprimit), pësimin (edhe këto detyra do të jenë të lidhura për personalitetin e

³³ Prof. Dr. Alajdin Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 668.

³⁴ Prof. Dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 670.

borxhliut, për shkak të vërteta, sepse është vështirë të mirret me mend se dikush tjetër do të bëjë diçka, ose që të pësoj në vend të debitorit, ashtu sikur kur është në pyetje edhe vetë debitori).

Përveç këtyre rastëve, pagesën mund ta bëjnë edhe ndonjë person tjetër në vend të debitorit. Aty gjithsesi së pari vijnë ata persona, të cilët do të kenë interes juridik që borxhi shuhet. E këta do të jenë: dorzani, pronari i sendit të luajtshtëm ose të paluajtshtëm të dhënë në peng, respektivisht në formë të hipotekës dhe kundërshtari i përzierjes në Padin Pauliane.³⁵ Përmbushjen mund ta bëjë edhe personi i tretë që nuk ka ndonjë interes të caktuar. Kështu ndodh kur ai për njërën ose për arsyen tjetër është i obliguar, që të përmbush detyrimin e vet. Për këtë arsye LMD në nenin 285, aline 1,2, ku parashikon dispozita :aline 1, detyrimi mund të plotësohet jo vetëm nga debitori, por edhe nga personi i tretë.

Alinea 2: po i njeiti nen: kreditori është i detyruar të marrë përmbushjen nga secili person i cili ka interes ligjor, detyrimi të jetë përmbushur edhe atë kur debitori e kundërshton atë përmbushje. Pra kjo dispozitë sanksionon se kreditori është i obliguar që të pranojë përmbushjen nga personi i tretë, me kusht se kreditori është i obliguar që të pranojë përmbushjen nga personi i tretë, me kusht që debitori të jetë dakord, përveç rastëve kur sipas kontratës ose natyrës së detyrës të detyrimit duhet ta përmbush personalisht vet debitori. Pataj kreditori mund ta pranojë përmbushjen nga personi i tretë edhe pa dijen e debitorit, si edhe në rastin kur debitori ka lajmëruar lidhur me këtë se nuk pranon që i treti ta përmbush detyrën e debitorit.

Por, duhet thënë se nëse debitori ofron që vetë ta përmbush menjëher detyrën e vet, atëherë kreditori nuk mund ta pranojë përmbushjen nga personi i tretë, (LMD I RM-së, neni 285, aline 3): kreditori është i detyruar të marrë përmbushjen nga një person i tretë, nëse debitori pajtohet me këtë, përveç kur sipas kontratës ose natyrës së vet detyrimit, nuk duhet ta përmbush debitori personalisht. Përndryshe është rregull e përgjithshme se kreditori është i obliguar ta marrë përmbushjen nga çdo person i cili ka ndonjë interes juridik që detyra të përmbushet, edhe atë në rastin kur debitori kundërshton këtë përmbushje.³⁶

Kreditore mund ta pranojë përmbushjen nga një person i tretë, pa dijen e debitorit edhe në rastet kur debitori e informon se nuk pajtohet për ta përmbush detyrimin e tij nga personi i tretë. (LMD-së, neni 285, aline 4). Në rast pagimit të borxhit nga ana e personit të tretë detyra ndaj kreditorit është shuar definitivisht, por kjo nuk don të thotë se debitori do të lirohet nga çdo detyrë (personi i tretë nuk e ka kryer, pagesën në vend të borxhliut me qëllim mirëbërës, që në atë mënyrë ti japë dhuratë). Personi i tretë e zë vendin e kreditorit të paguar, dhe debitori tani ka borxh pagesën e atij personi të tretë. Nëse personi i tretë do të kryente pagesën dhe atë e ka zënë vendin e kreditorit të paguar, do të kemi rastin e pagimit me subrogim (ndërrim).³⁷

-Përmbushja me subrogim.

Ligji për Marrëdhënie të detyrimeve, të RM-së, përmbushjen me subrogim e ka paraparë në (nenin, 288, aline 1) ku thuhet: në rast të përmbushjes së një detyrimi të huaj, çdo përmbushës mund të bëjë marrëveshje me kreditorin para përmbushjes ose pas përmbushjes, përmbushja kërkonë të kalojë në të gjitha ose në disa drejta sekondare. Nëse personi i tretë e bënë pagesën dhe e zë vendin e kreditorit të paguar, do të ekzistojë rasti i pagimit me

³⁵ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimeve, Prishtinë, fq. 239.

³⁶ Prof. Dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimeve, Prishtinë, 2002, fq. 670-671.

³⁷ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimeve, Prishtinë, fq. 239.

subrogim(ndërim).Subrogimi e ka domethënien e ndërimit, dhe mund të jetë i dy llojshëm: real dhe personal.

Subrogimi personal, paraqet ndërimin e personalitetit të kreditorit.Kështu ndodh kur dorëzani e ekzekuton detyrimin dhe ai vjen në vend të kreditorit, kurse pozita e debitorit fare nuk ndryshohet. Të drejtat e kreditorit mund të transferohen ekzekutuesit, dhe në bazë të kontratës mes debitorit dhe ekzekutuesit,përfunduar para përmbushjes,(alinea,2,po i njeiti nenë).Kur personi i tretë e paguan borxhin për debitorin dhe e zë vendin e kreditorit, krojohet ndërrimi personal.Borxhi shuhet ndaj kreditorëve të vjetër, por ndaj debitorit ngel i njejtë, por tani ndaj paguesit.Paguesi si kreditor i ri ka të drejtë të kërkojë nga debitori pagimin e borxhit.

Subrogimi real, paraqitet kur ndërrohet lënda, sendet e pagesës.Pagimi me subrogim mund të krijohet në tre mënyra :

- Subrogimi sipas urdhërit të ligjit(ex lege)
- Subrogimi me vullnetin e paguesit(ex contractus),
- Subrogimi me rastin e përmbushjes së pjesëshme.³⁸

Subrogimi ligjor, shkaktohet në bazë të dispozitës ligjore.Kështu ndodh kur detyrimin e përmbush dorëzani. Prej momentit të përmbushjes së detyrimit nga dorëzani, atëherë këtij i kalojnë si kërkesat kryesore ashtu edhe ato aksesore.

Për këtë rast të subrogimit LMD ka dispozitën në nenin 289, kur detyrimin do ta përmbush personi që ka interes juridik në të,në të ai kalon me vetë ligjin , në momentin e përmbushjes së kreditorit , kërkesë me të gjitha drejtat sekondare.Sipas kësaj dispozite kur detyrën e përmbush personi që ka ndonjë interes juridik në të , në të edhe kalon sipas ligjit kërkesa e kreditorit në momentin e përmbushjes me të gjitha përkesat aksesore.Sipas këtyrë rregullave as kreditori, as debitori nuk mund të pengojnë subrogimin ligjorë në rastin kur është caktuar që personi i tretë të përmbush detyrën e debitorit.Siç mund të vërehet, subrogimi këtu shkaktohet pavarësisht nga vullneti i debitorit dhe i kreditorit.

Subrogimi kontraktor: ky rast i subrogimit sanksionohet në LMD-së RM-së. Kurse sajohet në bazë të lidhjes së kontratës midis kreditorit dhe përmbushësit të detyrimit.Ndërsa pozita e debitorit ngel e njejtë, përveç faktit se debitori tani nuk duhet të përmbush detyrën ndaj kreditorit.Por, e drejta e kreditorit mund të kaloj te përmbushësi në bazë të kontratës së lidhur midis debitorit dhe përmbushësit që është lidhur para përmbushjes së detyrimit ,(LMD I RM-së neni288,alinea,2).Duhet të themi edhe se në këto raste të subrogimit të përmbushësit në të drejtat e kreditorit çdo gjë krijohet në momentin e përmbushjes.³⁹

Subrogimi në rastin e përmbushjes së pjesëshme të kërkesës së kreditorit mbi paguesin kalojnë të drejtat aksesore me të cilat sigurohet përmbushja e kësaj kërkesë , vetëm nëse nuk janë të nevojshme për përmbushjen e pjesës së ngelur të kërkesës së kreditorit(neni 290 LMD,al.1).Mjetet e provës në subrogimin e pjesëshëm, në bazë të pagesës së pjesëshme, po që se ka mundësi, e ndan atë me paguesin dhe me kreditorin në proporcion me vëllimin e të drejtave të tyre.Nëse në një gjë e tillë nuk është e mundur, kreditori këto mjete të provës ia dorëzon paguesit,duke dhënë edhe mjetet e sigurimit, siç janë:kaucioni, letrat me vlerë, deklarata e dorëzantit etj.⁴⁰

³⁸ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 265.

³⁹ Prof.Dr. Alajdin Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 672.

⁴⁰ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 266.

-Personit të cilit duhet ti bëhet pagesa.

Përmbushja duhet të kryhet nga kreditori ose personi i autorizuar sipas ligjit, me vendim të gjykatës, me marrëveshje ndërmjet kreditorit dhe debitorit, ose nga ana e vetë kreditorit. Përmbushja është e vlefshme edhe atëherë kur është përmbushur nga personi i tretë, nëse kreditori në vecanti e ka miratuar atë ose e ka shfrytëzuar atë, (LMD I RM-së, neni 294, al 1,2). Pagesa sipas rregullës, i kryhet kreditorit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar. Për të marrë pagesën e plotfuqishme, kreditori duhet që të posedoj aftësinë e plotë punuese.

Nëse debitori ia ka ekzekutuar pagesën kreditorit, i cili nuk e ka aftësinë e plotë punuese, do ti nënshtrohet rrezikut që të jetë i detyruar tja paguaj edhe një herë pagesën me kërkesën e përfaqësuesit të kujdestarit të kreditorit, nëse do të ndodhte që kreditori është krejtësisht i paaftë për punë dhe e ka shpenzuar sendin e marrë. Pagesa e kreditorit të paaftë për punë do të jetë e vlefshme vetëm në atë rast, nëse lënda e pagesës do të ndodhte në pasurinë e tij, ose do ishte e dobishme për të. Gjithashtu, debitori nuk mund që tja ekzekutojë pagesën e vlefshme kreditorit mbi pasurinë e të cilit është hapur falimentimi. Falimentimi ka për pasojë që ti mirret udhëheqja e pasurisë atij personi dhe ai nuk mund as që të marrë e as që të paguajë. Pra, kreditori i vërtetë në këtë rast nuk mund që ta marrë pagesën:

- nëse debitori dhe kreditori meren vesht ashtu, psh: banka nga e cila ka marrë hua kreditori,
- nëse është caktuar sipas ligjit, psh: poseduesit e paligjshëm të letrës me vlerë,
- nëse është caktuar me vendim gjyqësorë,
- nëse është caktuar nga vetë kreditori, psh me assignacion,
- nëse personi i tretë është cedent kurse debitori nuk është i njoftuar për cedimin,
- nëse kreditori më vonë e paraqet pagimin për personin e tretë .⁴¹

-Deponimi i borxhit.

Debitori ka mundsëi që në mënyrë të plotëfuqishme ta bëjë pagesën në gjykatë dhe të konsiderohet sikurse tja kishte bërë vetë kreditori. Ky është rasti i deponimit të borxhit. Për të bërë deponimi i borxhit duhet të plotësohen këto kushte:

- kreditori duhet të jetë në vonesë me marrjen e borxhit,
- kur nuk dihet se ku është kreditori,
- kur kreditori është i panjohur,
- kur kreditori është me paaftësi për të vepruar dhe nuk e ka përfaqësuesin e vet,
- kur është sendi i luajtshëm, i cili mund të ruhet lehtë (paratë, letrat me vlerë, sendet e çmueshme), dhe
- për deponimin e bërë debitori duhet ta njoftojë kreditorin në qoftë se di për të se vendbanimin e tij.

Deponimi bëhet në gjykatën e kompetencës lëndore në vendin e pagesës, përveç nëse arsyet e ekonomizimit ose natyrës së punës kërkojnë që deponimi të bëhet në vendin ku gjendet sendi. Përveç deponimit të rregullt në gjykatë, ekziston edhe deponimi duke ia dhënë sendin subjektit tjetër, e ky quhet: deponim me ndërmjetësim-sekuestrim. Këtu hynë rastet e deponimit të sendit të huaj në ruajtje, psh: drithërat, materiali ndërtimor. Ruajtësin-sekuestrimin duhet ta caktoj gjykata me kërkesë të debitorit, i cili ruatjen e bën në llogari dhe me shpenzime të debitorit. Parimisht, shpenzimet e deponimit të sendit të borxhit i bart debitori. Shpenzimet e

⁴¹ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 240.

deponimit në gjykatë i heq kreditori në qoftë se këto i kalojnë shpenzimet e përmbushjes së rregullt të detyrimit të debitorit. Debitori ka të drejtë ta revokojë deponimin, derisa kreditori nuk deklaron se e pranon sendin e deponuar si pagim borxhi, përkatësisht deri sa të merret vendimi gjyqësor me të cilin vendoset se kujt do ti takojë aj send.⁴²

5.1.4. Lënda e përmbushjes.

Lënda e përmbushjes është ajo që debitori i ka borxh kreditorit. Lënda e përmbushjes inicon çështje të ndryshme rreth saj siç janë :

- përmbatja e detyrës ,(LMD i RM-së, neni, 296),
- zëvendësimi i përmbushjes, (LMD i RM-së neni, 297),
- dorëzimi për shitje (LMD i RM-së neni, 298),
- përmbushja e pjesëshme (LMD i RM-së neni, 299),
- detyra e dhënies së sendit të caktuar sipas llojit(LMD i RM-së neni, 300).

Këto çështje shtrojnë çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me përmbushjen e detyrimëve. Këto çështje të të përmbushjes së detyrimëve kanë vlerë të caktuar tertike dhe praktike, andaj edhe do të mundohemi ti realizojmë veç e veç. Kur diskutohet për përmbatjen e detyrës, atëherë duhet thënë se përmbushja në këtë rast përbëhet nga ekzekutimi i asaj që është përmbatja e detyrës dhe, parimisht, këtë teori nuk mund ta përmbushë me diç tjetër, as që kreditori mund të kërkojë diç tjetër, (neni 296). Pra, debitori duhet ta përmbush atë që ka borxh, sepse ai është përmbatja e detyrës së tij, kurse kreditori duhet të kërkojë ekzekutimin e lëndës së përmbushjes e jo diç tjetër. Për këtë arsye edhe thuhet se nuk ka përmbushje të plotëfuqishme në qoftë se atë që e ka dorëzuar debitori si sendin e borxhit dhe atë si të tillë e ka marrë edhe kreditori, kurse në esencë nuk është lënda e përmbushjes, atëherë edhe kreditori ka të drejtë ta kthejë atë send prapa dhe të kërkojë dorëzimin e sendit të borxhit, (neni 297).

Siç mund të vërehet, për përmbushje të plotëfuqishme është e nevojshme që debitori të përmbush sendin e borxhit, ndërsa kreditori është i autorizuar gjithashtu të kërkojë lëndën e përmbushjes, sepse ajo është përmbatja e detyrës së debitorit. Nëse ndodh që debitori ti dorëzojë kreditorit ndonjë send ose ndonjë të drejtë tjetër që ai ta shesë dhe nga çmimi i realizuar të inkasoj kërkesën e vet, kurse pjesën e ngelur të çmimit tia dotëzojë debitorit. Kurse vet detyra shuhet në momentin kur kreditori e inkason kërkesën e vet nga shuma e realizuar te kjo shitje ,(neni, 298). Siç mund të vërtetohet përmbushja e detyrës së debitorit ndonjëherë mund të bëhet edhe duke shitur sendin e debitorit dhe nga çmimi i realizuar hiqet kërkesa e kreditorit dhe shpenzimet eventuale rreth shitjes, kurse pjesa tjetër e këtij çmimi i kthehet debitorit.⁴³

Kreditori, sipas rregullave të përmbushjes duhet të realizoj kërkesën në tërësi. Ky realizim bëhet nëse debitori e përmbush detyrën e vet si është përmbatja e saj. Andaj, ekziston edhe rregulla se kreditori nuk është i detyruar që ta pranojë përmbushjen e pjesshme të detyrimit, përveç nëse nuk e kërkon apo nuk e imponon ndryshe natyra e detyrës, (neni, 299).

Pra, këtu rregulla thotë se kreditori ekzekutimin e pjesshëm mund ta refuzojë, por do ta pranojë këtë ekzekutim nëse natyra e marrëdhënies e lejon këtë. Kreditori është i autorizuar të marrë pagesën e plotë. Kreditori mund të refuzojë marrjen e pagesës së pjesëshme, përveç rastit kur është fjala për detyrim me para, detyrimet suksesive, në rastet kur debitori dhe kreditori merren

⁴² Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 267-268.

⁴³ Prof.Dr. Alajdin Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 675-676.

vesh që detyrimin ta përmbushin, si psh: kontrata mbi shitjen me kredi, në kontratat mbi huanë që huaja të kthehet në pjesën alikuote.⁴⁴

Zëvendësimi i përmbushjes(datio in solutum): në të drejtën klasike romake lejohej që palët të kontraktojnë të ashtu quajturën facultas alternative. Në raste të tilla debitori mund të lirohej prej detyrimit, kur kreditori në vend të asaj që me të vërtetë e kishte borxh, i jepte ndonjë send tjetër, që kreditori e merrte me kusht që detyrimi të shuhet. Dhënia e këtillë e ndonjë sendi tjetër, në vend të pagimit të borxhit, quhet datio in solutum voluntaria dhe shërbente si mënyrë e shuarjes së detyrimëve ipso jure. Në të drejtën e Justinianit, përveç datio in solutum voluntaria apo marrëveshjes vullnetare të palëve për shuarjen e obligatës me të dhënë të ndonjë sendi që në të vërtetë nuk kishte objekt borxhi, ekzistonte edhe datoi in solutum necessaria. Datio in solutum necessaria parashikohej në dobi të pronarëve të tokave të ngopur me borxhe. Pronarët e tokave të ngopur me borxhe kishin të drejtë që në vend të pagimit të të hollave në dorë tu japin kreditorëve parcela toke, të vlerësuara me ndërgjegje zyrtarisht.⁴⁵

Dhënia për përmbushje: ekzistonë kur debitori ia dorëzonë kreditorit ndonjë send ose i cedon kërkesën me qëllim që kreditori atë send tja shesë e ta marrë kërkesën, kështu nga ajo që ka fituar ta marrë pagesën për veti, e që tepricën eventuale tja kthejë debitorit(psh : debitori ia dorëzon kreditorit stilografin e vet që ky ta shesë dhe që shumën e marrë ta përdorë për plotësimin e kërkesave të veta nga kontrata mbi shitjen.)⁴⁶Për shembull: debitori ia dorëzon kreditorit veturën e vet që ta shes dhe që me shumën e marrë ta realizojë kërkesën e vet, kur pjesën e mbetur të çmimit tja kthejë debitorin. Në dhënien për përmbushje kreditori merr përitje të autorizuarit të debitorit. Dhënia për përmbushje nuk është surogat i përmbushjes sikurse ndërrimi i përmbushjes. Ajo nuk e sjell drejtëpërdrejtë shuarjen e detyrimit sikurse datio in solutum, por tërthorazi mund të bëhet shuarja e detyrës, nëse kreditori do të paguaj nga pasuria e ceduar e debitorit.⁴⁷

5.1.5.Koha e përmbushjes

Kur diskutohet për vendin e përmbushjes duhet të kihet parasysh rasti:

- kur afati është caktuar për përmbushje ,
- kur ekziston mundësia e përmbushjes para afatit,
- kur kreditori e kërkon përmbushjen para afatit,
- kur kemi rastin e caktimit të afatit nga debitori ose kreditori dhe
- kur janë rastet e përmbushjes së detyrimëve në të holla.⁴⁸

Detyrimi i krijuar ndërmjet kreditori dhe debitorit duhet të ekzekutohet në afat të caktuar. Afat i pagesës është intervali kohor brenda të cilës duhet të përmbushet detyrimi.

Afatin e pagesës e caktojnë debitori dhe kreditori me marrëveshjen e tyre. Ky afat quhet i kontraktuar, në të cilën debitori dhe kreditori duhet të përmbahen patjetër afatit të caktuar që do të thotë se debitori nuk do të jetë i detyruar të bëjë pagesën para afatit kontraktues, kurse kreditori as që mundet ta kryejë pagesën para afatit. Koha e pagesës mund të jetë e caktuar: në mënyrë absolute- dies certus quando dhe relative. Në mënyrë absolute është e caktuar kur është e

⁴⁴ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 268.

⁴⁵ Dr. Ivo Puhani, E Drejta Romake, Prishtinë, 1989, fq. 397.

⁴⁶ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 242.

⁴⁷ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 269.

⁴⁸ Prof.Dr. E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 683.

fiksuar kalendarisht, psh: 31 tetor 1998, ose në fund të nëntorit, kurse relativisht nëse lidhet me ndonjë ngjarje të caktuar ,psh :tre muaj pas martesës së kreditorit.⁴⁹

-Kur egziston mundësia e përmbushjes para afatit: në rastet kurë afati kohor është rënë dakord ekskluzivisht në interes të debitorit , ai ka të drejt të bëjë përmbushjen para afatit të kontraktuar ,por është i detyruar ta informoj kreditorin për qëllimin e tij .Në raste tjera kur debitori do te ofroj përmushje para afatit ,kreditori mund të refuzoj përmbushjen , dhe gjithë ashtu mund të mbaj të drejtën e kompensimit të dëmit, nëse ai duhet ta njoftoj debitorin pa vones,(LMD-së i RM-së ,neni, 304,alinea ,1,2).Nëse debitori dhe kreditori nuk e kanë caktuar kohën e pagesës, atëherë atë ndonjëherë e bën ligji(detyra e ushqimit mbatjes paguhet suksesivisht në fillim të çdo muaji), ndërsa ndonjëherë caktohet sipas natyrës së bëmjes(blerja e drithit që korret në vitin 1969, drithi ka për tu dorëzuar pas kryerjes së korrjes).

-Kreditori ka të drejt të kërkoj përmbushjen para afatit, nëse debitori nuk e ka dhënë sigurin e premtuar, ose sipas kërkesës së tij nuk ka plotësuar sigurin e reduktuar pa fajin etij , si dhe kur afati kohorë është rënë dakord ekskluzivisht në interes të tij. (LMD-së i RM-së ,neni, 305).Nëse koha e pagesës nuk mund të caktohet as edhe në këtë mënyrë, detyrimi arrin për pagesë, pasi të sajohet.Kjo do të thotë praktikisht se kreditori mund të kërkoj pagesën menjëher, e gjithashtu edhe debitori mund që ta kryejë pagesën menjëher.Debitori do të jetë i detyruar që ta kryejë pagesën, kur kreditori ia tërheq vëretjen, ashtu si që është i detyruar kreditori ta marrë pagesën, kur debitori ia ofron përmbushjen.Në të kundërtën do të shkaktohet vonesa me të gjitha pasojat e dëmshme, si për debitorin , ashtu edhe për kreditorin.⁵⁰

-Caktimi i afatit nga debitori ose kreditori: gjatë përcaktimit të kohës për përmbushje i lihet vullnetit të kreditorit ose debitorit, ose personi tjetër, nëse personi i autorizuar nuk e ka përcaktuar afatin, urdhëron të kërkoj nga gjykata të përcaktoj një kohë të arsyeshme për të përmbushur.(LMD-së i RM-së ,neni, 306).

-Nëse pagesa bëhet me ndërmjetësimin e një bankë ose shtëpi kursimi kur ajo është duke u kryer llogaria e kreditorit do të llogaritet nëse palët kontraktuese nuk e kanë caktuar ndryshe që borxhi të zgjidhet kur banka, dmth shtëpia e kursimit ku mbahet llogaria do të arihet detyrimi në para në favor të d ebitori ose kreditorit ose shtëpis së kursimit për të miratuar shumën e treguar në llogarin e kreditorit me urdhër.

-Nëse kontrata e përcakton pagesën me post ,supozohet se palët u pajtuan që duke paguar shumën që i detyrohen debitorit me post, ka shlyer detyrimin ndaj kreditorit nëse një metod e tillë e pagesës nuk është dakord, borxhi zgjidhet kur kreditori merr detyrimin monetar.

Nëse një rregullore ose një kontrat parashikon një pages me një fletëkontroll në llogari të caktuar,supozohet se palët janë pajtuar se pagesa është kryer kur debitori do të paguaj shumën që i detyrohet një kontroll përfitojnë në llogarin e shënuar.(LMD-së i RM-së ,neni, 306,alinea1,2,3).

5.1.6.Vendi i përmbushjes

Te përmbushja e detyrimëve me rëndësi është edhe vendi i përmbushjes së tyre. Për këto çështje ekzistojnë dispozita në të drejtën nacionale (LMD I RM-së,neni308-309).Nga kjo rregullativë rrjedh se ekzistojnë rregulla të përgjithshme për vendin e përmbushjes së detyrimëve dhe rregulla shpecifike për vendin e përmbushjes së detyrimëve në të holla.Këto janë çështje që

⁴⁹ Dr.Sc. E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 269.

⁵⁰ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 243.

shprehin vlerën teorike dhe praktike të këtyre rregullave si dhe specifikat e tyre në raste dhe situatë të ndryshme.⁵¹Debitori është i detyruar që detyrimi duhet të përmbushet në vendin ku është caktuar: sipas marrëveshjes së debitorit dhe kreditorit, ose sipas ligjit.

Kur vendi i përmbushjes nuk është i përcaktuar dhe nuk mund të përcaktohet sipas qëllimit të punës,natyrën e detyrimit ose rrethanave tjera përmbushja e detyrimit kryhet në vendin kur debitori në kohën e ndodhjes së obligimit kishte selinë, vendbanimin.(LMD i RM-së,neni308,aline,1,2).Nëse debitori është person juridik që ka shumë njësi në vende të ndryshme si vend i përmbushjes do të konsiderohet secila e njësive për të kryer veprimet e domosdoshme për përmbushjen e detyrimit nëse kreditor atë rrethan para nënshkrimit të kontratës për atë ka qenë i njohur apo patjetër duhet të jetë e njohur,(po i njejt i nenë ,aline,3).

Kur vendi i përmbushjes nuk është caktua me punë juridike e as me ligj, ai caktohet në bazë të qëllimit të detyrimit, natyrës së detyrës dhe në bazë të rrethanave të tjera.Sipas natyrës së detyrimit, vendi i përmbushjes caktohet në këtë mënyrë:

-nëse sendi është i paluajtshëm,

-nëse vendi i përmbushjes është vendi ku ndodhet sendi i tillë-locus rei site.

Kur është i luajtshëm, vendi i pagesës është vendi ku është lidhur kontrata.Detyrimet me para përmbushen ne vendin në të cilin kreditori e ka vendbanimin, e në munges të vendbanimit, në vendqëndrimin e tij(LMD i RM-së,neni 309,aline,1).Nëse pagimi bëhet me virman, detyrimet me para bëhen në selin e organizatës tek e cila janë mjetet në para të kreditorit(LMD i RM-së,neni 309,aline,2). Por,nëse kreditori ndryshon vendin ku ai kishte selin e tij pra vendëbanimin në kohën kur u ngrit detyrimi,dhe për këtë arsye u riten shpenzimet e përmbushjes kjo rritje bie mbi barën e kreditorit.(LMD i RM-së,neni 309,aline,3).

5.1.7.Efekti i pagesës

Çështja e efektit të pagesës ndërlikohet kur ndërmjet debitorit dhe kreditorit ka më shumë marrëdhënie detyrimi dhe debitori e kryen pagesën e pjesëshme me të cilën nuk i ka plotësuar të gjitha detyrat e veta.Në këtë rast shtohet çështja e llogaritjes(imputacionit) së pagesës së kryer që bëhet me marrëveshjen e debitorit dhe kreditorit. Nëse nuk ekziston marrëveshja, do të zbatohen keto rregulla:

-Në qoftë se nuk ekziston deklarata e debitorit për llogaritjen e përmbushjes, së pari përmbushen kërkesat e arritura sipas radhës për përmbushje,

-Në qoftë se njëkohësisht arrijnë më shumë detyra , së pari përmbushen detyrimet më pak të siguruara, e kur të gjitha sigurohen njësoj, së pari përmbushen ato që janë barrë më e madhe për debitorin,

-Në qoftë se detyrimet janë të barabarta në të gjitha aspektet, përmbushen sipas radhës që janë krijuar, e nëse njëkohësisht janë krijuar, atëherë ajo që është dhënë në emër të përmbushjes radhitet në të gjitha detyrimet proporcionalisht me shumën e tyre.⁵²

⁵¹ Prof,Dr. Alajdin.S Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 687.

⁵² Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 271.

5.1.8.Vërtetimi i pagesës.

Kur debitori përmbush detyrimin e vet ashtu siç është, atëherë detyrimi shuhet dhe ai lirohet nga obligimi ndaj kreditorit. Mirëpo, te përmbushja e detyrimeve për hir të sigurisë së caktuar, debitori ka të drejtë të kërkojë vërtetimin ose dëftesën nga kreditori se e ka përmbushur detyrimin e vet. Rreth vërtetimit të përmbushjes ekzistojnë rregullativa të caktuara në të drejtën nacionale, (LMD i RM-së, nenet 310, 311). Sipas rregullave të (LMD-së i RM-së neni 310, alinea, 1), ku thuhet: kush e përmbush detyrimin në tërësi ose pjesërisht ka të drejtë të kërkojë që kreditori për këtë të lëshojë vërtetimin me shpenzime të veta. Sipas kësaj dispozite, si për përmbushjen në tërësi, ashtu edhe për përmbushje të pjesshme, debitori mund të kërkojë nga kreditori vërtetimin se e ka përmbushur detyrimin e vet. Këtë obligim kreditori duhet ta bëjë në mënyrë të rregullt.

Debitori që përmbushi detyrimin monetar nëpërmjet bankës ose postës, ka të drejtë të kërkojë kreditorit fletë vërtetimi me shpenzimet e veta, nëse metvertet ka ndonjë arsye, (po i njëjti nen, alinea, 2). Pra këtu mund të kërkojmë vërtetimin për përmbushje vetëm nëse ka ndonjë arsye, por nuk mundet në çdo rast të kërkojë, pra vetëm kur dyshonë në sjelljen e kreditorit mund të kërkojë nga ai vërtetimin e caktuar. Në qoftë se është dhënë vërtetimi se tërësisht është paguar borxhi kryesor, supozohet se është paguar kamata, shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet të tjera, (po i njëjti nen, alinea, 3). Kështu është sepse kur paguhet borxhi kryesor duhet të paguhet edhe borxhet aksesore. LMD i RM-së neni 310, alinea, 4, ku thuhet: në qoftë se debitori i dhënies të kohëpaskohshme, siç janë qiraja dhe kërkesat tjera që llogariten kohëpaskohe, siç janë harxhimet e energjisë elektrike, të ujit ose përdorimi i telefonit, ka vërtetimin se ka paguar kërkesën arritur më vonë, supozohet se ka paguar edhe ato kërkesa që janë arritur për përmbushje më vonë.

5.2. Shuarja e detyrimeve me kompensim(compensation).

Compensatio apo kompensimi i borxhit me borxh është mënyrë e shuarjes së detyrimeve me shkelje apo anulim reciprok të borxheve dhe aktivëve: debiti et crediti inter se contribution. Në të drejtën e lashtë romake kompensimi mund të bëhet vetëm me marrëveshjen e palëve.⁵³ Debitori mund të anulojë kërkesën që e ka kundër kreditorit me atë që ai të kërkojë prej tij, nëse të dy pretendimet janë para ose sende tjera të këmbyeshme të njëjtit lloj dhe me cilësi të njëjtë. (LMD i RM-së, neni, 325). Kompensimi eviton dy pagesa në kahë të kundërt.

Ndërprerja, në këtë mënyrë, është e tërësishme për të dy detyrimet reciproke të shumës së njëjtë, e vetëm pjesërisht në rast të kundërt. Lëmia e mbrojtjes së kompensimit është pagesa e të hollave: nëse personi A i detyrohet 1000e personit B, edhe pse B fiton 600 nga personi A, kompensimi mund të ndërrojë këto dy detyrime me pagesë të vetme të A për B prej 400e.

-Kompensimi është mënyrë e pagesës sepse pas neutralizimit të borxheve të tyre, të dyja palët i kryejnë detyrimet e veta.

-Kompensimi është një lloj forme e shkurtuar e pagesës.

-Palët mund të heqin dorë prej njëres.⁵⁴

⁵³ Dr. Ivo Puhani, E Drejta Romake, Prishtinë, 1989, fq. 399.

⁵⁴ Muriel Fabr-Manjan, E Drejta Obliguese, Prishtinë, 2007, fq. 596.

Kompenzimi nuk ndodhë sapo të plotësohen kushtet, por është e nevojshme njëra palë ti thotë palës tjetër që bënë kompenzimë. Pas deklaratës për kompenzim konsiderohet se kompenzimi ka ndodhur në atë moment, kur janë plotësuar kushtet për të. (LMD i RM-së, neni, 326).

Kushtet e kompensimit: Për të ekzistuar kompensimi duhet të plotësohen këto kushte:

- Të ekzistojë marrëdhënia midis debitorit dhe kreditorit.
- Kërkesat midis tyre të jenë reciproke,
- Kërkesat të jenë të njëllojta,
- Kërkesat të jenë likuide,
- Kërkesat të jenë të arritura për përmbushje,
- Kërkesa për kompensim duhet të jenë të mundshme.⁵⁵

Kushtet kanë vlerë të caktuar si teorike, ashtu edhe praktike andaj edhe do ti analizojmë veç e veç.

-Të ekzistojë marrëdhënia midis debitorit dhe kreditorit: është kusht me rëndësi për ekzistimin e kompensimit në marrëdhëniet e detyrimëve. Kjo marrëdhënie duhet të jetë edhe e plotëfuqishme dhe me të vërtetë të ekzistojë. Nga kjo rrjedh se ky kusht më shumë duhet të konsiderohet si rregull e përgjithshme për këtë rast të shuarjes së detyrimëve.

-Kërkesat midis tyre të jenë reciproke: do të thotë se debitori ka kërkesë ndaj kreditorit, të cilit edhe ai i ka borxh. Por, debitori mund ta rrafshojë kërkesën e vet me kërkesën, të cilën kish për të pasur kreditori ndaj tij. Nuk do të ekzistojë reciprociteti, kur kreditori do ti kishte borxh personit të tretë, ndërsa ky, i treti do ti kishte borxh debitorit të vet. Së këndejmi, debitori solidar nuk mund të thirret për rrafshimin kompenzimin e kërkesës, të cilën bashkëborxhliu i tij do ta kishte ndaj kreditorit. Përgjithësi nga kjo do të ekzistonte te cedimi i kërkesave (cesioni): debitori i ceduar (cesus) mund ta rrafshonte kërkesën, të cilën e ka ndaj kreditorit të përparshëm dhe ndaj kreditorit të rinj (cesionarit), nëse nuk ka ditur për cedimin, ndërsa kërkesa e tij ka arritur para dijenisë dhe para cedimit të kërkesës.⁵⁶

-Kërkesat të jenë të njëllojta: njëllojshmëria e kërkesave është kur janë kërkesat në para dhe kërkesat të cilat kanë si lëndë sende të luajtshme. Kompenzimi nuk bëhet nëse kërkesat janë me lëndë të ndryshme dhe ato në të cilat sendet janë individualisht të caktuara. Në ato raste kur kërkesat e debitorit dhe të kreditorit janë me para në valut të ndryshme, ato mund të kompensohen sepse janë kërkesa të njëllojta. Njëllojshmëria e kërkesave nuk do të thotë se ato duhet të burojnë prej bazës së njëjtë juridike. Pra, mund të rrafshohen dy kërkesa me para edhe pse njëra nga kontrata e tjera nga delikti, njëra nga kontratat mbi shitjen e tjetra nga kontrata mbi huanë.⁵⁷

-Kërkesat të jenë likuide e pastër, e vërtetë (d.m.th: se palët i kanë borxh njëra tjetrës kërkesa, të cilat ekzistojnë pamëdijshje, përmbatja e të cilave është e caktuar, si sipas bazës, edhe sipas lartësis. Nëse ndonjë kërkesë do të jetë kontestuese, prandaj do të jetë nevoja që të vërtetohet, ajo nuk kishë për të qenë likuide, kështu që me të nuk mund të bëhet kompenzimi. Gjithashtu, nuk do të e mjaftojë që kërkesa vetëm të ekzistojë, por do të jetë nevoja që të dihet edhe shuma e saj. Likuiditeti i kërkesave në disa të drejta nuk konsiderohet si kusht esencial për kryerjen e kompenzimit. Konsiderohet se është kusht i natyrës procedurale.⁵⁸

-Kërkesat të jenë të arritura për përmbushje: është kusht me rëndësi që kërkesat e debitorit dhe të kreditorit të jenë të arritura për përmbushje. Ky kusht kërkohet në të gjitha të drejtat

⁵⁵ Prof. Dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 689.

⁵⁶ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 246.

⁵⁷ Dr. Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 274.

⁵⁸ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 246.

nacionale,ndërkaq themi se kërkesa ka arritur për përmbushje kur ka kaluar afati për përmbushjen e detyrimit. Kjo rregull vlen vetëm në detyrimet që janë të afatizuara.Ndërkaq në detyrimet që nuk janë të afatizuara, atëherë kërkesat e tyre arrijnë për përmbushje kur debitori dhe kreditori kërkojnë përmbushjen, përkatësisht kompensimin e ketyre kërkesave.⁵⁹

-Kërkesa për kompensim duhet të jenë të mundshme: në çdo marrëdhënie detyrimi kur plotësohen kushtet e latëpërmendura, atëher mund të vijë deri te kompensimin i kërkesave.

Kompensimi bëhet vetëm në kërkesat që mund të kompensohen. Kështu dorzani mund të bëjë kompensimin e detyrës së debitorit ndaj kreditorit me kërkesën e debitorit nga kreditori, (neni 327,i LMD-së).Madje, ai që ka dhënë sendin e vet peng për detyrën e huaj, mund të kërkojë nga kreditori tia kthejë sendin e pengut kur janë plotësuar kushtet për shuarjen e kësaj kërkesë me kompensim, si dhe kur kreditori me fajin e vet e realizon kompensimin, (neni 327,aline,3 i LMD-së).Pastaj, debitori kërkeën e bartur mund tia kompensojë cesionarit me ato kërkesa të veta të cilat deri në lajmërimin për cedim ka mundur tia kompensojë cedimin,(neni 327,aline,1 i LMD-së).Ai mund të kompensojë edhe ato kërkesa të veta nga bartësi të cilat i ka fituar para lajmërimit për cedim, afati për përmbushje i të cilit nuk ka arritur në momentin kur është lajmëruar për cedim, me kusht që ky afat bie para afatit të përmbushjes së kërkesës së bartur ose njëkohësisht në të.

Dhe në fund, në qoftë se kërkesa e bartur është regjistruar në librat publikë, debitori mund tia bëjë kompensimin marrësit(cesionarit), vetëm në qoftë se kërkesa e tij është regjistruar te kërkesa e bartur ose në qoftë se marrësi është informuar gjatë bartjes për ekzistimin e asaj kërkesë, (neni327,aline,2 i LMD së RM-së).

Llojet e kompensimit: Kompensimi i kërkesave mund të bëhet në tri mënyra:

- Me vullnetin e palëve,
- Në bazë të ligjit,
- Në bazë të vendimit gjyqësorë.

Varësisht nga mënyra e krijimit ,ekziston kompensimi :

- Kontraktor,
- Ligjorë dhe
- Gjyqësorë.

-Kompensimi kontraktorë(pactum de compensando)me të cilën merren vesh për kompensimin e kërkesave të tyre reciproke.Në atë rast ata ë vërtetojnë edhe kushtet e rrafshimit, kështu që nuk janë të detyruar tu kushtojnë kujdes të gjitha kushtëve për rrafshim, të cilave u kushtohet kujdes kur është fjala për kompensimin ligjor dhe gjyqësor.⁶⁰

-Kompensimi ligjor(compensation ex lege): ky rast i kompensimit eksiston kur në bazë të të dispozitave ligjore kompensohet kërkesat reciproke të debitorit dhe të kreditorit.Ky kompensim është kompensim automatik, sepse bëhet me urdhërin e ligjit.Debitori dhe kreditori këtij kompensimi nuk mund tui kundërvihen.Për këtë arsye kompensimi ligjor konsiderohet si rast i inkasimit me dhunë të borxhit ose kërkesës.Ky rast i kompensimit në një mënyrë i kundërvihet parimit të autonomis së vullnetit .⁶¹

-Kompensimi gjyqësor do të thotë:se rrafshimi është bërë sipas vendimit gjyqësor.Edhe këtu nevojitet deklarata e njëres nga palet me qëllim që të bëhet rrafshimi.Atë e bën debitori, kështu që kur të paditet nga ana e kreditorit për pagimin e kërkesave, paraqet ndaj tij kundër-

⁵⁹ Prof.Dr. Alajdin S Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 691-692.

⁶⁰Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 275.

⁶¹ Prof.Dr. Alajdin S Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 696.

kërkesën e vet dhe kërkon që me rastin e vendimit mbi kërkesën e kreditorit të mirret parasysht edhe kundërkërkesa e tij.⁶²

Rastet në të cilat nuk mund të bëhet kompensimi: ka raste në të cilat sado që janë plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme për kompensim, rrafshimi i kërkesave nuk mund të realizohet, në këto raste:

- Kur kreditori dhe debitori merren vesh për disa kërkesa të cilat nuk mund të kompenzohen(pactum de non compensando);

- Kërkesat që për lëndë të detyrimit kanë aso sendesh të cilat nuk mund të kompensohen;

- Kërkesat e sendeve të cilat i janë dhënë debitorit për ruajtje ose për shërbim, ose që i ka ndaluar debitori në mënyrë të padrejtë;

- Kërkesat që rrjedhin nga shkaktimi doloziv i dëmit;

- Kërkesat e shpërblimit të dëmit të shkaktuar me dëmtimin e shëndetit ose me shkaktimin e vdekjes;

- Kërkesa që rrjedh nga detyrimi ligjor për mbajtje(LMD i RM-së, neni 330, alinea, 1, 2, 3, 4, 5)

Efektet e kompensimit: kompensimi ka për pasojë që kërkesat reciproke të palëve të shuhen, nëse janë me volum të njëjtë. Nëse kërkesat nuk do të jenë të njëjta sipas volumit, atëherë do të bëhet shuarja e kërkesës më të vogël, kështu që më e madhja do të zvogëlohet për atë pjesë sa ka qenë kërkesa më e vogël dhe do të mbetet në atë pjesë, e cila e tejkalon kërkesën e shuar. Nëse me rrafshim do të shuhej kërkesa kryesore, atëherë do të shuhej edhe tërë kërkesa aksesore(dorzanja, pengu) etj. Shuarja me kompenzim mund të bëhet edhe në rastin kur kërkesa është ceduar shumë herë dhe kjo, vetëm nëse ekziston reciprociteti i kërkesave midis poseduesit të parë dhe atij të fundit të kërkesës së ceduar.⁶³

5.3.Shuarja e detyrimëve me faljen e borxhit(remissio).

5.3.1.Nocioni i faljes së borxhit

Falja e borxhit është mënyra vullnetare e shuarjes së detyrimëve në bazë të deklaratës së kreditorit me të cilën deklaron se nuk ka për të kërkuar kurrfarë pagese nga debitori, (LMD i RM-së, neni 333, alinea, 1). Për faljen e borxhit është e domosdoshme deklarata mbi pelqimin e debitorit dhe kreditorit. Në rast se nuk ekziston pelqimi i debitorit, deklarata e kreditorit nuk do të paraqes faljen e borxhit për premtimin njëanshëm të kreditorit dhënë debitorit se prej tij nuk ka për të kërkuar pagimin e kërkesës: pactum de non petendo. Për faljen e borxhit duhet të lidhet kontrat ndërmjet debitorit dhe kreditorit, kurse për vlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje nuk është e nevojshme të lidhet në formën sipas së cilës është krijuar detyra, (LMD i RM-së, neni 333, alinea, 2). Kontrata mund të lidhet gojarisht, me skrim, drejtpërdrejt ose nëpërmjet gjykatës. Falja e borxhit mund të ketë baza të ndryshme, por në shumicën e rastëve bëhet me qëllim që debitorit ti jepet dhuratë(animus donandi), punë juridike mirëbërëse, por falja e borxhit mund të bëhet edhe me shpërblim kur kreditori i fal debitorit një borxh më të vogël që ai tia paguaj borxhin tjetër më të madh.⁶⁴

⁶² Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 248.

⁶³ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 248

⁶⁴ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 277.

5.3.2.Kushtet për faljen e borxhit.

Për të ekzistuar falja e borxhit duhet të ekzistojnë këto kushte:

- të egzistoj marrëdhënia juridike midis debitorit dhe kreditorit dhe
- të lidhet kontrata e re midis debitorit dhe kreditorit për faljen e borxhit.

Ekzistimi i marrëdhënies juridike është kushtë elementar për faljen e borxhit. Kjo marrëdhënie juridike midis tyre duhet ti paraprijë faljes së borxhit dhe kjo marrëdhënie duhet të jetë e plotëfuqishme.Lidhja e kontratës së re midis debitorit dhe kreditorit për faljen e borxhit është kushte që sanksionohet, gjë që është normale, sepse shuhet kështu marrëdhënia ekzistuese midis debitorit dhe kreditorit.⁶⁵

5.3.3.Llojet e faljes së borxhit.

Llojet e falje së borxhit klasifikohen sipas kriterëve të cakuara, sic janë:

1.Pjesmarja e një ose më shumë kreditorëve në faljen e borxhit,

- falje individuale,
- falje kolektive.

2. Vëllimi i borxhit:

- falje e plotë,
- falje e pjesëshme e borxhit.⁶⁶

-Falja individuale e borxhit: ekziston kur kreditori ia fal borxhin e vet debitorit të caktuar. Koj falje realizohet duke caktuar në mënyr precise se kujt i falet borxhi, por për këtë falje e kemi edhe rastin kur caktohen të gjitha të dhënat që dëshmojnë se kujt personalisht i është falur borxhi.

-Falja kolektive e borxhit:ekziston kur disa kreditor kërkesat e veta ia falin debitorit tjetër.Kjo falje e borxhit bëhet kur kreditorët detyrimisht mirren vesh për këtë në rastet e pajtimit me dhunë ose në rast të marrëveshjes jasht procedures së falimentimit.Te nivelizimi i kërkesave me dhunë debitori zakonisht nuk është në gjendje ta paguaj borxhin e vet ngase pasiva e tij është më e madhe se aktiva. Kur kjo shkaktohet atëherë kreditorët kërkesat e veta i inkasojnë proporcionalisht sipas marrëdhënies ekzistuese të tyre, kurse pjesën tjetër që smund tia paguajnë debitorin e falin.Te ky nivelizim i kërkesave me dhunë, jashtë procedurës së falimentimit, kreditorët lidhnin kontrat me debitorinme anë të së cilës falin pjesën e caktuar të borxhit të debitorit.Kjo kontrat ka efekt ndaj gjithë kreditorëve qe e kanë bërë këtë falje, andaj nëse ndonjëri prej tyre nuk është pajtuar me këtë kontrat nuk ka ndonjë ndikim në efektet e kësaj kontrate.⁶⁷

-Falja sipas vëllimit të borxhit :

-Falja e plotë e borxhit : ekziston kur kreditori ia fal debitorit në tërësi kërkesën e vet. Me këtë debitori lirohet nga obligimi në tërësi ndaj kreditorit, andaj edhe detyrimi midis tyre shuhet.Koj falje ka efekt në të ardhmën(ex nunc).

⁶⁵ Prof.dr. Alajdin.S.Alishani, E Drejta e Detyrimëve, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2002, fq. 698.

⁶⁶ Dr.sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, pjesa e përgjithshme dhe e veçant, Prishtinë, 2001, fq. 277.

⁶⁷ Prof.dr. Alajdin.S.Alishani, E Drejta e Detyrimëve, pjesa e përgjithshme,prishtinë, 2002, fq. 699.

-Falja e pjesshme e borxhit: ekziston kur borxhi i falet pjesërisht debitorit. Debitori në këtë rast lirohet nga obligimi për pagimin e borxhit për atë pjesë sa e ka falur kreditori, kurse për pjesën që ka mbetur e papërbushur mbetet i obliguar deri në përmbushjen e tij. Në qoftë se si arsye juridike e faljes së borxhit realizohet duke lidhur kontratën e përzier të dhuratës (negotium mixtum cum donation), e cila pjesërisht mirret si kontratë bëmirese, kurse pjesërisht si kontratë me shpërblim.

-Efektet e faljes së borxhit: shprehet në shuarjen e kërkesës. Në rast të faljes së plotë të borxhit, kërkesa shuhet në tërësi, si ajo kryesore, ashtu edhe ajo aksesore. Me faljen e pjesëshme të borxhit, kërkesat kryesore dhe aksesore shuhen në atë masë, në të cilën është falur borxhi. Falja e borxhit që i përket njërit debitor solidar, tërheq shuarjen e kërkesës së tij. Me faljen in rem të gjithë debitorët lirohen nga detyra, kurse me faljen intuit personae borxhi mbetet fuqplotë ndaj debitorëve të tjerë solidar. Me faljen e borxhit nuk mund të cënohen të drejtat e personave të tretë (e drejta në peng, e drejta e gëzimit të frytëve të kërkesës nga e cila ka hequr dorë kreditori). Efekt i rëndësishëm i faljes së borxhit është që debitori në të ardhmen të mos e ketë më kërkesën e falur si borxh.⁶⁸

5.4. Shuarja e detyrimëve me përtërirje (novation)

5.4.1. Kuptimi dhe natyra e Përtërirjes

Përtërirja është mënyrë e shuarjes së detyrimit, e cila bëhet në mënyrë që kreditori dhe debitori mirren vesht që detyrimin ekzistues ta zëvendësojnë me një të ri, dhe nëse detyrimi i ri ka një objekt tjetër ose të një baze tjetër ligjore, (LMD i RM-së, neni, 337, alinea, 1.) Në këtë mënyrë bëhet shuarja e detyrimit të vjetër dhe krijimi i detyrimit të ri. Përtërirja nuk sjell lirimin e debitorit nga detyra. Kreditori nuk e ka plotësuar kërkesën. Ai tahi vetëm fiton kërkesën të re. Marrëveshja e kreditorit dhe debitorit, me të cilën është ndryshuar ose shtuar dispozitat për afatin, për vendin ose mënyrën e ekzekutimit, atëherë marrëveshja plotësuese për kamatë, për dëmin e kontraktuar, mbi sigurinë e përmbushjes apo cdo dispozitë tjetër sekondare, si dhe marrëveshja për lëshimin e një dokumenti të ri për borxhin, nuk inovacion. (LMD i RM-së, neni 337, alinea, 2).

Përtërirja ka qenë e njohur edhe në të Drejtën Romake, por, atje ka pasur rol tjetër. Atëherë me të është arritur që të kryhet ndërimi i subjekteve në detyrim. E Drejta Romake nuk ka lejuar që në marrëdhënien e njejtë të detyrimit të kryhet ndërimi i personalitetit të debitorit dhe kreditorit. Ishte nevoja që të sajohet marrëdhënia krejtësisht e re e detyrimit. Sipas natyrës së vet, përtërirja nuk ka paraqitur mënyrën e shuarjes së detyrimit, por transformimin e detyrimit të vjetër në të rinj. Egziston mendimi se përtërirja është e njejtë si edhe ndërimi i përmbushjes (datio in solutum). Te ndërimi i përmbushjes kemi atë se debitori në një detyrim të njejtë me përmbatje të caktuar jep dicka tjetër dhe lirohet definitivisht nga detyra. Te përtërirja detyrimi i vjetër ndërrohet dhe ai nuk përmbushet, por krijohet detyrimi i rinj, i cili ka për tu përmbushur. Ndërimi i përmbushjes do të thotë njësoj si dhe përmbushja e detyrimit, ndërsa përtërirja nuk nënkuptohet si përmbushje e detyrimit, por shuarja e detyrimit të vjetër dhe krijimi i atij të rinj. Përtërirjen duhet kuptuar në mënyrë të difishtë:

-ajo paraqet mënyrën e shuarjes së detyrimit të vjetër dhe

⁶⁸ Dr.sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, Prishtinë, 2001, fq. 278.

-ajo do të thotë krijimi i detyrimit të rinj.⁶⁹

5.4.2.Kushtet e përtërirjes (novatio)

Që të bëhet përtërirja duhet të plotësohen këto kushte :

- Që të egzistoj detyrimi i vjetër i vlefshëm,
- Që të krijohet detyrimi i ri i vlefshëm,
- Që të ekzistojë dallimi midis detyrimi të vjetër dhe të ri,
- Që të ekzistojë qëllimi i palëve për ta kryer përtëritjen.
- Që të ekzistojë detyrimi i vjetër i vlefshëm: nuk mund të përtërihet një detyrim i pavlefshëm.

Nëqoftë se detyrimi i parë është i pavlefshëm atëherë edhe detyrimi i ri që lind me përtërirje është i pavlefshëm.

-Krijimi i detyrimit të ri të plotëfuqishëm: ky është kushti i dytë me rëndësi për përtërirje, i cili e shuan detyrimin e vjetër. Në qoftë se detyrimi i ri është i pavlefshëm atëherë përtërirja nuk është e vlefshme dhe detyrimi i vjetër nuk është shuar , ai vazhdon të ekzistoj. Shuarja e detyrimit të vjetër dhe krijimi i detyrimit të ri është process i lidhur reciprokisht.

-Të ekzistoj qëllimi i palëve për ta bërë përtërirjen : ky është kusht i tretë i përtërirjes. Përtërirja nuk prezumohet, por duhet të rezultoj nga shprehja e vullnetit të palëve që detyrimi të zëvendësohet me ndonjë tjetër.Qëllimi i përtërirjes (animus novandi) duhet të ekzistojë në çastin e lidhjes së kontratës për përtërirje, dhe duhet të shprehet në ndonjë mënyr declarative apo në heshtje.

-Dallimi në mes detyrimit të vjetër dhe të ri (aliquid i ri) : Ky është kushti i katërt për të pasur përtërirje.Përtërirja me ndërrimin e lëndës paraqitet kur debitori ia dorëzon kreditorit, psh: në vend të aparatit televiziv, makinën e qepjes, por nuk ka përtërirje nëse ndodh ndërrimi i sasisë së lëndës , psh: në vend të 1000 kg gurë, dorëzohen 2000 kg.Përtërirje është kur kemi të bëjmë me cilësin e lëndës. Përtërirja me ndërrimin e bazës paraqitet nëse palët merren vesh që debitori detyrën e vet në para nga dëmi i shkaktuar ta ketë në të ardhmën borxh, si detyr nga kontrata mbi huan , ose detyrën e vet për dorëzimin e sendit nga kontrata mbi depozitën, si detyrë nga kontrata mbi qiranë.⁷⁰

5.4.3.Efektet e përtërirjes

Kur krijohet përtërirja e plotëfuqishme atëherë ajo krijon efekte të caktuara juridike. Efekti kryesor i përtërirjes është shuarja e detyrimit të vjetër dhe krijimi i detyrimit të ri ,(LMD i RM-së,neni338,aline,1).Me shuarje e detyrimit të vjetër shuhet edhe pengu, dorzania, përvec në rastet në qoftë se me dorzanin ose pengdhënësin është kontraktuar ndryshe,(po i njeiti nenë ,aline,2).Përtërirja ka efekt juridik edhe në detyrimet solidare passive dhe aktive.Të detyrimet solidare passive me përtërirje të cilën e kanë bërë me njërin prej debitorëve solidar lirohen edhe debitorët tjerë solidar.Kjo do të thotë se përtërirja me njërin prej debitorëve solidarë ka efet edhe ndaj debitorëve të tjerë. Mirpo, në qoftë se kreditori dhe debitori përtërirjen e kanë kufizuar në pjesën e detyrimit që i takon këtij debitori, atëher detyrat e debitorëve të tjerë nuk shuhen, por vetëm zvogëlohen për atë pjesë sa është pjesa e borxhit të këtij debitori solidar.⁷¹

⁶⁹ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 252.

⁷⁰ Dr.Sc.Nerxhivane Dauti,E Drejta e Detyrimëve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçant, Prishtinë,2001, fq. 280.

⁷¹ Prof.Dr. Alajdin.S.Alishani, E Drejta e Detyrimëve, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2002, fq. 703.

5.5. Shuarja e detyrimëve me konfondim(confusion).

Kofondimi është një prej rastëve të shuarjes së detyrimëve që mund të shkaktohet në kundërshtim me vullnetin e debitorit dhe të kreditorit. Rregulla lidhur me konfondimin ekzistojnë në të drejtën nacionale në (LMD i RM-së, neni, 342, aline, 1, 2, 3). Konfondimi ekzistonë kur në një marrëdhënie detyrimi kërkesat bashkohen në një person të vetëm të cilësisë së kreditorit dhe të debitorit, (i njëjti nënë aline, 1). Ky konstatim përkrahet edhe në rregullativë, sepse aty thuhet se detyrimi shuhet me bashkimin në një person të njëjtë vetia e kreditorit dhe të debitorit, ndërsa konstaton se detyrimi shuhet kur cilësitë e kreditorit dhe të debitorit bashkohen në një person të vetëm. Këtë e kemi sepse rregulla është se askush nuk mund të jetë debitor ose kreditor i vetvetës (nemo contra se obligate videtur). Kështu ndodh në praktikë të trashëgimia universal, sepse trashëgimtari i cili ka qenë kreditor ose debitor i trashëgimlënësit pas trashëgimis bëhet kreditor ose debitor i vetvetës. Me këtë një person bashkohen vetit e debitorit dhe të kreditorit.

Konfondim kemi edhe të trashëgimia singular kur kërkesa e debitorit (cesusi) cedohet. Pastaj, këtë rast të shuarjes së detyrimëve kemi kur kërkesa kalon në debitorin ose borxhi kalon në kreditor, ose kërkesa dhe borxhi kalojnë në ndonjë person të tretë. Në fund mund të themi se deri të konfondimi vjen kur ndërmarjet e ndryshme interesohen në një organizatë të re, ndërmarjet e mëparshme shuhet, andaj të drejtat dhe detyrimet e ndërmarrjeve të integruara janë në organizatën e re të krijuar.⁷²

5.5.1. Efektet e konfondimit:

Konfondimi sjell shuarjen e detyrimit, si atij kryesor, ashtu edhe atij aksesori (dorëzanisë, pengut etj.). Nëse do të ndodhte që personaliteti i kreditorit të jetë njëri nga debitorët solidar, kjo nuk do të ketë pasojë se janë shuar detyrimet e debitorëve të tjerë solidar.

Ajo vetëm do të zvoglohet, aqë sa është pjesa, të cilën duhet ta paguaj ai debitor solidar, i cili e ka trashëguar kreditorin. Ka situata kur nuk do të bëhet shuarja e detyrimëve, nëse kërkesa dhe borxhi do të gjindeshin te personi i njëjtë. Në të drejtën tonë njihen keto raste:

-Nëse trashëgimtari është kreditorë i trashëgimlënësit, ai do të ketë të drejtë që ta plotësojë kërkesën e vet ndaj dekijusit (trashëgimlënësit) nën kushtet e njëjta si dhe kreditorët tjerë të dekijusit, e kjo do të thotë deri te lartësia e vlerës së pasurisë së trashëguar.

-Nëse do të ndodhte shuarja e kërkesës, kur kreditorët e trashëgimlënësit do të kërkonin ndarjen e pasurisë së trashëgimlënësit nga pasuria e trashëgimtarit.

Në atë rast kreditorët e trashëgimlënësit rezervojnë për veti të drejtën që ata së pari të paguhet nga trashëgimia, dhe atëherë, nëse pas tyre ngel diçka të paguhet kreditorët e trashëgimtarit.

-Kërkesa e regjistruar në librat tokësore nuk shihet edhe nëse bjen në duart e debitorit. Duhet të bëhet shlyerja nga librat tokësore.

-Konfondimi nuk mund të sjell shuarjen e detyrimit, nëse me të do të shken të drejtat e personave të tretë (e drejta e pengut, e drejta e gëzimit të frutave).

⁷² Prof. Dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimëve, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2002, fq. 703.

-Konfondimi nuk do të ketë efekt, kur marrësi i sendit të ngarkuar ne hipotekë do ti paguante kreditorët të hipotekuar. Në atë rastë hipoteka do të ekzistonte edhe më tutje, por tani në llogari të tij.

-Konfondimi nuk do të bëhet, kur letra e prurësit do të gjindej në duart e dhënësit të saj (botuesit) . Në këtë rast detyrimi nuk do të shuhet deri sa ekziston letra dhe nuk është asgjesuar.

-Shuarja e detyrimit me anë të konfondimit nuk do të bëhet, nëse debitori do ta trashëgoj dorzaninë ose anasjelltas, gjegjësisht nëse kreditori do ta trashëgojë dorzanin ose ai kreditorin. Mirpo, për këtë detyra e dorëzanit do të shuhej, nëse kreditori do ta trashëgonte debitorin ose anasjelltas.⁷³

-Mënyrat e shuarjes së detyrimëve kundër vullnetit të subjekteve të tyre.

5.1.Shuarja e detyrimëve për shkak të pamundësisë së përmbushjes.

Detyrimet mund të shuhen për shkak të pamundësisë së përmbushjes së tyre. Ky rast i shuarjes së detyrimëve shkaktohet në kundërshtim me vullnetin e pjesëmarësve. Për këtë rast të shuarje së detyrimëve ekzistojnë rregullativa në të drejtën nacionale(LMD,i RM-së,neni 343,344,345).Duke pasur parasysh mësimet e doktrinës, rregullativën e cekur dhe praktikën gjyqësore ekzistuese, mund të thuhet se të drejtat nacionale dhe rregullativa e unifikuar i kushtojnë kujdes të caktuar rregullave të këtij rasti të shuarjes së detyrimëve.Sipas rregullave detyrimi shuhet kur përmbushja e tij bëhet e pamundëshme nga rrethanat për të cilat debitori nuk përgjigjet sepse aty sanksionohen se detyrimi shuhet kur ekzekutimi i tij bëhet i pamundur pa fajin e debitorit dhe para se ky të jetë vënë në vones,(LMD, i RM-së,neni 343,aline,1)Debitori i cili është në këto rrethana duhet të provojë rrethanat që përjashtojnë përgjegjësin e tij,(i njeiti nenë ,aline,2).

Në jetën e përditshme pamundësia e përmbushjes së detyrimit mund të shkaktohet në raste dhe situatë të ndryshme. Kështu ndodh kur shkaktohet rrufeja, tërmeti, zjari me efektet negative ndaj lëndës së detyrimit, ku shkaktohet rrëmbimi i një sendi që është lëndë e detyrimit, kurë bëhet ndalimi administrative që një send të jetë lëndë e detyrimit, kur ndalohet eksport-importi i sendit që është lëndë e detyrimit.Në qoftë se sendi i detyrimit është sipas llojit të caktuar dhe shkaktohet pamundësia e përmbushjes , atëher detyrimi nuk shuhet edhe në rastin kur atë cka ka debitori nga ata sende shkaktohen nga rrethanat për të cilat ai nuk përgjigjet, (LMD i RM-së,neni, 344,aline,1) pra këtu vlen rregulla tradicionale se sendi sipas llojit nuk zhduket(genera non porunt), sepse ai zëvendësohet me sendin e llojit të njejtë.

5.1.1.Kushtet e pamundësisë për përmbushje :

Që pamundësia e ekzekutimit të sjellë shuarjen e detyrimit duhet të plotësohen këto kushte:

-Që të shkaktohet pas krijimit të detyrimit. Nëse detyrimi ka qenë i pamundur në momentin e krijimit të tij, atëherë ai nuk ka ekzistuar fare dhe nuk do të ketë as të shuhet.

⁷³ Dr. Lubisha Millosheviç, Edrejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq 253.

-Që pamundësia e ekzekutimit të mos jetë shkaktuar me fajin e debitorit, por që është shkaktuar nën ndikimin e fuqive madhore, dmth: ngjarjeve të cilave nuk janë parapar, e nëse janë parapar, nuk kanë mundur që të pengohen dhe që e kanë penguar debitorin që ti kryej detyrat e veta.

-Që debitori të mos e ketë vonuar përmbushjen. Nëse debitori është vonuar, atëherë pamundësia e ekzekutimit nuk do ta lirojë nga detyra, sepse konsiderohet se është fajtorë për mosekzekutim. Shuarja e detyrimit për shkak të mosekzekutimit do të bëhej vetëm me kërkesën e debitorit, i cili do të vërtëtoj ekzistimin e kushtëve të lartpërmendura. Mirpo palët mund të parashohin me marrëveshjen e tyre që debitori në cdo rast ka për ta kryer detyrën. Atëherë debitori në rastin e pamundësisë së përmbushjes do ta ketë borxh pagimin ekuivalent në të holla në vend të detyrimit të mëparshëm. Ky është i ashtuquajti subrogim real. Pamundësia e ekzekutimit duhet të dallohet nga rasti kur ekzekutimi për debitorin do të jetë tepër i rëndë, por jo edhe i pamundshëm. Në atë rast do të jetë fjala për ndikime rrethanave të paparapara në përmbushjen e detyrave.⁷⁴

5.1.2. Efektet e pamundësisë së përmbushjes

Pamundësia e plotë e përmbushjes paraqitet kur lënda e detyrimit zhduket në tërësi. Nëse paraqitet pamundësisë e tillë, detyrimi shuhet ipso facto në tërësi. Në pamundësinë e pjesëshme, kur detyrimi bëhet në një pjesë të pamundshme për përmbushje, debitori lirohet lirohet nga detyra për atë pjesë e cila është e pamundshme që të përmbushet.⁷⁵

5.2. Shuarja e detyrimëve me kalimin e kohës

Skadimi i kohës është mënyrë vullnetare e shuarje së detyrimëve, kur me anë të kontratës është caktuar koha e zgjedhjes së detyrimit, por mund të përfshihet edhe në mënyrë kundër vullnetit të palëve kur me ligj ose me vendim të gjykatës është caktuar koha e zgjatjes së detyrimëve. Kjo mënyrë e shuarje së detyrimëve vlen për detyrimet e përhershme dhe sukcesive. Pra sipas (LMD-së, RM-së, neni 346), në një marrëdhënie të përhershme afatgjatë, me një afat të caktuar, do të përfundoj vetëm nëse është kontraktuar ose me ligjë është theksuar se edhe pas skadimit të afatit marrëdhënie detyimore vlen edhe për një periudhë të caktuar.

Këto detyrime mund të kenë afat të caktuar të zgjatjes, varësisht nga qëllimi që dëshirohet të arrihet me anë të tyre. Në atë rast se afati i zgjatjes që më parë është caktuar, ato, si rregull shuhet me skadimin e kohës. Koha e zgjatjes së detyrimit mund të caktohet me kontratë, me testament, me vendim gjyqësor dhe ligj. Me kalimin e kohës detyrimi shuhet dhe në të ardhmen nuk ekziston më. Si raste të shuarjes së detyrimëve me skadimin e kohës konsiderohen:

-Kontrata mbi marrëdhënien e nënqiragjinjëve lidhur me afat prej dy vitesh dhe pas skadimit të këtij afati, detyrimi shuhet.

-Lënësi i detyrimit trashëgimtarit me legat që ti paguaj ndonjë subjekt 1000 den për çdo muaj deri në moshën madhore të tij.

⁷⁴ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 256.

⁷⁵ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçant, Prishtinë, 2001, fq 291.

-Sipas ligjit ekziston detyra e vëllaut të madh që ta mbaj vëllaun e mitur deri në moshën madhore.⁷⁶

Anulimi i një marrëdhënie të përhershme borxhi kemi atëherë kur:

-nëse kohëzgjatja e marrëdhënies së borxhit nuk është e përcaktuar, secila palë mund ta përfundojë atë anulim.

-anulimi duhet të dorëzohet palës,

-anulimi mund të jepet në çdo kohë, vetëm jo në kohë të papërshtatshme,

-ndërprerja e borxhit pushon kur skadon afati i njoftimit të përcaktuar me marrëveshje dhe nëse një afat i tillë nuk përcaktohet, me marrëveshje, atëherë marrëdhënia përfundon pas skadimit të afatit të përcaktuar me ligj ose me zakonet, me skadimin e datës së përcaktuar,

-palët mund të bien dakord se marrëdhënia e tyre e borxhit do të pushojë së ekzistuari me dorëzimin e anulimit nëse për një rast të caktuar ligji nuk urdhëron gjë tjetër.

-kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori atë çka ka poseduar para shuarjes së detyrimit me mbarimin e afatit ose anulimit. (LMD i RM-së, neni 347, alineë, 1, 2, 3, 4, 5).

5.3. Shuarja e detyrimëve me denoncim

Shuarja e detyrimëve me denoncim është një prej rastëve të shuarjes së detyrimëve që shkaktohet në kundërshtim me vullnetin e debitorit dhe të kreditorit. Ky rast i shuarjes së detyrimëve sanksionohet në të drejtën nacionale. Sipas rregullave në qoftë se koha e zgjatjes së marrëdhënies së borxhit nuk është caktuar, çdo pjesëmarës ka të drejtë ta shuaj me denoncim. Siç mund të vërehet, këtu kemi rastin e marrëdhënies së detyrimëve që janë të paafatizuara, andaj i mundësohet si debitorit, ashtu edhe kreditorit që ta denoncojë këtë marrëdhënie të krijuar.

Denoncimi i marrëdhënies së detyrimit kur ndërmiret nga debitori ose kreditori duhet që ti dërgohet anës tjetër, nga kjo dispozitë rrjedh se kur ndërmiret e drejta në denoncimin e marrëdhënies së detyrimit nga debitori ose kreditori, atëherë pa tjetër ky vendim duhet të dërgohet anës tjetër. Zakonisht dërgimi i denoncimit bëhet me shkrim, por mund të bëhet edhe gojarisht. Për hir të sigurisë së denoncimi me të vërtetë është bërë, duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të dërgohet në mënyrë të sigurt. Prarimisht, denoncimi mund të jepet në çdo kohë, por nuk duhet të jepet në kohë të papërshtatshme.

5.3.1. Efektet e denoncimit:

Për të krijuar efekte denoncimi duhet të jipet në kohë të përshtatshme. Koha e përshtatshme është kur ai jipet në rrjedh normale të marrëdhënies së detyrimit dhe i jepet në suaza të rregullave të së drejtës së detyrimëve. Ai nuk duhet të jepet në kohë të papërshtatshme, sepse mund të shkaktojë dëm palës tjetër. Kështu ndodh kur denoncimi nga lokali afarist ose nga banesa bëhet kur ekziston acari i madh, kur janë vërshimet. Marrëdhënia e denoncuar e borxhit shuhet kur skadon afati i denoncimit të caktuar sipas kontratës, kurse nëse ky afat nuk është caktuar sipas kontratës, atëherë marrëdhënia e borxhit shuhet pas skadimit të afatit të caktuar sipas ligjit. Për realizimin e denoncimit të një marrëdhënie të detyrimit duhet të caktohet afati i denoncimit. Ky afat zakonisht është 30 ditë. Por, këtë afat mund të caktohet në bazë të kontratës,

⁷⁶ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, Prishtinë, 2001, fq. 285.

mund të caktohet edhe me dispozita ligjore. Afati i denoncimit i jepet që pala tjetër të përgaditet për shuarjen e kësaj marrëdhënie të detyrimit.⁷⁷

5.4.Shuarja e detyrimëve me vdekjen e debitorit ose kreditorit

Me vdekjen e kreditorit ose debitorit e ndërpret detyrmin vetëm nëse ka ndodhur personalisht me të, duke marrë parasysh karakteristikat personale të një prej palëve kontraktuse ose aftësis personale të debitorit.(LMD i RM-së ,neni,348).Vdekja e subjekteve të detyrimëve nuk është mënyr e përgjithshme e shuarjes së detyrimëve. Sipas rregullës, detyrimi nuk shuhet pas vdekjes së subjekteve të tij, por kalon në trashëgimtarët e tyre. Mirpo, ekzistojnë edhe detyrimet, të cilat shuhet pas vdekjes. Aty hynë detyrimet që janë sajuar duke marrë parasysh vetitë e personalitetit të pjesëmarrësve të tyre (veçanërisht të debitorit). Ato janë marrëdhëniet, të cilat, sipas të drejtës romake, quhen intuit personae.Këtu do të përfshihen detyrat nga kontrata mbi vepër(vdekja e rrobaqëpsit ose klientit të tij),detyrat nga kontrata mbi autorizim(vdekja e autorizuesit), detyrat nga kontrata mbi ortakërin(vdekja e ortakut), detyra e shpërblimit të dëmit moral(vdekja e personit të dëmtuar)etj.⁷⁸

5.5.Shuarja e detyrimëve me parashkrim(prescriptio).

5.5.1.Nocioni i parashkrimit.

Parashkrimi është mëyrë e shuarje së detyrimëve kundër vullnetit të subjekteve.Kreditori është i detyruar që në marrëdhëniet e detyrimëve kërkesat e veta ti realizojë me kohë.Nëse brenda intervalit të caktuar kohor nuk e realizon të drejtën e vet, ajo shuhet.E drejta për të kërkuar përmbushjen me forcë të detyrimit pushon me vjetërsim.Vjetërsimi ndodh kurr afati i caktuar skadon, në të cilën kreditori ka mundur të kërkoj përmbushjen e detyrimit.(LMD i RM-së neni 349,aline,1,2).Në këtë rast kreditori kërkesën e vet nuk mundë ta realizoj me anë të padis, pra: me mjete juridike nuk mund të realizohet kërkesa .

-Parashkrimi është humbja e mundësisë juridike që me anë të padis të kërkohet përmbushja e detyrimit pas skadimit të afatit , i cili është përcaktuar me ligj.Pra, me parashkrim nuk humbet e drejta në tërësi, por mundësia e realizimit të autorizimit me anë të mjetëve të dhunës, të cilat i përmbajnë të drejtat subjektive.Por, në rast se debitori e përmbush detyrimin e parashkrirë, nuk ka të drejtë të kërkoj kthimin e asaj që e ka dhënë, (LMD i RM-së neni, 356), edhe nëse e ka ditur se detyra është parashkrirë, sepse nuk ka paguar dicka që nuk ka pasur borxh.

-Parashkrimi nuk krijon efekte nga vetë ekzistimi i tij.Gjykata nuk merr parasysh parashkrimin sipas detyrës zyrtare,(LMD i RM-së neni, 349,aline,2),por personalisht debitori është i detyruar që vetë të bazohet në parashkrimin e kërkesës së kreditorit, në në formë të

⁷⁷ Prof.Dr. Alajdin.S.Alishani, E Drejta e Detyrimëve, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2002, fq. 711.

⁷⁸ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq, 257.

mbrojtjes me kundërshtimin e parashkrimit, por edhe me paraqitjen e padis në gjykatë, me të cilën kërkohet që të konstatohen se është bërë parashkrimi,(LMD i RM-së neni, 349,aline,3).

-Me parashkrimin e kërkesës kryesore parashkruhen edhe ato aksesore sic janë: kërkesa e kamatave, frytëve, shpenzimeve, kushti penal,(LMD i RM-së, neni,361).

Nëse parashkruhet kërkesa ndaj debitorit kryesor,konsiderohet se është parashkruar edhe kërkesa ndaj debitorit aksesori(dorzanit).Nëse detyra e debitorit do të ketë qenë e siguruar me peng ose me hipotek, pas parashkrimit të detyrimit kreditori mund të paguhet nga sendi i lënë.

Parashkrimi paraqet një lloj sanksioni kundër kreditorit të pakujdesshëm, i cili e ka lënë pas dore që në afatin e caktuar të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit.

Parashkrimi e lehtëson pozitën e debitorit, sepse i bën të mundur që të refuzojë përmbushjen e detyrimit pas kalimit të afatit të caktuar.Parashkrimi nuk i përfshin të gjitha të drejtat subjektive. Si rregull: nuk parashkruhen të drejtat reale,po vetëm ata të detyrimëve.Mirpo,ka disa të drejta të detyrimëve të cilat nuk shuhet me parashkrim.Nuk mund të parashkruhet detyra e mbajtjes si detyrim ligjor dhe e drejta që të ndahen sendet e përbashkëta.⁷⁹

Koha e parashkrimit: sipas rregullave të parashkrimit caktohen afatet brenda të cilëve mund të ushtohen të drejtat. Nëse me kujdes analizohet kjo rregullativë mund të vërehet se ekziston:

-afati i përgjithshëm i parashkrimit dhe

-afatet e veçanta të parashkrimit.

-Afati i përgjithshëm i parashkrimit:në të drejtën nacionale caktohet afati i përgjithshëm i parashkrimit(LMD i RM-së neni, 360),me këtë kjo rregullativë cakton këtë afat brenda të cilit duhet të realizohet cdo kërkesë, pas skadimit të këtij afati nuk mund të realizohet kërkesa me anë të ndonjë mjeti juridik.Kjo është e kuptueshme sepse ka skaduar edhe afati i fundit që ndonjë kërkesë të realizohet me mjete juridike.

-Afati i përgjithshëm i parashkrimit sanksionohet(LMD i RM-së neni,368.alinea,1), sipas kësaj dispozite, kërkesat parashkrihen për 10 vjet në qoftë se në bazë të ligjit nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit.LMD në nenet 366,aline,1,2,3, ka parapar afatin e parashkrimit për kërkesat e shpërblimit të dëmit të shkaktuar me vepër penale.

Sipas këtyre rregullave, kur dëmi është shkaktuar me vepër penale, kurse për ndjekje penale është paraparë afati më i gjatë i parashkrimit, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkrihet kur skadon afati i caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale, (po i njeiti nenë).

Pastaj, ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale ka afat edhe në ndërprerjen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit.⁸⁰

-Afatet e veçanta të parashkrimit të parapara me LMD-së janë 1 dhe 3 vjet kurse disa nga ato janë edhe më të gjata se 5 vjet. Kështu, kërkesat të cilat përbëhen nga dhëniet e kohëpaskoshme të cilat arrijnë për përmbushje një vit, ose në periudha kohore më të shkurta parashkruhen për 3 vite, nga aritja e secilës dhënie të veçantë.

Kërkesa të tilla janë psh: kërkesa e kamatës, kërkesa e dhënjes së mbajtjes etj,si dhe anulitetet me të cilat përmbushet kamata nga shumat e barabarta të kohëpaskoshme të caktuara që më parë. Mirpo kërkesa të till nuk janë edhe përmbushjet me këste dhe përmbushjet e pjesëshme për të cilat vlen afati i përgjithshëm i parashkrimit,(LMD i RM-së neni,361,aline,1).

Kurse sa i përket të drejtës nga e cila dalin kërkesat e kohëpaskoshme të cilat parashkruhen në afat prej 3 vitëve, ajo e drejt parashkruhet në afatin e përgjithshëm prej 5 vitesh, duke llogaritur

⁷⁹ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçant, Prishtinë, 2001, fq, 292.

⁸⁰ Prof.Dr. Alajdin.S.Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2002, fq. 720.

nga kërkesa e fundit e arritur e pa përmbushur pas së cilës debitori më nuk ka bërë ndojë dhënie tjetër. Por atëherë kur do të parashkruhet kjo e drejt e kreditorit e humb jo vetëm të drejtën që të kërkoj dhënje të ardhshme të kohëpaskohshme, por edhe të drejtën që të kërkoj dhënien e kërkesave të arritura. Kurse si përjashtim nga kjo e drejta ligjore e mbatjes nuk mund të parashkruhet nga shkaqet e lartëpërmendura (LMD i RM-së neni, 362, alineë, 1, 2).

Gjithashtu në afatin prej 3 vitesh parashkruhen edhe kërkesat mes personave juridik shoqëror nga kontrata mbi qarkullimin e mallit dhe dhënies së shërbimëve, si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra në lidhje me ato kontrata. Mirëpo, parashkrimi do të rrjedh ndaras për çdo dërges të marrit për ekzekutimin e veprës ose shërbimit. Në afatin prej 3 vitësh parashkruhet edhe kërkesa e pagimit të qirasë, qoftë atëherë kur ajo është kontraktuar me këste ose në një shumë të përgjithshme.

Dhe në fund, në afatin subjektiv prej 3 vitesh parashkruhet edhe kërkesa e dëmit të shkaktuar, me atë se ai afat fillon të rrjedh nga moment kur i dëmtuari ka kuptuar për dëmin e shkaktuar dhe personin i cili e ka shkaktuar atë. Mirëpo, megjithatë kjo kërkesë në çdo rast do të parashkruhet pas kalimit prej 5 viteve prej kur është shkaktuar dëmi.⁸¹

Afatet objektive të parashkrimit janë: ato afate të cilat fillojnë të rrjedhin nga ndonjë rrethanë objektive, e kjo nënkuptonë nga ndonjë rrethanë e cila nuk varet nga palet e marrëdhënies detyimore. Rrethanë e tillë është psh: dita e parë pas ditës kur kreditori ka pasur të drejtë të kërkoj përmbushjen e detyrimit, e kjo nënkuptonë ditën e parë pas arritjes së detyrimit për përmbushje.

Afatet miks të parashkrimit janë: kombinim i afatëve objektive dhe subjektive të parashkrimit. Që të mund të pengohet shtyerja e përmbushjes deri te e cila mund të çoj afati subjektiv, ligji ka parapar që për të njëjtën marrëdhënie detyimore të ketë edhe afat objektiv të parashkrimit.

5.5.2. Fillimi i rrjedhjes së afatëve të parashkrimit.

Fillimit i rrjedhjes së afatëve të parashkrimit varet prej shumë rrethanave.

-Ai varet nga: lloji i lëndës, dhe për këtë shkak edhe nga lloji i marrëdhënies detyimore.

-Ai pastaj varet nga gjendja juridike e njërës ose të dy palëve të marrëdhënies detyimore.

-Ai në fund varet edhe nga: rregullimi i ligjor i fillimit të rrjedhjes së parashkrimit për disa lloje të detyrimëve pavarësisht nga lënda e atyre marrëdhënieve.

-Varësisht nga lloji i lëndës së marrëdhënies detyimore në mënyra të ndryshme është rregulluar edhe fillimi i rrjedhjes së afatëve të parashkrimit të detyrimëve lënda e të cilëve është ndonjë mos bërë ose ndonjë durim (detyrimet passive). Afatet e parashkrimit të detyrimet aktive fillojnë të rrjedhin prej ditës së parë pas ditës kur debitori ka qenë i detyruar që ta përmbushë detyrimin e tij. Kjo rregull është pasojë e faktit se atë ditë detyra duhet të përmbushet kurse e drejta të realizohet, dhe në qoftë se nuk vjen deri te kjo atëherë kreditori mund të fillojë realizimin e dhunshëm të autorizimit të tij, lëshimi i së cilës mund të çoj deri te parashkrimi, në qoftë se ndaj realizimit të tillë të së drejtës së tij nuk fillon në afatin e parapar të parashkrimit.

Afatet e parashkrimit të detyrimëve passive, fillojnë të rrjedhin ditën e parë nga dita e cënimit të dyre. Ai cënim përbëhet nga ndërmarja e veprimëve të cilat debitori ka qenë i detyruar tu përmbahet, ose me ndales që ta durojë atëqë është parapar me kontrat mes debitorit dhe kreditorit.

⁸¹ Dr.Sc.Abdulla Aliu, E Drejta e Detyrimëve, Material I Autorizuar, Tetovë, 2009, fq. 50.

-Varësisht nga gjendja juridike e njëres ose të të dy palëve të detyrimit në mënyra të ndryshme është caktuar edhe fillimi i rrjedhjes së afatëve të parashkrimit , varësisht nga ajo se: a është kreditorë personi fizik pa aftësi veprimi dhe i cili nuk ka përfaqësues të emëruar ose se palë të atij detyrimi janë bashkëshortët, prindërit dhe fëmijët, i kujdesuri dhe kujdestari si dhe personat që jetojnë në bashkësi jashtëmartesore.⁸²

5.5.3.Ndalja e parashkrimit.

Në marrëdhëniet e detyrimëve ka raste kur nuk rrjedhin rregullat e parashkrimit.këto raste të mosrrjedhjes së parashkrimit janë të shumta dhe të sanksionuara me dispozita ligjore të ndryshme. Arsyet se pse rregullat e parashkrimit nuk rrjedhin janë:

-Ku kemi të bëjmë me kërkesën midis bashkëshortëve. Nëse marrëdhënia e detyrimit është krijuar para kurorës, atëherë parashkrimi ndërprehet gjatë zgjatjes së kurorës. Kjo arsyetohet me atë që mos të prishen marrëdhëniet bashkëshortore për shkak të realizimit eventual të kërkesës së njërit bashkëshortë ndaj tjetrit me anë të gjyqit,(LMD i RM-së neni,370,aline,1).

-Parashkrimi nuk rrjedh midis prindërve dhe fëmijëve, kujdestarit dhe të mbrojturit, gjegjësisht organit të kujdestarisë, derisa sa zgjat e drejta e prindërve, apo e kujdestarisë. (LMD i RM-së neni,370,aline,2).

-Ai, gjithashtu nuk rrjedh sa i përket kërkesave që i kanë personat e inkuadruar në familjet e huaja ndaj punëdhënësit ose anëtarëve të familjes së tij, deri sa zgjatë ajo marrëdhënie pune,(LMD i RM-së neni,370,aline,3).

-Parashkrimi nuk rrjedh gjatë kohës së mobilizimit dhe luftës sa i përket kërkesave të personave në detyra ushtarake,(LMD i RM-së neni,371,aline,1).

-Ai, gjithashtu, nuk rrjedh gjatë tërë kohës për të cilën kreditori nuk ka mundur, për shkak të pengesave të pakapërcyeshme ,që me anë të gjyqit të kërkojë ekzekutimin e detyrimit,(LMD i RM-së neni,372) .

5.5.4.Ndërprerja e parashkrimit.

Sipas natyrës së vet ndërprerja e parashkrimit paraqet anulim të kohës së kaluar nga fillimi i rrjedhjes së afatit të parashkrimit deri në shkaktimin e rrethanës e cila solli deri te ndërprerja e atij afati. Pikërisht këtu qëndron dallimi mes ndaljes dhe ndërprerjes së parashkrimit, sepse pas shfaqjes së tij afati i parashkrimit fillon të rrjedh prej fillimi.Në këtë rast duhet cekur se moment i rrjedhjes së afatit të parashkrimit varet nga shkaku i cili solli deri te ndërprerja e parashkrimit.Deri te ndërprerja e parashkrimit çojnë:

-pohimi i borxhit dhe

-ngritja e padis ose

-ndërprerja e çdo veprimi tjetër të kreditorit kundër debitorit të ndërmarrë para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim të vërtetimit, sigurimit ose realizimit të kërkesës.

⁸² Dr.Sc. Abdulla Aliu, E Drejta e Detyrimëve, Material I Autorizuar, Tetovë, 2009, fq. 50.

Pohimi i borxhit nga ana e debitorit çon në ndërprerjen e parashkrimit në atë moment kur ajo është bërë. Pra parashkrimi përfundon kur debitori pranon borxhin,(LMD i RM-së, neni 376, alinea, 1) Sipas natyrës juridike pranimi i borxhit është punë juridike e njëanshme joformale ose ndonjë punë tjetër juridike. Pranimi i borxhit duhet të jetë: i qartë, i caktuar dhe i pakusht. Ai duhet të bëhet para fillimit të parashkrimit. Pohimi me shkrim i detyrës së parashkuar nuk paraqet pohimin e borxhit në kuptimin e lartëpërmendur, por ajo paraqet denoncim nga parashkrimi për të cilin do të bëjmë fjalë në paraqitjen e mëparshme. Pohimi i borxhit me punë tjera juridike mund të bëhet me pagimin e këstëve, nëse pagesa bëhet me këste, pagimin e kamatës, dhënien e sigurimit etj, (po i njehti nenë, alinea 2).

Ngritja e padisë ose ndërmarrja e ndonjë veprimi tjetër të kreditorit kundër debitorit para gjykatës ose organit kompetent tjetër me qëllim të vërtetimit, sigurimi ose realizimit të kërkesës çon në ndërprerjen e parashkrimit nëse gjykata ose organi kompetent tjetër e ka miratuar atë me aktgjykim të plotëfuqishëm respektivisht me vendim të plotëfuqishëm, (LMD i RM-së neni 377). Në këtë rast duhet cekur se veprimi tjetër i kreditorit mund të jetë edhe thirja në mbrojtje, paraqitja e kompensimit të kërkesës, paraqitja e kërkesës në ndonjë procedurë tjetër (psh në procedurën falimentuese, në procedurën e kompensimit të dhunshëm).

- Në qoftë se kreditori është denoncuar nga padia ose veprimi tjetër që e ka ndërmarrë, ose
- Në qoftë se padia ose veprimi tjetër i tij nuk është miratuar me aktgjykim të plotëfuqishëm respektivisht me vendim tjetër të plotëfuqishëm atëherë konsiderohet se nuk ka ardhur deri te ndërprerja e parashkrimit. mirëpo në qoftë se padia është hudhur posht për shkak të inkompetencës së gjykatës .mirëpo në qoftë se padia është hudhur posht për shkak të inkompetencës së gjykatës ose për ndonjë arsye tjetër e cila nuk ka të bëjë me esencën e punës dhe në qoftë se kreditori përsëri ngren padi në afat prej 3 muajsh nga dita e plotëfuqishmëris së vendimit për hudhjen posht të padisë, atëherë do të konsiderohet se parashkrimi është ndërprere me ngritjen e padisë së parë nëqoftë se kërkesa e padisë së dytë është miratuar me aktgjykim të plotëfuqishëm.⁸³

5.5.5. Paraqitja e parashkrimit.

Parashkrimi paraqitet kur do të kalojë dita e fundit e afatit të caktuar me ligj, (LMD i RM-së 349, alinea, 2). Mund të ndodhë që koha e parashkrimit të ketë filluar të rrjedhë asaj rrjedhje të ketë ardhur në ndërimin e palës së debitorit.

-paraqitja e parashkrimit të kërkesave të kohëpaskoshme dmth: të kërkesave të dhënieve të kohëpaskoshme të cilat arrijnë për përmbushje një vit ose periudha kohore më të shkurta (psh një muaj), e me të edhe të të drejtave nga të cilat dalin kërkesat e kohëpaskoshme është ceshtje e ndërlikuar.

-ndaj personit fizik i cili nuk ka zotësi veprimi, pa marrë parasysh se a e ka të emëruar përfaqësuesin e vet ligjorë parashkrimi do të rrjedhë, mirpo parashkrimi nuk paraqitet nëse personi fizik pa zotësi veprimi nuk ka përfaqësues ligjorë përderisa mos kalojnë dy vite kur ai person është bërë me zotësi të plotë veprimi ose pasi që të jetë emëruar përfaqësuesi i tij ligjorë, (LMD i RM-së neni, 374, alinea, 1, 2, 3).

-ndaj personit i cili është në detyrë ushtarake ose ushtrime ushtarake parashkrimi rrjedhë sipas rregullave të përgjithshme të asaj rrjedhje, por ai nuk paraqitet me skadimin e ditës së fundit të

⁸³ Dr.Sc. Abdulla Aliu, E Drejta e Detyrimëve, Material I Autorizuar, Tetovë, 2009, fq. 54.

afatit të parashkrimit por pas skadimit të afatit prej 3 muajsh, pas kryerjes së shërbimit ushtarak,(LMD i RM-së neni,375).

-kur është bërë përtërirja e detyrimit, kurse deri te ndërprerja e parashkrimit ka ardhur me pohimin e borxhit, atëherë parashkrimi i kërkesës që është krijuar me përtërirje paraqitet me skadimi e afatit të parashkrimit të paraparë për atë ose kërkesë.⁸⁴

Dallimi i rregullave të parashkrimit ,rregullave usucapio dhe rregullat e prekluzionit.

-Renoncimi nga parashkrimi

Sipas **nenin,354 të LMD së RM-së**, debitori nuk mund të renoncohet nga parashkrimi para se të kalojë afati i paraparë për parashkrim dmth: pas paraqitjes së parashkrimit. Megjithatë ai mund të renoncohet nga parashkrimi pasi të paraqitet ai.Me dispozitat për ndalimin e renoncimit nga parashkrimi para paraqitjes së tij ligjdhënësi e ka mbrojtur debitorin nga presioni eventual i kreditori.Mirpo pas paraqitjes së parashkrimit nuk ka asnjë arsye që debitori të mos i jepet mundësia e renoncimit nga parashkrimi. Deri te renoncimi i parashkrimit çonë:

- pohimi me shkrim i detyrës së parashkruar,
- dhënia e pengut ose ndonjë sigurim tjetër i kërkesës së parashkruar, dhe
- përmbushja e detyrës së parashkruar.

Në këtë rast duhet cekur se përmbushja e detyrës së parashkruar çon deri te renoncimi i parashkrimit edhe atëherë kur debitori nuk ka ditur se është paraqituri parashkrimi , për arsye se parashkrimi çon në atë që kërkesa të mos mund të realizohet përmes rrugës së dhunshme kurse me atë rast kemi të bëjmë më përmbushje vullnetare.⁸⁵

5.5.6.Parashkrimi dhe prekluzioni.

Me anë të parashkrimit humb e drejta që me mjete juridike të realizohet, kurse me shkaktimin e prekluzionit humb e drejta njëher e përgjithmon.Gjatë afatit prekluziv e drejta duhet të ushtohet, sepse pas skadimit të tij nuk mund të ushtrohet kjo e drejtë pasi që titullari i së drejtës prekluzohet. Me skadimin e afatit të parashkrimit e drejta nuk mund të realizohet me mjete juridike, mirpo nëse debitori dëshiron ta përmbush detyrimin e parashkrirë, atëherë konsiderohet se e ka paguar borxhin që ka ekzistuar, pra nuk konsiderohet se e ka bërë pagimin condition indebiti.

Afatet e parashkrimit janë të shumta si për nga numri ashtu edhe për nga zgjatja e tyre, kurse afatet prekluzive për nga numri janë më të pakta si dhe për nga zgjatja e tyre janë të shkurta.Rregullat e parashkrimit ka raste kur nuk rrjedhin dhe ka raste kur ndërpriten, kurse rregullat e prekluzionit as që mund të ndalen ,as që ndërpriten.Rregullat e parashkrimit mirren parasysh me iniciativën e subjektit të interesuar, ndërsa rregullat e pekluzionit mirren parasysh sipas detyrës zyrtare.⁸⁶

⁸⁴ Dr.Sc.Abdulla Aliu, E Drejta e Detyrimëve, Material I Autorizuar, Tetovë, 2009, fq. 56.

⁸⁵ Dr.Sc. Abdulla Aliu, E Drejta e Detyrimëve, Material I Autorizuar,Tetovë, 2009, fq. 56.

⁸⁶ Prof.Dr. Alajdin.S.Alishani, E Drejta e Detyrimëve, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2002, fq.720.

KREU II

EFEKTET E DETYRIMËVE.

1.KUPTIMI

Detyrimet janë marrëdhënie në të cilat pjesëmarësit e tyre kanë për tu sjellë në mënyr të caktuar ndaj njëri tjetrit. Të flitet për ndikimin e detyrimëve, dmth, të flasësh për sjelljen e debitorit ndaj kreditorit dhe kreditorit ndaj debitorit. Në detyrimie (debitorit) borxhliut i takojnë detyrat, ndërsa kreditori ka të drejta. Për këtë arsye efektet e detyrimëve kanë të bëjnë me detyrat e debitorit dhe të drejtat e kreditorit.⁸⁷ Detyrimi i debitorit mund të jetë ndonjë bërjë, veprim, mosbërje ose pësim. Ky detyrimi i debitorit duhet të ekzekutohet sipas përmbatjes së detyrimit. Vetë palët, pra debitori dhe kreditori, e caktojnë lëndën e detyrimit të debitorit, vendin kohën dhe mënyrën e përmbushjes së detyrimit. Debitori është subjekt pasiv, sepse ai duhet të përmbush detyrimin të caktuar, kurse kreditori është subjekt aktiv që kërkon diçka nga kjo marrëdhënie juridike. Të dy pjesëmarësit në marrëdhëniet e detyrimëve duhet të sillen ashtu siç e kërkojnë rregullat e së drejtës së detyrimëve.

Pra, në këto marrëdhënie duhet të sillen si shtëpiak të mirë, si ekonomist i mirë ose si shtëpiak i mirë në varshmëri nga marrëdhënia juridike ekzistuese. Këto rregulla janë standardet e sjelljes në qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimëve. Kjo kërkesë është kërkesë normale e cila lypset nga pjesëmarësit si duhet sjellur në përmbushjen dhe realizimin e të drejtave të veta. Të themi se kjo kërkesë rregullative kërkohej që të respektohet në praktik, andaj edhe ka vlerë të caktuar në qarkullimin juridik, për këtë arsye të drejtat nacionale edhe kanë sanksionuar me rregullativ të vaçant. Por këtyre standardëve të sjelljes debitori dhe kreditori në marrëdhëniet e tyre duhet të kenë parasysh rregullat e parimit bona fides, rregullat e parimit iustitia, rregullat e parimit bona mores, rregullat morale si dhe rregullat e parimit të ekuivalencës së prestimëve.⁸⁸

Mirëpo, ka raste kur çenohet marrëdhënia e detyrimit e krijuar nga debitori dhe kreditori. Ky cenim i marrëdhënies së detyrimit bëhet në atë mënyrë që pjesëmarrësit në këtë marrëdhënie nuk sillen ndaj njëri tjetrit ashtu siç janë marrë vesh. Duhet të theksohet se debitori është ai që në shumicën e rastëve e bën cenimin e detyrimit, në atë mënyrë që fare nuk e përmbush detyrimin (mos ekzekutimi ose mos përmbushja e plotë), ose nuk e përmbush në vend, në kohë ose në mënyrë të caktuar (përmbushja e parregullt ose e pjesërishtme).

Nga ana tjetër, edhe kreditori e bën cenimin e detyrimit në rast se nuk i ndërmer veprimet me të cilat është i lidhur ekzekutimi i detyrimit të debitorit, ose i shmanget marrjes së ekzekutimit të detyrës. Kreditori mund të paraqes padi kundër debitorit që nuk ka përmbushur detyrimin, dhe të kërkojë të merret vendimi i cili do të detyrojë debitorin ta përmbush borxhin. Pas skadimit të afatit për përmbushjen vullnetare të vendimit gjyqësor, kreditori mund të kërkojë ekzekutimin e dhunshëm të detyrimit në pasurin e debitorit.⁸⁹

⁸⁷ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, botimi I dytë, Prishtinë, fq. 225.

⁸⁸ Prof. Dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 619.

⁸⁹ Dr. Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, pjesa e përgjithshme dhe e veçant, Prishtinë, 2001. fq. 233.

Në pjesën mbi efektet e detyrimëve do të dallojmë tri nën pjesë:

- 1.Në të parën ka për tu bërë fjalë për detyrat e debitorit dhe të drejtat e kreditorit,
- 2.Në të dytën: për shkeljen e detyrimve nga ana e debitorit ose kreditorit, e veçanërisht për vonimin,
- 3.Në të drejtën përzierjen e kreditorit në marrëdhënien e pasurisë së debitorit.

2. SHKAKTIMI I EFEKTËVE KURË DETYRIMI CËNOHEN NGA KREDITORI.

Kreditori më së shpeshti është ai person,i cili e cakton afatin e përmbushjes së detyrimëve.Ai i dërgon thirrje debitorit që ta ekzekutojë detyrimin. Kjo thirrje për debitorin d.m.th edhe vërtetje për ta përmbushur detyrimin e vet. Në momentin e vërtetjes edhe këtij detyrimi i caktohet afati i ekzekutimit dhe debitori është i obliguar që menjëher pas vërtetjes ta përmbushë detyrën.Kreditori e bënë shkeljen e detyrimit, nëse nuk ndërmer veprimet e nevojshme paraprake nga të cilat varet ekzekutimi i detyrës së debitorit.(nuk ia dërgon ambalazhën në të cilën debitori duhet tja dërgoj mallin) ose i shmanget marrjes së ekzekutimit të detyrës, ose nuk bën zgjedhjen te detyrimet alternative, veprim ky, të cilin debitori do të jetë i detyruar të bëjë, ndërsa këtij(kreditori)i takon e drejta e zgjedhjes etj.

Në rastin kur debitori nuk do ta ekzekutonte fare detyrën e vet ose jo ashtu si janë marrë vesh, kreditori mundet që ta detyroj për këtë me mjetet e dhunës shoqërore.

Ai do të ngrehë padi kundër debitorit dhe të kërkojë të mirret vendimi, i cili do ta detyroj debitorin për përmbushjen e borxhit dhe, pas skadimit të afatit për ekzekutimin vullnetar të vendimit gjyqësorë, kreditori mund të kërkojë ekzekutimin me dhunë të detyrimit në pasurinë e debitorit.⁹⁰

Që kreditori të ketë të drejtë për shpërblimin e dëmit ndaj debitorit, i cili nuk ka kryer detyrën e vet të marrë përpara, duhet të vërtetojë ekzistimin e së drejtës së vet, apo detyrën e borxhliut.Faji i debitorit nuk duhet që të provohet,(argumentohet) sepse ai, te detyrat që marin më parë, supozohet se ekziston me vetë faktin se debitori nuk e ka ekzekutuar detyrën e vet.

Mirëpo, ka shtatë kur debitori nuk e ka kryer detyrën e vet pa fajin e tij. Në atë rast, ai mund të lirohet nga detyra e pagimit të shpërblimit të dëmit, nëse do të vërtetonte se mosekzekutimi e detyrës është bërë nën ndikimin e fuqisë madhore,me fajin e kreditorit ose me fajin e personit të tretë.

Edrejta e shpërblimit të dëmit i takon kreditorit për arsye të fajta për mos ekzekutimin ose vonimin e ekzekutimit të detyrës nga ana e debitorit.Lartësin e shpërblimit më së shpeshti e cakton gjyqi me vendimin e vet në kontestin, të cilin e ka inicuar kreditori kundër debitorit. Mirpo, kjo nuk është përher e domosdoshme. Te detyrimet në para shpërblimin në pikpamje të pagimit të shumës së caktuar të parave për arsye të vonësës kamata, interesi është i caktuar me ligj, edhe nëse palët me marrëveshjen e tyre nuk kanë caktuar interesin, kreditori do të ketë të drejtë për interesin ligjor.

⁹⁰ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, botimi I dytë, Prishtinë, fq. 227.

3. SHKAKTIMI I EFEKTËVE KUR DETYRIMI CËNOHET NGA DEBITORI.

Efekti i dretjepërdrejt i çdo detyrimi është për atë se debitori është i detyruar që tja ekzekutojë kreditorit atë për çka është obliguar ndërsa kreditori ka të drejtë që të kërkojë nga debitori ekzekutimin e detyrimit. Obligimi i debitorit mund të jetë ndonjë bërje (veprim, kryerje) ose ndonjë mosbërje (pësim). Shkelja e detyrimit bëhet në atë mënyrë kur pjesëmarësit në marrëdhënjen e detyrimit nuk sillen ndaj njëri tjetrit ashtu si janë marrë vesh. Debitori është i detyruar që ta ekzekutojë detyrimin e vet sipas përmbajtjes së tij. Ndërkaq, përmbajtjen e detyrës e caktojnë vetë palët debitori, dhe kreditori. Ato e caktojnë lëndën e detyrës së debitorit, vendin kohën dhe mënyrën e përmbushjes së detyrës.

Nëse debitori dhe kreditori nuk e kanë vendin e përmbushjes së detyrës, te kontratat e detyrimëve do të kuptohet se ka për tu ekzekutuar në atë vend që rrjedh nga natyra e punës, e nëse edhe në atë mënyrë nuk mund të caktohet vendi, atëherë detyrimet sa i përket sendeve të paluajtshme, ekzekutohen aty ku gjendet (faktikisht) dhe ku mbahen fletoret tokësore (juridikisht), ndërsa sendet e luajtshme dorëzohen aty ku është lidhur kontrata.⁹¹

Debitori më së shumti e bënë shkeljen e detyrimit. Ai atë e bënë në mënyrë që nuk e kryen fare detyrën (mos ekzekutimi i plotë i detyrimit), ose që nuk e përmbush në vend të caktuar, në kohën e caktuar apo në mënyrën e caktuar.

Kurë detyra përbëhet nga ndonjë veprim, atëherë ekzekutimi ka të bëjë me pagimin e shumës së parave, e cila paraqet shpërblimin e shpenzimeve, kur atë veprim e ka kryer ndonjë person tjetër, apo shpërblimin e dëmit, nëse atë veprim nuk mund ta kryejnë askush tjetër përveç debitorit. Përveç kësaj, kreditori do të ketë të drejtë që të kërkojë nga debitori, i cili nuk e ka kryer detyrën e vet dhe shpërblimin e dëmit, të cilin për atë arsye e ka pësuar. Për shkak të shkeljes së detyrimit, debitori mund ta ketë borxh, përveç, detyrës së përparme, edhe pagimin e shumës së caktuar të parave, në emër të shpërblimit të dëmit. Nëse kreditori nuk do ta kërkonte më përmbushjen e detyrës së përparme, ose do të jetë e pamundur përmbushja e këtij detyrimi, kreditori në atë rast mund të kërkojë shpërblimin e dëmit. Në vend të detyrës së përparme vendin e saj do ta zë detyra e shpërblimit të dëmit. Këtu është fjala mbi shpërblimin e dëmit për shkak të mos ekzekutimit të detyrës së marrë përpara, e jo prej deliktorëve (veprimi anti juridik).⁹²

Dhe më në fund, kreditori dhe debitori mund të caktojnë përpara me marrëveshjen e tyre shpërblimin e dëmit, të cilin debitori do tja paguaj kreditorit në rast se debitori nuk e kryen detyrën e vet, ose jo në kohë të caktuar. Ky dëmshpërblim quhet: kushti penal.

4. MOHIMI (KUNDËRSHTIMI) I PUNËVE JURIDIKE. (PADIA OSE ACTIO PAULIANA).

4.1. Kuptimi i mohimit (KUNDËRSHTIMIT)

Qysh në të drejtën romake është aplikuar i ashtu quajtur : action pauliana, me të cilën bëhet mohimi i punëve juridike. Kundërshtimi është një lloj i veçantë i pavlefshmërisë së

⁹¹ Dr. Lubish Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Botimi I dytë, Prishtinë, fq. 226.

⁹² Dr. Lubish Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Botimi I dytë, Prishtinë, fq. 227-228.

punëve juridike e cila çonë në atë që ajo e cila kundërshtohet ta humbë efektin juridik të vetë ndaj atij i cili e kundërshton dhe atë deri në atë masë sa është e nevojshme që ai ti realizojë kërkesat e tij. Ajo e cila kundërshtohet, d.m.th, lënda e kundërshtimit mundë të jetë:

-Puna juridike e njëanshme,

-Puna juridike e dyanshme ,

ose ndonjë punë tjetër(psh,zhdukja e ndonjë dokumenti në të cilin është i inkorporuar ndonjë e drejtë e cila pa atë dokument nuk mund të realizohet, lëshimi që të realizohet ndonjë e drejtë e tij).Ai i cili kundërshton ndonjë veprim juridik apo punë juridike të debitorit quhet sulmues.

Ai bënë kundërshtimin e atij veprimi juridik i cili debitori i tij e bën insolvent, d.m.th, të atillë që të mos mundë ti ekzekutoj detyrat e tij ndaj sulmuesit(kreditorit).Në këtë rast duhet cekur se sulmuese e bën kundërshtimin me anë të padis ose kundërshtimit e cila njihet me emrin si Padia ose Actio Pauliana, dhe në bazë të tyre gjykata kompetente merrë vendimin në procedurën gjyqësore përkatëse.Kundërshtimi bëhet për shkat të menjanimit të pasojave të shkaktuara nga puna juridike e kundërshtuar e cila debitorin e ka bërë insolvent.Në atë mënyrë krijohet mundësia juridike që sulmuesi ti realizoj kërkesat e tij kurse debitori i tij ti ekzekutoj detyrat e tij. Kundërshtimi është i drejtuar ndaj personit, i cili ka realizuar ndonjë dobi nga puna juridike e debitorit e cila është objekt i kundërshtimit, psh: ndaj personit të cilit debitori i ka shitur diçka shumë lirë, ose i ka falur diçka , që në atë mënyrë të bëhet insolvent dhe në atë mënyrë sulmuesi(kreditori) të mos mund ti realizojë kërkesat e tij.⁹³Këtu paraqiten tre persona :

-Kreditori, i cili është dëmtuar me punën(eventus damnum),

-Debitori, i cili ka tjetërsuar pasurin e vet personit të tretë(consilium fraudis), dhe

-Personi i tretë, të cilit debitori i ka tjetërsuar pasurinë e vet(conscentia fraudis).⁹⁴

-Kreditori do të jetë i detyruar që ta vërtetoj se me veprën juridike të debitorit është dëmtuar. Ndërkaq, do të konsiderohej se është dëmtuar, nëse për shkak të zvogëlimit të pasurisë së debitorit, ai nuk mund që ta marrë kërkesën e vet nga pasuria e ngelur e debitorit.Ai ka tentuar për atë, por pa kurrfarë suksesi. Debitori është insolvent(i zhytur në borxh).Kreditori nuk mund ta sulmojë pagimin e borxhëve të arritura kreditorëve të tjerë.Kreditori që e ka marrë pagesën nuk do të jetë në rrezik që kreditori tjetër me Padinë Pauliane tja marrë atë, të cilën ia ka paguar debitorit. Kusht tjetër është që te debitori të ekzistojë qëllimi i dëmtimit. Me veprimin që e ka ndërmarrë debitori, ai ka qenë i vetëdijshëm, që me të i shkakton dëm kreditorit të vet. Ai e din se veprimi i ndërmarrë do të ketë pasoja të këqija për kreditorin.

Që të ketë rast Padia Pauliane, kreditori është i detyruar të vërtetoj se debitori ka pasur qëllim ta dëmtojë me veprimin e ndërmarrë juridik.Këtë situatë, kur kreditori është i liruar që të vërtetoj ekzistimin e qëllimit të dëmtimit të debitorit. Ato janë rastet, kurr mirret përpara se ai qëllim ekziston te debitori dhe nuk duhet të provohet(argumentohet). Aty më së pari hynë rasti, kur debitori e tjetërsion pasurinë e vet për çmim tepër të ultë, d.m.th, e bart lëndën e pasurisë së vet, duke mos patur kujdes për vlerën e saj të vërtetë.Në atë rast do të mjaftonte që kreditori të vërtetojë se debitori me kontratën mbi shitjen, me kontratën mbi këmbimin ose me kontratën mbi dërgimin e ka tjetërsuar ndonjë lëndë me çmim të ulët dhe se pronari ka ditur, ose është dashur që të dijë se debitori e bënë atë në dëm të kreditorëve të vet.

-Debitori e tjetërsion pasurin e vet, duke mos marrë kurrfarë shpërblimi, psh:me kontratën mbi dhuratën, me faljen e borxhit, me dorëheqje nga të drejtat etj.⁹⁵

⁹³Prof ,Dr, Abdulla Aliu, E Drejta Civile, Prishtinë, 2007, fq. 170.

⁹⁴ Prof,Dr, Abdulla Aliu, E Drejta Civile, Prishtinë, 2007, fq. 169.

⁹⁵Dr, Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 234.

-Dhe, më në fundë, kushti i tretë është dija për qëllimin e dëmtimit. Është nevoja pra, që personi i tretë të dijë se debitori ndërmerr veprimin që të dëmtojë kreditorin. Personi i tretë duhet që të jetë i ndërgjegjshëm. Nuk është nevoja që personi i tretë, gjithashtu, të ketë pasur qëllim që të dëmtoj kreditorin, që të nxjerrë për veti ose për ndonjë person tjetër ndonjë dobi. Që të ketë sukses me Padin Pauliane, kreditori duhet që të vërtetojë se personi i tretë ka ditur, ose ka qenë i detyruar që të dijë për qëllimin e dëmtimit nga ana e debitorit.

Por, ka raste kur kreditori është liruar që të vërtetojë ekzistimin e dijenisë për qëllimin e dëmtimit të personi i tretë, sepse ai përpara supozohet se ekziston. Aty së pari kish për të ardhur rasti kur debitori ja tjetëron pasurinë dikujt nga farefisi i afërm. Pandërgjegjshmëria e këtyre personave supozohet se ekzistonë: gjë që nuk do të thotë se ky supozim nuk mund të rrëzohet me prova të kundërta. Mandej, këtu hynë edhe rasti kur debitori kryen disponimet pa pagesë me pasurinë e vet.

4.2. Zhvillimi historik.

Rrastet kur debitorët përpiqëshin me vëretje ti mashtronin kreditorët dhe bënë të pamundshëm realizimin e aktiveve, duke lidhur me miq kontrata të simuluar (fiktive), ose duke dhuruar pasurinë, paguheshin me dispozita mbi *fraus creditorum*. “*quau frau dationis gesta erunt cum eo, qui fraudem non ignoraverit, detyrimëve his cuartori bonorum vel ei, cuidetyrimeve ca re actionem dare oportebit intra annum, qou experimidi potestas fuerit, actionem dabo, id que etiam adversus ipsum, qui fraudem, fecit, servabo*”. Kundër sjelljes së përgjithshme të debitorëve në rastet e përmendura kishin në dispozicion: *interdictum frauditorium*, *action Pauliana* dhe *restitution in integrum ob fraudem*.⁹⁶ Koncepti i rregullt për zvogëllimin e padërgjegjshëm të pasurisë së debitorit, si me anë të tjetërsimit të sendeve të turpshme, ashtu edhe me disponim të drejtave, zhvillohej me *Actio Pauliana*.

Legjitimacion aktiv për padin Pauliana kishin të gjithë kreditorët e debitorët insolvent. Të legjitimiar pasiv ishin debitorët insolvent dhe të gjithë subjektet që kishin lidhur me ta punë juridike të dëmshme për kreditorin. Paditësi ishte i detyruar të argumentoj:

-Se me punën juridike efekti i së cilës kundërshtohet, debitori ishte bërë i varfër më të vërtet. Kur ishte fjala për mosveprim padia refuzohej. Zakonisht padia përdorej me rastin e bankrotimit dhe tërheqje *Curator bonorum*, në emër të të gjithë kreditorëve.

-Se me punën e kundërshtuar juridike kreditorët kishin pësuar dëm, dmth kur debitori me gjithë zvogëlimin e pasurisë ishte edhe solvent, padia refuzohet.

-Se debitori e kishte lidhur punën e kundërshtuar juridike i vetëdijshëm për faktin se me disponimin e tij dëmton kreditorët. Ekzistimi i vetëdijës së debitorit zakonisht merrej me mendë, mirpo debitorit i lejohej të argumentonte të kundërtën.

4.3. Veprimet që mund të kundërshtohen

Çdo veprim juridik i bërë nga debitori me qëllim që të pakësojë pasurinë e tij në dëm të kreditorit, me kërkimin e tij mund të deklarohet i pavlefshëm. Në to veprime të debitorit bëjnë pjesë: veprimet faktike, punët juridike dhe lëshimet.

⁹⁶ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçant, Prishtinë, 2001, fq. 240.

Në veprimet juridike të debitorit bëjnë pjesë:

- veprimet antijuridike,
- punët juridike të simuluar,
- mosveprimet,
- vëshimet marrëdhëniet kontraktore,
- shprehja e njanshme e vullnetit .

Në të drejtën reale veprimet e tilla ekzistojnë kur bartet pronësia, sajimi i së drejtë së pengut ose hipotekës, në renoncimin nga e drejta , në aktpajtim. Veprimi juridik që mund të sulmohet nënkupton si punën juridike, ashtu edhe veprimin faktik të debitorit që kanë sjell zvogëlimin e pasurisë së tij. Veprimi juridik që kundërshtohet quhet: veprim juridik i kundërshtuar. Nuk do të deklarohet i pavlefshëm vetëm tjetërsimi i pasurisë, por edhe heqja dorë nga trashëgimia, sepse edhe ky është një veprim juridik i debitorit që e pakëson pasurinë e tij. Por nuk mund të kundërshtohet mospranimi i një dhurate, sepse në këtë rast nuk pakësohet pasuria, por as nuk shtohet. Nuk mund të kundërshtohen punët juridike të lidhura ngusht me personalitetin e debitorit. Psh: revokimi i dhuratës.⁹⁷

4.4. Palët

Kundërshtimi i veprimëve juridike të debitorit, të cilat janë të përshtatshme për sulmim, realizohen në kontest. Palët në kontest me rastin e ngjitjes së padis Pauliane janë: kreditori, debitori dhe personi i tretë.

Paditësi: personi që ka të drejtë sulmimi në kontest, i cili paraqitet në padinë Pauliana, quhet sulmues dhe ai rëndom është paditësi në kontest. Për këtë sulmim janë të autorizuar të gjithë subjektet që kanë ndonjë kërkesë ndaj debitorit, pa marrë parasysh se kurrë është shkaktuar ajo dhe çfarë është sipas natyrës së vet. Kreditori mund të jetë çdo subjekt që mund të dëshmojë cilësitë e veta si kreditor. Çdo kreditor ka të drejtë të vërtetojë sulmimet juridike të debitorit me personat e tretë, por duhet të ketë shfrytëzuar më parë të gjitha mjetet e mbrojtjes së të drejtave të veta ndaj debitorit. Kjo do të thotë se duhet të ketë ndjekur debitorin në permbushje, të ketë marrë aktgjykimin e plotëfuqishëm të prerë dhe që të mos ketë mundur të marrë atë që i përket nga pasuria e debitorit as me mjete të dhunës.

I padituri: personi i tretë kundër të cilit ngritet padia Pauliana në kontest quhet i kundërshtuari i sulmit, dhe ai rëndom është i padituri. Subjektet kundër të cilëve mund të behet sulmimi në marrëdhënie me kreditorin, janë persona të tretë, ose subjekte në të cilët debitori ka ceduar ndonjë porosi të vet. Personi i tretë është personi që ka lidhur marrëdhënie me debitorin. Me sulmim synohet nga ajo që veprimi juridik të anulohet vetëm sa i përket marrëdhënies ndërmjet debitorit dhe atij personi të tretë, që kreditori të mund ta realizojë kërkesën e vet ndaj debitorit.⁹⁸

⁹⁷ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 239.

⁹⁸ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 241-242.

5.E DREJTA E NDALJES (IUS RETENTIONIS).

5.1.Kuptimi

Me të drejtën e ndaljes nënkuptohet e drejta e kreditorit që ndonjë send të luajtshëm të debitorit që e ka në posedim të vet, e që i përket debitorit t'ia ndalë derisa të mos realizohet kërkesa e arritur e debitorit, pa marrë parasysh se nga cila marrëdhënie juridike buron kërkesa e tij (nga delikt, kontrata sinalagmatike ose marrëdhëniet e tjera të detyrimëve).

E drejta e ndarjes është e njohur që nga e drejta romake, në të cilën detentori i sendit të huaj, që ka bërë shpenzime për riparimin e tij është bërë kreditor i pronarit të atij sendi. Pretori, në bazë të rregullave të trejtshmërisë (aequitas) i ofron mundësi detentorit për të ndalur sendin me kundërshtim (exception doli), me qëllim të realizimit të shpenzimeve për atë send.

Në të drejtën bashkëkohore, e drejta e ndarjes ka funksionin e mjetit juridik për realizimin e kërkesës së kreditorit nga sendi i debitorit.

5.2.Kushtet për ekzekutimi e së drejtës së ndaljes

Për ekzistimin e së drejtës së ndarjes duhet të plotësohen këto kushte:

- Kërkesa e kreditorit duhet të jetë arritur për ekzistim,

- E drejta e ndarjes duhet të realizohet në kërkesat me para dhe ndaj sendit të caktuar.⁹⁹

- Kërkesa e debitorit duhet të jetë e arritur për përmbushje: ky është kusht kryesor për të drejtën e ndarjes. “Kreditori i kërkesës së arritur, në duart e së cilit gjendet ndonjë send i debitorit, ka të drejtë ta ndalë derisa të paguhet kërkesa (neni 275, LMD, i RM-së, alinea 1)”.

- E drejta e ndarjes duhet të realizohet në sendet e caktuara dhe në kërkesat me para: kreditori mund ti ndalë sendet që mund të shiten, por nuk mund të ndalë autorizimin që ka marrë nga debitori, siç janë dokumentet, letrat e legjitimacionit (neni 276, LMD i RM-së alinea 2).

- E drejta e ndarjes mund të realizohet vetëm me kërkesa në të holla.

5.3.Efektet e së drejtës së ndaljes (effectus ius retentionis)

E drejta e ndarjes është mjet juridik për realizimin e kërkesës së kreditorit. Është edhe mjet dhurues, sepse kreditori nga ky send mund të inkasojë kërkesën e vet, dhe e shtynë debitorin për të ekzekutuar detyrimin e vet. Të drejtën e kërkesës kreditori e realizon në qoftë se debitori pas të drejtës së ndarjes nga ana e kreditorit nuk e përmbush detyrimin e vet, pra, “kreditori në rast se nuk realizon kërkesën e vet deri në skadimin e afatit, mund të kërkojë nga gjykata për të nxjerr vendimin për shitjen e sendit në mënyrë publike, sipas çmimit rrjedhës kur sendi ka çmimin në panair në treg” Te e drejta e ndarjes kreditori vepron në mënyrë analoge sikurse edhe kreditori i pengut.¹⁰⁰

⁹⁹Dr.Sc.Nerxhivane Dauti, E drejta e Detyrimëve, fq237, Prishtinë, 2001.

¹⁰⁰ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 238.

KREU III

III NË PËRGJITHËSI PËR VONËSËN E DEBITORI.

1.KUPTIMI

Subjektët çënojnë detyrimin edhe në rastin e vonesës, kur veprimi që pritët të përmbushet prej tyre, nuk bëhet në afatin e nevojshëm. Në vonesë mund të paraqiten si kreditor ashtu edhe debitor, pra nga ekziston edhe :

1.Vonesa e debitorit(mora debitoris)

2.Vonesa e kreditorit(mora creditvis)..

Vonesa e debitorit(sipas terminologjisë të së Drejtës Romake,(mora debitoris, mora solvendi) paraqet fajin,vonimin e palejueshëm për ekzekutimin e detyrës nga ana e borxhliut.¹⁰¹Vonesa e debitorit, ekziston kur debitori me kohë nuk e përmbush detyrën e vet ose as që ofron përmbushjen e detyrës së tij. Nga kjo rrjedh se debitori vullnetarisht ose me qëllimi nuk e ka bërë përmbushjen e detyrimit të vet. Nga kjo rrjedh se debitori vullnetarisht ose me qëllim nuk e ka bërë përmbushjen e detyrimit të vet.Nuk do të kemi vonesë, nëse debitori do ta përmbushte detyrën e vet në vend tjetër ose në mënyr tjetër .Gjithashtu, nuk mund të flasim për vonesën,nëse debitori nuk mund që atë ta krijojë fare për shkakë të pamundësisë.Për vonesën e debitorit ekziston rregullativa në të drejtën nacionale(LMD i RM-së neni 313)

Sipas këtyre rregullave debitori vjenë në vonesë kur nuk e përmbush detyrën e vet në afat të caktuar për përmbushje,(po i njeiti nenë,alinea,2).Nëse afati i përmbushjes nuk është i caktuar debitori vjen në vonesë kur kreditori e fton që të përmbush detyrën e vet dhe këtë gojarisht ose me shkrim, me vëretje jashtëgjyqësore ose duke nisur ose ndërmarrë veprime qëllimi i të cilave është realizimi i përmbushjes së detyrimit. LMD i RM-së neni 251 alinea,5, ka sanksionuar rastet kur nuk është e nevojshme vënia në vonesë e debitorit. Keshtu do të jetë kur debitori ka deklaruar me shkrim se nuk dëshiron ta ekzekutojë detyrimin, kur ka kaluar afati brenda të cilës do të ekzekutohej detyrimi.Të njejten çështje ka parapar edhe(neni 252 i LMD i RM-së) , ku thuhet: debitori lirohet nga obligimi i përmbushjes së detyrimit nëse dëshmon se nuk ka mund ta përmbush detyrimin , gjegjësisht ka ran ë vonesë për këtë përmbushje përshkak rrethanave të lidhjes së kontratës të cilë nuk ka mund që pengojë.Por , kur debitori vdes dhe afati i caktuar për ekzekutimin e detyrimit mbaron pas vdekjes së tij, trashëgimtarët e tij bien në vonesë me kalimin e 15 ditëve nga dita e njoftimit me shkrim nga ana e kreditorit dhe në fund, kur detyrimi rrjedh nga një akt i paligjshëm ose i kundërligjshëm.¹⁰²Përndryshe, për dëmin nga shkak i vonesës në përmbushjen e detyrimit përgjigjet debitori të cilit kreditori ia ka caktuar afatin plotësues për përmbushje, (LMD i RM-së neni 251 alinea 3).Ai përgjigjet edhe për pamundësinë e pjesshme dhe të plotë të përmbushjes edhe pse nuk është fajtor për

¹⁰¹ Dr, Lubish Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Botimi I dytë, Prishtinë, fq. 228.

¹⁰² Prof.Dr, Alajdin.S.Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 620.

mospërmbushjen, në qoftë se pamundësia është shkaktuar pasi që debitori ka ardhur në vonesë për të cilën ai përgjigjet, (LMD i RM-së neni 251 alinea 4) .

Dhe në fund, debitori lirohet nga përgjegjësia për dëmin në qoftë se vërtetohet se sendi i cili ka qenë lënd e detyrës është zhdukur rastësisht dhe se ai detyrën e vet me kohë do ta përmbush. Këtë rrethanë në (nenin 252 i LMD I RM-së) e ka përforcuar, duke konstatuar se debitori lirohet nga përgjegjësia për dëmin nëse provon se nuk ka mundur ta përmbush detyrën e vet, përkatësisht është vonuar në përmbushjen e detyrës për shkak të rrethanave të shkaktuara pas lidhjes së kontratës të cilat nuk ka mundur ti pengojë, ti evitoj ose ti shmang. Nuk ekziston vonesa nëse debitori do ta përmbush detyrën e vet në vend tjetër ose në mënyrë tjetër, si dhe në rastin kur debitori atë nuk mund që ta kryej fare për shkak të pamundësive.¹⁰³ Që të shfaqej vonesa e debitorit, përveç fajta të debitorit kërkohej të plotësohen edhe disa kushte:

1. Nuk mund të kishte vonesë debitori kur nuk ekzistonte detyrimi i mbrojtur juridik.

Detyrimet e mbrojtura jurodike ishin të gjitha detyrimet që buronin nga kontratat, deliktet dhe *variae causarum figurae*. *Obligationes naturales* nuk hynë në grupin e detyrimëve të gatshme për të lindur vonesën e debitorit.

2. Që të kishte vonesë debitori, nevojitej të ekzistonte detyrimin i maturuar.

Detyrime të maturuara apo detyrime të cilave u kishte ardhur afati i kryerjes (dies *veniens*) ishin të gjitha ato që kreditori mund ti paditë pa ndonjë rezik se do të refuzohej për shkak të *petition tempore*.¹⁰⁴

3. Që të shfaqej vonesa e debitorit, nevojitet që kreditori të kërkoj kryerjen: *interpellation creditoris*. Kreditori nuk ishte i detyruar të kërkoj kryerjen vetëm në obligatat që krijoheshin nga deliktet e vjedhjes: *fur semper moram facere videtur*, në obligatat në të cilat si kreditor ishin personat e mitur, kur jepej liria me *fideikomis* dhe në aktivet me afat të përcaktuar me kalendar të pagimit. Ftesën mund ta bëjë me gojë, me shkrim, me anë të gjykatës, jashtë gjykatës, me anë të paraqitjes së padis, kundërpadis, me prezentimin e kambialit, me anë të faturës së dërguar etj. Kjo vëretje është e plotëfuqishme nëse bëhet vetëm për borxhin të cilin e kërkon kreditori. Kjo vëretje nuk ka efekt në qoftë se detyrimi është i afatizuar. Kurse vëretjen mund ta bëjë kreditori ose trashëgimtari i tij debitori ose trashëgimtarët e tij. Përndryshe, vëretja nuk duhet të jipet për detyrimet e afatizuara, sepse debitori bie në vonesë me kalimin e kohës së përmbushjes.¹⁰⁵ Në rastet e përmendura debitorët ishin të detyruar që me vetë iniciativë ti kryejnë prestimet e premtuara, kurse vonesa e tyre bëhet *ex ipsa re*. Atëherë aplikohet rregulla: *dies interpellat pro homine*.

4. Debitori i cili me fajin e tij, as pas thirrjes së kreditorit, nuk e plotësonte detyrimin e merituar, të mbrojtur juridikisht, i shtrohej pasojave negative të mora debitoris. Pas hapjes së vonesës përgjegjësia e debitorit përforcohej shumë. Prej momentit të vonesës, debitorët përgjigjeshin edhe për shkatërimin e sendit rastësisht, me fjalë të tjera përgjigjeshin edhe për veprimin e fuqis madhore (*casus leviores*, *casus minors*), por vetëm atëherë kur ishte fjala për ngjarje të tilla, veprimi i të cilave mund të pengohej sikur të qenë parashikuar qysh më parë. Këtë prov duhet ta nxjerin kreditorët patjetër. Kur kreditorët vërtetonin se sendi nuk do të shkatërrohej sikur debitori ta kishte detyrimin në kohë, debitorët mernin persipër përgjegjësin e plotë. Pasoja e dytë e vonesës ishte përgjegjësia e debitorit për shpagimin e dëmit që i ishte bërë kreditorit për shkak të kryerjes me vonesë të obligatës. Dëmi përfshinte *damnum emergens* apo

¹⁰³ Dr.Sc, Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 234.

¹⁰⁴ Dr.Ivo Puhani, E Drejta Romake, Prishinë, 1989, fq. 403-404.

¹⁰⁵ Prof.Dr, Alajdin.S.Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 621-622.

dëmin e pësuar realisht dhe luerum cessans apo fitimin e lëshuar. Fitimi i lëshuar për shkak të moskryerjes të aktiveve monetare e të tjeta të sendeve të zëvendësueshme caktohej me kamata të ashtu quajtura vonesë apo moratore, ndërsa për shkak të moskryerjes së detyrimëve të tjera caktohej sipas rrethanave. Pasoja më e rëndësishme e vonesës së debitorit ishte drejta e kreditorit të inicojë padi e parapar për mbrojtjen e disa marrëdhënieve obligatore, pa ndonjë frikë se do të rrefuzohet për shkat të plus petition temper dhe që pas marrjes së aktgjykimit, nëse e argumenton ekzistimin e të drejtës së vet, të kërkojë kryerjen ose ndaj personit të debitorit ose mbi pasurinë e tij.¹⁰⁶

2. KUSHTET

Për ekzistimin e vonesës së debitorit duhet të plotësohen këto kushte :

- detyra e debitorit të arrije për përmbushje
- kreditor duhet ti paraqes vëretje debitorit
- debitori të jetë fajtor për vonesën.

-detyra e debitorit të arrije për përmbushje: me arritjen e detyrimit për përmbushje skadon afati për përmbushjen e detyrimit të detyrimit. Detyrimi do të arrijë për pagim, kur kreditori e fton debitori për përmbushjen e detyrimit të plotëfuqishëm dhe jo kontestues.

Me fjalë të tjera, themi se detyrimi ka arritur për përmbushje kur kalon dita e fundit e përmbushjes së saj. Për të aritur detyrimi për përmbushje duhet të jetë i plotëfuqishëm. Kjo vlen për detyrimet që kanë afatin e përmbushjes. Ndërsa detyrimet që nuk kanë afat të përmbushjes përmbushja dyhet të bëhet menjëher pas kërkesës së kreditorit (LMD, i RM-së neni 303).

LMD ka parapar mundësin e përmbushjes para afatit të detyrimit, ku thuhet : nëse afati është i kontraktuar në interes të debitorit, ai ka të drejtë ta përmbush detyrimin edhe para skadimit të afatit , por është i detyruar ta informoj kreditorin për qëllimin e vet, dhe kjo të mos jetë në kohë të papërshtatshme, (LMD i RM-së neni 304, aline 1) nga ana tjetër LMD i RM-së ka parapar rastet kur debitori mund të ofroj përmbushjen para afatit , kreditori mund të kundërshtoj përmbushjen , ose mundet edhe të përkrah të drejtën e shpërblimit të dëmit .¹⁰⁷

-kreditor duhet ti paraqes vëretje debitorit: kreditori duhet t'ia tërheq vëretjen debitorit për mos ekzekutimin e detyrimit të vet. Vëretja mund të paraqitet me gojë, me shkrim, përmes (me ndërmjetësim) gjykatës, me anë të ngehjes së padis, kundërpadisë, me paraqitjen e kambialit, me anë të mos dërgimit të faturës. Vëretja nuk mund të paraqitet për detyrimet e afatizuara, sepse debitori bie në vones me skadimin e kohës për përmbushje, “dies interpellat pro homine”-dita e tërheq vëretjen në vend të njeriut. Vëretjen mund ta bëjë kreditori ose përfaqësuesi i tij dhe duhet ti drejtohet debitori.

-debitori të jetë fajtor për vonesën: rreth këtij kushti nuk ekzistojnë qëndrime unike në doktrinën juridike, rregullativë dhe në praktikën gjyqësore. Këtë po e themi, sepse në të drejtën bashkëkohore vonesa kuptohet në kuptimin subjektiv ose objektiv. Sipas mendimit subjektiv vonesa ekziston në qoftë se debitori në bazë të fajta të vet bie në vones. Ndërkaq sipas mendimit objektiv ekziston kur debitori vonohet në përmbushjen e detyrimit të vet, pa marrë parasysh faktin se a është fajtor për të apo jo. Nga kjo rregullativ rrjedh se vonesa e debitorit kuptohet si në aspektin subjektiv ashtu edhe atë objektiv, si dhe ka ligje që përkrahin të dy kuptimet siç është rasti me LMD. Në të drejtën bashkëkohore përcaktimi është dominues që vonesa e debitorit të

¹⁰⁶ Dr. Ivo Puhan, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 1989, fq. 404.

¹⁰⁷ Prof. Dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 621.

kuptohet në kuptimin objektiv. Kjo do të thotë se për vonesën e tij nuk është e domosdoshme që ai të jet edhe fajtor. Kjo është e mirrë, meqë kuptimi subjektiv nuk mend të eliminohet në tërësi.¹⁰⁸

3. PASOJAT NGA VONESA E DEBITORIT

Debitori që vonohet është fajtor për mosekzekutimin me kohë të detyrimit. Faji i debitorit për mos ekzekutimin me kohë të detyrimit prezumohet se ekziston dhe ai do të përgjigjet, derisa nuk vërtetohet se vonesa për përmbushjen e detyrës së vet është bërë pavarësisht nga vullneti i tij, nga ndikimi i fuqisë madhore, me faljin e kreditorit ose subjektit të tretë.¹⁰⁹

Vonesa e debitorit e keqëson pozitën e tij në raport me kreditorin. Vonesa e debitorit sipas rregullave cakton pasoja juridike. Këto pasoja rëndojnë pozitën e debitorit ndaj kreditorit. Këtë po e themi, se debitori tani jo vetëm që duhet të paguaj borxhin e vet por atij i shtohet obligimet për shkat të vonesës. Në rast se debitori është i vonuar në detyrim me para, përveç borxhit kryesor, debitori ka për detyrë të paguaj edhe kamatën e vonesës. Pra, me rënien në vonesë të debitorit, kreditori ka të drejtë të kërkoj përmbushjen e detyrimit dhe shpërblimin e dëmit për shkak të vonesës së tij.¹¹⁰ Ai gjithashtu ka të drejtë të kërkojë zgjedhjen e marrëdhënies së detyrimit dhe shpërblimin e dëmit për shkak të kësaj zgjedhjeje të marrëdhënies së detyrimit. Nëse debitori ka detyrë tja kthejë sendin kreditorit, ky nuk ka të drejtë të kthejë vetëm sendin, por edhe frytet që ia ka sjellë ai, në rast se debitori është i pandërgjegjshëm.

Debitori që vonohet ka edhe rrezikun që ta humb sendin (sepse debitori nuk mund të lirohet nga detyrimi, në rastin e fuqisë madhore), e përveç kësaj debitori është i detyruar tja shpërblejë kreditorit dëmin që e pëson ai për shkak të vonesës.

Pra në qoftë se debitori ka obligim që tja kthejë sendin kreditorit, atëher ai i kthen edhe frytet që ka sjell ai send, po që se debitori është i pandërgjegjshëm për vonesën e vet.

3.1. Pagesa e kamatës:

Kamta është institucion juridik sepse egziston një grup i rregullave që mundësojnë organizimin juridik të saj në qarkullim. Është e rregulluar sipas, (LMD-së së RM-së, neni Norma e interesit kontraktues përcaktohet nga vet palët, (neni 388, alinea 1). Nëse interesi është kontraktuar, por norma e tij nuk është përcaktuar, as koha, do të zbatohet norma e kamatës sipas Bankës Kombëtare të RM-së, e cila ishte e vlefshme në kohën e lidhjes së kontratës dhe fillon me kërkesën kryesore, (i njëjti nenë, alinea, 2). Nëse detyrimi shprehet në monedh të huaj ose përcaktohen në monedh monedh të huaj, në rast se nuk është përcaktuar ndryshe, dmth nëse nuk është përcaktuar me ligj, kreditorit i takon kamata në monedhën vendëse, në shkallën më të ulët të interesit të paguar në bank, pasë pamjes së depozitave në valutën e huaj në vendin e kryerjes së aktivitetit, (po i njëjti nenë, alinea, 3). Nëqoft se debitori nuk e paguan kamatën në kohën e përcaktuar, do të ketë ritje të kamatës ligjore.

¹⁰⁸ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 235.

¹⁰⁹ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 235.

¹¹⁰ Prof.Dr. Alajdin.S Alishani, E Drejta e detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 622.

3.2.Kthimi i frutave

Duke u bazuar në të drejtën sendore frutat janë send aksesori, dhe deri në ndarjen nga sendi kryesor janë pronsi pronsi e pronarit të sendit kryesor. Frutat janë sende që sendi kryesor i jep periodikisht, por që janë të destinuara për ndarje: ose frutat në formën natyrore janë produkte të cilat ndonjë send i jep periodikisht pa e harxhuar substancën e vet , por janë të destinuara për ndarje .Frutat janë të gjitha produktet natyrrë dhe juridike që krijohen nga vlerat pasurore ose nga përdorimi faktik dhe juridik i saj.

Frutat ndahen në:

- fruta natyrore dhe
- fruta civile .

Frutat natyrore janë sende që i jep sendi ,pa e humbur substancën e vet.¹¹¹

Frutat civile janë frutat të një sasi ose të një drejte jopersonale janë përfitimet natyrore dhe ligjore , të cilat drejtpërdrejt burojnë nga pasuria apo e drejta jopersonale ,nga përdorimi faktik dhe juridik i tyre pa zvoglimin e vlerës së pasurisë ose të së drejtës jopersonale.¹¹²

3.3.Reziku i humbjes së sendit.

Gjatë vonësës debitori heq rrezikun e sendit po që se gjatë kohës së vonësës së vet sendi ose lënda e detyrimit zhduken nga fuqia madhore. Në qoftë se debitori ka për obligim që t'ia kthejë sendin kreditorit atëherë ai i kthehet edhe ftytet që ka sjellë atë send, po që se debitori është i pandërgjegjshëm , fajtor ,për vonësën e vet.

3.4.Shpërblimi i dëmit.

Dëmi është një ndër burimet materiale të marrëdhënieve të detyrimeve.Marrëdhënia juridike lind ngase i është shkaktuar dëm tjetrit dhe ai duhet t'i shpërblehet atij.Që të mund të bëhet fjalë për shpërblimin e dëmit, është e nevojshme që, sëpari, të ekzistojë dëmi, që të jetë shkaktuar një humbje në pasurinë e dikujt ose, përgjithësisht, të jetë cenuar ndonjë e drejtë e tij.Dëmi është njëri nga kushtet themelore për përgjegjësinë juridike-civile. Në bisedat e rëndomta me fjalën dëm nënkuptohet çdo humbje, pavarësisht nga natyra e saj. Në këtë kuptim, thuhet se është dëm kur dikush sëmuret, kur lëshon një rast të mirë etj.

Me fjalën dëm kuptohet çdo përjetim i ndonjë të keqeje.¹¹³Por, në kuptimin e ngushtë juridik, me fjalën dëm konsiderohet cënimi i vlerave juridikisht të mbrojtura.LMD, si dhe ligjet e detyrimeve në shum shtete, nuk e përcakton saktësisht kuptimin e dëmit, por jep orientime në bazë të cilave mund të përcaktohet kuptimi i tij. Në kuptimin juridik, dëmi paraqet zvogëlimin e pasurisë së ndokujt(dëmi i thjeshtë)dhe pengimin e shtimit të saj(fitimi i humbur), si dhe shkaktimin e dhimbjeve fizike ose psikike ndaj tjetrit ose frikës (dëmi jomaterial),(LMD i RM-së,neni 142).

¹¹¹ Prof.Dr. Alajdin.S Alishani, E Drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2002, fq. 623.

¹¹² www.google.com reziku i humbjes së sendit.

¹¹³ www.juristi.info

Detyrimi për shpërblimin e dëmit paraqitet si sanksion, që në momentin e lindjes së përgjegjësisë civile. Detyrimi për shpërblimin e dëmit bie mbi personin përgjegjës që ka shkaktuar dëmin. Bazuar në rregullat e së drejtës kur dikush dikujt i shkaktonte dëm, është i detyruar që t'ia shpërblejë dëmin e shkaktuar, poqese plotësohen dhe kushtet e caktuara, (LMD i RM-së, neni 141, alinea, 1). Duke shpërblyer dëmin e shkaktuar, synohet që të vendoset ajo gjendje që ka ekzistuar para momentit të shkaktimit të dëmit. Megjithatë, duhet bërë dallimin ndërmjet shpërblimit të dëmit deliktor nga ai kontraktor, pasi tek shpërblimi i dëmit deliktor detyrimi i debitorit buron nga ligji, kurse tek përgjegjësia kontraktore detyrimi i debitorit buron nga kontrata.

Edhe sot, gjykatësi me rastin e sjelljes së vendimit për shpërblimin e dëmit i referohet asaj që është e drejtë objektive në një vend, duke marrë për bazë plotësimin e kushteve për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar, me ç'rast lind dhe detyrimi i dëmtuesit për shpërblim të dëmit. (LMD i RM-së, neni 143, alinea, 2). Bazë e përgjegjësisë, për detyrimin për shpërblimin e dëmit të një personi të caktuar është vetë fakti i shkaktimit të dëmit. Kjo parashihet edhe në (LMD i RM-së, neni 141) sipas të cilit ai i cili i shkaktonte dëm tjetrit është i detyruar që ta shpërblejë. Qëllimi i detyrimeve nga shkaktimi i dëmit është shpërblimi i dëmit pasuror që ka pësuar i dëmtuari.

Me termin shpërblim të dëmit, nënkuptojmë detyrën juridike me të cilën ngarkohet dëmtuesi që të shpërblejë subjektin e dëmtuar qoftë në aspektin material qoftë në atë moral. Shpërblimin e dëmit në parim e bën dëmtuesi ose subjekti përgjegjës, kurse kërkesën për shpërblim në parim e parashton personi i dëmtuar. Pra, shpërblimi i dëmit nuk ka për qëllim që të shton pasurin e subjektit të dëmtuar, e as ta vë në pozite varfërie subjektin përgjegjës.

Qëllimi i përgjegjësisë pasurore-juridike nuk është dënimi, por riparimi i dëmit të shkaktuar, çka do të thotë se si synim i të drejtës moderne është jo përgjegjësia, por mënjanimi i veprimeve dhe pasojave të dëmshme. Esenca qëndron në atë se riparimi i dëmit me anë të shpërblimit të tij, për tu krijuar gjendja që ka ekzistuar përpara shkaktimit të dëmit. Çështja e çastit të detyrimit për shpërblim të dëmit dhe prezumimet procedurale, zënë vend të rëndësishëm në doktrinën juridike. Përmes shpërblimit të dëmit, përveç që synohet të riparohen pasojat e dëmit, gjithashtu sanksioni i tillë ka për qëllim në një aspekt edhe ndëshkimin e personit përgjegjës që ka shkaktuar dëmin për shkak të veprimeve të fajshme apo për shkak të pakujdesisë në lëshimet eventuale që mund t'i ndodhin. Mënyra e shpërblimit të dëmit që shqiptohet si ndëshkim ndaj subjektit përgjegjës ka qenë karakteristike për periudhat e hershme të zhvillimit të shoqërisë. Por sot, ky qëndrim nuk vjen në shprehje pasi kemi situata ku personi tjetër e shkaktonte dëmin, ndërsa një subjekt i tretë është i detyruar që ta shpërblejë, dhe se shpërblimi i dëmit sot ka për synim riparimin e pasojës së dëmshme. Me realizimin e shpërblimit të dëmit, pasojat e dëmit kalojnë definitivisht në anën e personit që ka shkaktuar dëmin, sepse tani për personin e dëmtuar ose kthehet gjendja e mëparshme ose merr shpërblimin në të holla, duke marrë parasysh dëmin të cilin e ka pësuar. Që të konsiderohen të zhdëmtuara pasojat e dëmit, duhet që në tërësi të shpërblehet i gjithë dëmi, si dëmi real ashtu edhe fitimi i munguar.¹¹⁴

Dëmi mund të jetë: - material (pasuror) dhe
- jomaterial ose moral.

- Dëmi material dhe llojet e tij. Me dëmin material kuptojmë cenimin e vlerave pasurore të ndonjë personi fizik apo juridik. Dëmi material shkaktohet më së shpeshti me asgjësimin, dëmtimin apo marrjen e sendit, bërjen të pamundur ose vështërsimin e shfrytëzimit të sendit, për mënjanimin e të cilave kërkohen shpenzime. Kemi të bëjmë me dëm material edhe në

¹¹⁴ www.doktoratura.edu

rast të shkaktimit të lëndimeve trupore – cenimi i integritetit fizik, humbja e aftësisë për punë, për të cilin shkak mund të humbasin të ardhurat mbi bazë të punës, si dhe në rast të shkaktimit të vdekjes së ndonjë personi.

Dëmi material mund të ndahet:

- në dëm real ose të thjeshtë (damnum emergens) dhe
- fitim të humbur (lucrum cesans).

Dëm material është zvogëlimi i pasurisë ekzistuese të të dëmtuarit. Kështu ndodh kur ndokuj i dëmtohet në tërësi automjeti në aksident trafiku, kur dikush ia then dorën personit tjetër, kur dikush u ekspozohet shpenzimeve lidhur me fikjen e zjarrit të vënë nga një person tjetër. Fitimi i humbur ekziston në rast të pengimit të shitmit të pasurisë së personit të dëmtuar. Fitimi i humbur është ai që, sipas rrjedhës së rregullt të gjërave ose rrethanave të veçanta, me të drejtë është pritur të realizohet, por kjo është penguar me veprimin ose lëshimin e dëmtuesit (LMD i RM-së, neni 189). Kjo ndodh kur shoferit, i cili ushtron profesionin e taksistit, dëmtuesi ia dëmton automjetin, për të cilin shkak ai, për një kohë të caktuar, nuk mund ta ushtrojë profesionin, apo kur, për pasojë të lëndimeve trupore, tek i dëmtuari është shkaktuar humbja e aftësisë për punë, për të cilin shkak nuk mund të realizojë të ardhura nga marrëdhënia e punës, të cilat do t'i kishte realizuar sikurtë mos ndodhte ngjarja dëmtuese.

-Dëmi moral ose jomaterial. Me dëm jomaterial kuptojmë cënimin e vlerave jopasurore, përkatsisht cënimin e vlerave personale të ndonjë personi. Dëmi jomaterial ekziston në rast të shkaktimit të dhimbjeve fizike, dhimbjeve shpirtërore, zvogëlimit të aktivitetit jetësor, shëmtimit, cënitit të prestigjit e të nderit, cënitit të lirive dhe të drejtave të personalitetit, shkaktimit të vdekjes së personit të afërm dhe shkaktimit të frikës, (LMD i RM-së, neni 189, alinea 1).

Bazat e përgjegjësisë: Që të ekzisojë përgjegjësia për shpërblimin e dëmit, duhet të plotësohen këto kushte:

- të ekzisojë dëmi,
- që dëmi të jetë shkaktuar me veprim ose lëshim të kundërligjshëm të dëmtuesit,
- që të ekzisojë faji i dëmtuesit dhe
- të ekzisojë lidhja shkakësore mes veprimit dëmtues dhe pasojave - dëmit.

Veprimi është i kundërligjshëm kur është në kundërshtim me normën juridike, moralin shoqëror, me të cilin cenohet ndonjë e drejtë subjektive e të dëmtuarit. Megjithatë, ekzistojnë veprime të njeriut të cilat nuk janë të kundërligjshme, por dëmtuesi është përgjegjës për shpërblimin e dëmit. Një përgjegjësi e tillë ekziston: kur dëmtuesi e shkakton dëmin, duke ushtruar ndonjë të drejtë që i takon, por me rastin e shfrytëzimit të saj nuk bën t'i kalojë kufitë e lejuar, kur shfrytëzimi i së drejtës do të shndërrohej në keqpërdorim të së drejtës; kur dëmi shkaktohet me pëlqimin e të dëmtuarit; kur dëmi është shkaktuar nga personi zyrtar gjatë kryerjes së punës zyrtare, në kuadër të autorizimeve të veta; kur dëmi shkaktohet në mbrojtje të nevojshme; kur dëmi është shkaktuar në gjendje të nevojshme ekstreme dhe në rastin kur dëmi është shkaktuar në vetëndihmë të lejuar.¹¹⁵

Lartësia e shpërblimit të dëmit jomaterial, si problem parashtrohet vetëm atëherë kur dëmi duhet të zhdëmtohet në të holla. Duhet theksuar se në praktikë, shpërblimi i dëmit në të holla nga dëmi i shkaktuar paraqet mënyrën më të shpeshtë të shpërblimit të dëmit material apo jomaterial, kurse në disa raste, paraqet mënyrë të vetme, pasi konsiderohet si variant më i përshtatshëm për mbulimin e pasojës së dëmit. Lartësinë e shumës së parave për shpërblimin e

¹¹⁵ www.juristi.info.

dëmit e cakton gjykata kompetente në kontest civil. Kur kemi të bëjmë me shpërblimin e dëmit material, i njëjti duhet të përmbushet në tërësi, sikurse dëmi real, poashtu edhe fitimi i munguar. Neni 174, I LMD së RM-së, alinea 1, thotë: personi përgjegjës është i detyruar të përcaktoj situatën që ishte para se të ndodhte dëmi. Nëse gjendja e mëparshme nuk e largon dëmin krejtësisht, personi përgjegjës është i detyruar të jap kompenzim në të holla për pjesë tjetër të dëmit, (po i njëjti nenë alinea, 2). Kur krijimi i gjendjes së mëparshme nuk është i mundur, ose kur gjykata e konsideron atë që personi nuk është e nevojshme ta bëjë atë, gjykata do të vendos ta paguaj pjesën e dëmtuar të të hollave si shpërblim të dëmit, (po i njëjti nenë alinea 3). Gjykata do të japë dëmshpërblimin e dëmtuar në gatshme kur e kërkon, nëse rethanat e rastit të dhënë arsyetojnë themelimin e ish kushtit, (po i njëjti nenë alinea 4).

Ndërsa kur jemi të shpërblimi i dëmit jomaterial, për dallim nga e kaluara, ku me rastin e caktimit të shpërblimit, gjykatësit ndonjëherë sillnin vendime shumë subjektive dhe arbitrare, sot janë përcaktuar disa kritere edhe, me rastin e vlerësimit të të mirës jomateriale të dëmtuar. Në rast të shkeljes së drejtave të personit, gjykata mund të urdhëroj me shpenzimet e dëmtuesit, publikimi i aktgjykimit të dëmtshëm për të marrë atë tërheqje të deklaratës me të cilin është bërë lëndimi, ose diçka tjetër me të cilën është bërë lëndimi, ose diçka tjetër me të cilën është aritur qëllimi i kompenzimit, (LMD i RM-së, neni 188). Gjykatësi me rastin e përcaktimit të intensitetit të dëmtimit trupor duhet të ketë kujdes që mos të gjykojë edhe për raste të lëndimeve apo gërvishtjeve të vogla, pasi kjo do të shërbente vetëm për komercializëm dhe jo për ndreqje të pasojave të dëmit, (LMD i RM-së neni 189, alinea, 2).

Procedura e realizimit të së drejtës në shpërblimin e dëmit : qëllimi i ekzistimit të përgjegjësisë juridike civile për dëmin e shkaktuar, është shpërblimi i dëmit pavarësisht lartësisë së tij. Kjo për palën e dëmtuar e cila në këtë marrëdhënie juridike është në pozitën e kreditorit është një e drejtë. Kurse për dëmtuesin i cili në këtë marrëdhënie është në pozitën e debitorit do të thotë që vetëm i dëmtuari të relizoj të drejtën në shpërblimin e dëmit, pasi një të drejtë të tillë mund ta realizojn edhe personat tjerë që bëjnë pjesë në anën e të dëmtuarit, sidomos në rastet kur shkaktohet dëmi jomaterial.

Realizimi i të drejtës për shpërblim të dëmit, pavarësisht se kush do të jetë përgjegjës, përkatësisht i detyruar për shpërblim të dëmit, bëhet vetëm në qoftëse plotësohen prezumimet procedurale juridike. Kjo do të thotë se personi i dëmtuar nuk do të mund t'a realizojë të drejtën për shpërblim të dëmit me vetë faktin e shkaktit të dëmit, por ai duhet edhe të parashtrijë kërkesë për shpërblimin e dëmit. Shpërblimi për dëmin e shkaktuar realizohet në kontestin e veçantë civil. Procedura inicohet vetëm me anë të parashtrimit të kërkesëpadisë nga i dëmtuari (paditësi), me të cilën paraqitet kërkesa konkrete në pikëpamje të shpërblimit të dëmit, faktet ku mbështetet kërkesa, provat dhe vlera e kontestit.¹¹⁶

4.SHUARJA E VONESËS SË DEBITORIT.

Shuarja e vonesës së debitorit mund të shkaktohet në raste kur ofron më vonë përmbushjen e detyrimit të vetë së bashku me detyrimet tjera aksesore. Vonesa e debitorit mund të shuhet :

1. Kur kreditori zgjat afatinë e përmbushjes së detyrimit të vet me detyrimin aksesorë,

¹¹⁶ www.doktoratura.edu

- 2.Kur kreditori e zgjat afatin për përmbushjen e detyrimit të debitorit,
- 3.Kur kreditori e tërheq vëretjen e vet që ia ka paraqitur debitorit.

4.1. Shuarja me përmbushje.

Pagesa është mënyrë e zakonshme e kryerjes së detyrimëve e cila sjell në zhdukje borxhin.Nën pagesë duhet të kuptohet jo vetëm, si në gjuhën e përditshme ,mënyrë e pagesës së një shumë parash, por edhe cilado mënyrë e kryerjes së një detyrimi.Është e sakt se shprehja nuk përdoret shumë për shërbimet, respektivisht ish detyrimet të bëhet madje edhe nëse , teknikisht, mund të përdoret shprehja e përgjithshme sipas së cilës kreditori duhet të paguaj borxhin e vet. Posaçërisht ,për shërbime , mënyra konkrete e kryerjes është shumë e ndryshueshme varësisht nga marrëveshja, sepse kreditori duhet të bëjë sakt atë që është i detyruar ta bëjë.Rregullat e përgjithshme të pagesës janë më shumë të përshtatura në detyrimet ti dërgohet diçka debitorit, e madje edhe, më saktë, në detyrimet monetare.¹¹⁷Duke trajtuar mënyrën e tillë të shuarjes së detyrimëve, do ti shqyrtojmë veçmas këto çështje:

- 1.Kuptimi
- 2.Natyra juridike e pagesës,
- 3.Subjektet e pagesës,
- 4.Lënda e pagesës,
- 5.Koha e përmbushjes,
- 6.Vendi i pagesës,
- 7.Efekti i pagesës, dhe
- 8.Vërtetimi i pagesës.

4.1.1.Kuptimi.

Pagesë do të thotë përmbushje, ekzekutimi i detyrimit. Pagesa si mënyr e shuarjes së detyrimëve ka kuptim më të gjërë, se sa domethënia e saj në bisedën e përditshme.Ajo nuk do të thotë vetëm dorëzimi i shumës së caktuar të parave, e cila është lëndë e borxhit, por edhe kryerja e çdo veprimi tjetër, i cili mund të paraqesë përmbatjen e detyrimit (dorëzimin e ndonjë sendi tjetër, kryerja e ndonjë veprimi faktik apo juridik , mosbërja, abstenimi, pësimi).Në çdo rast përmbatja e pagesës është caktuar me përmbatjen e borxhit nga i cili rrjedh detyrimi.

Që veprimi i borxhliut të ketë domethënien e pagesës duhet që ajo të jetë ndërmarrë me qëllim që të bëhet shuarja (përfundimi) e detyrimit.Nëse te borxhliu nuk do të ekzistonte vullneti për pagesë , veprimi i ndërmarr do të ketë domethënie tjetër.Aty tani, do të ekzistonte qëllimi i debitorit që me kreditorin të krijojë ndonjë marrëdhënie të re detyrimi, e jo që të shuhet detyrimi ekzistues.¹¹⁸Për këtë rast të shuarjes së detyrimëve në të drejtën nacionale ekzsitojnë rregullativa:(LMD nenet:285.286).Nga kjo rregullativë rrjedh padishim se ekzistojnë rregulla të përgjithshme lidhur me përmbushjen e detyrimëve, por rregulla që janë specifike të cilat edhe karakterizojnë këtë rast të shuarjes së detyrimëve.Nga kjo rregullativ gjithashtu rrjedh se potencohet shuarja e detyrimëve në këtë mënyrë ose sipas ligjit, sepse në këtë mënyrë kontribuohet së tepërmi për rregullsitë e shumta në qarkullim dhe në rrjedhën normale të tyre.¹¹⁹

¹¹⁷ Muriel Fabr-Manjan, E Drejta Obliguese, Shkup, 2007, fq. 586.

¹¹⁸ Dr, Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 238.

¹¹⁹ Prof.Dr. Alajdin Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 668.

4.1.2.Natyra juridike e përmbushjes.

Për natyrën juridike të përmbushjes së detyrimëve në doktrinë nuk ekziston qëndrim unik. Sipas një mendimi përmbushja e detyrimit ka karakter të punës së dyanshme juridike. Kështu është sepse debitori e ofron përmbushjen kurse kreditori e pranon atë, ndaj në këtë mënyrë shuhet detyrimi. Kjo teori është përkrahur në doktrinën juridike gjermane. Përndryshe ky mendim nuk përkrahet, sepse përmbushja e detyrimit nuk është punë e dyanshme juridike si dhe fakti se pranimi i përmbushjes nuk mund të krahasohet me kontratën. Kjo aq më tepër kur dihet se përmbushja e detyrimit mund të bëhet edhe pa pranimin e kreditorit, pa bashkëpunimin e tij, si dhe kundër vullnetit të tij. Në këto raste kryesore është kreditori të marrë atë çka kërkuar. Ndërkaq, sipas mendimit të dytë përmbushja e detyrimit është një akt real që përfshinë dëshirën e debitorit që ta përmbush detyrimin animus solvendi. Pra, te përmbushja parimisht vlen deri te pajtimi i vullnetit të debitorit (solvensit), dhe të kreditorit (accipiensit). Por, duhet thënë se këto elemente nuk janë esenciale për përmbushjen e detyrimit, sepse te përmbushja kryesore është që detyrimi të realizohet dhe kështu debitori të lirohet nga obligimi që ka ndaj kreditorit.¹²⁰

4.1.3.Subjektet e pagesës.

Në pagesën e borxhit marrin pjesë dy persona:

- Ai person që e paguan borxhin dhe,
- Ai person kujt i bëhet pagesa.

-Ai person që e paguan borxhin: pagesën, sipas rregullës, e kryen borxhliu personalisht, ose nëpërmjet përfaqësuesit të vet. Ai është i autorizuar të ekzekutojë pagesën dhe që ta shtyjë kreditorin që të marrë pagesën. Nëse kreditori do ta refuzonte marrjen, do të ndodhë vonesa e kreditori. Që pagesën ta bënte në mënyrë plotëfuqishme debitori duhet që të posedoj aftësinë e plotë punuese. Nëse pagesën do ta ekzekutonte debitori me aftësi të kufizuar punuese, ose debitori plotësisht i pa aftë për punë, kujdestari i tij mund të kërkojë kthimin e pagesës. Por, ka dhe situatë kur kujdestari i tij nuk mund të kërkojë kthimin e pagesës edhe kur pagesa e ekzekutuar do të jetë e vlefshme, edhe pse atë e ka ekzekutuar personi pa aftësi punuese. Ajo do të jetë, nëse do të plotësohen këto kushte:

- Nëse borxhi është i padyshimt (i vërtetë) dhe
- Nëse ka arritur për pagesë.

Për borxhin e aritur dhe të padyshimtë pagesën e vlefshme mund ta bëjë edhe debitori pa aftësi punuese, sepse kjo do të jetë në interes të tij. Shtyerja e pagesës mund të sjellë krijimin e detyrave të reja pagesën e kamatës, shpenzimet kontraktuale. Ka raste, kur pagesën mund ta bëjë vetëm borxhliu, e askush tjetër në vend të tij.

Kështu ndodh nëse detyra do të krijohej duke marrë parasyshë personalitetin e debitorit, ose kur është fjala për detyrën e mosbërjes (mosveprimit), pësimi (edhe këto detyra do të jenë të lidhura për personalitetin e borxhliut, për shkak të vërtetës, sepse është vështirë të mirret me mend se dikush tjetër do të bëjë diçka, ose që të pësojë në vend të debitorit, ashtu sikur kur është në pyetje edhe vetë debitori). Përveç këtyre rastëve, pagesën mund ta bëjnë edhe ndonjë person tjetër në vend të debitorit. Aty gjithsesi së pari vijnë ata persona, të cilët do të kenë interes juridik që

¹²⁰ Prof, Dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 670.

borxhi shuhet. E këta do të jenë: dorzani, pronari i sendit të luajjtshëm ose të paluajjtshëm të dhënë në peng, respektivisht në formë të hipotekës dhe kundërshtari i përzierjes në Padin Pauliane.¹²¹

Përmbushjen mund ta bëjë edhe personi i tretë që nuk ka ndonjë interes të caktuar. Kështu ndodh kur ai për njërën ose për arsyen tjetër është i obliguar, që të përmbush detyrimin e vet. Për këtë arsye LMD në nenet 285, aline 1,2, ku parashikon dispozita :aline 1, detyrimi mund të plotësohet jo vetëm nga debitori , por edhe nga personi i tretë .Aline 2: po i njejtë nen: kreditori është i detyruar të marrë përmbushjen nga secili person i cili ka interes ligjor, detyrimi të jetë përmbushur edhe atë kur debitori e kundërshton atë përmbushje.

Pra kjo dispozitë sanksionon se kreditori është obliguar që të pranojë përmbushjen nga personi i tretë, me kusht se kreditori është i obliguar që të pranojë përmbushjen nga personi i tretë, me kusht që debitori të jetë dakord, përveç rastëve kur sipas kontratës ose natyrës së detyrës të detyrimit duhet ta përmbush personalisht vet debitori.

Pastaj kreditori mund ta pranojë përmbushjen nga personi i tretë edhe pa dijen e debitorit, si edhe në rastin kur debitori ka lajmëruar lidhur me këtë se nuk pranon që I treti ta përmbush detyrën e debitorit. Por, duhet thënë se nëse debitori ofron që vetë ta përmbush menjëher detyrën e vet, atëherë kreditori nuk mund ta pranojë përmbushjen nga personi i tretë, (LMD I RM-së, neni 285, aline 3): kreditori është i detyruar të marrë përmbushjen nga një person i tretë ,nëse debitori pajtohet me këtë, përveç kur sipas kontratës ose natyrës së vet detyrimit , nuk duhet ta përmbush debitori personalisht. Përndryshe është rregull e përgjithshme se kreditori është i obliguar ta marrë përmbushjen nga çdo person i cili ka ndonjë interes juridik që detyra të përmbushet, edhe atë në rastin kur debitori kundërshton këtë përmbushje.¹²²

Kreditori mund ta pranojë përmbushjen nga një person i tretë, pa dijen e debitorit edhe në rastet kur debitori e informon se nuk pajtohet për ta përmbush detyrimin e tij nga personi i tretë. (LMD-së ,neni 285, aline 4).

Në rast pagimit të borxhit nga ana e personit të tretë detyra ndaj kreditorit është shuar definitivisht, por kjo nuk don të thotë se debitori do të lirohet nga çdo detyrë (personi i tretë nuk e ka kryer, pagesën në vend të borxhliut me qëllim mirëbërës, që në atë mënyrë ti japë dhuratë). Personi i tretë e zë vendin e kreditorit të paguar, dhe debitori tani ka borxh pagesën e atij personi të tretë. Nëse personi i tretë do të kryente pagesën dhe atë e ka zënë vendin e kreditorit të paguar, do të kemi rastin e pagimit me subrogim (ndërim).¹²³

4.1.4. Personit të cilit duhet ti bëhet pagesa.

Përmbushja duhet të kryhet nga kreditori ose personi i autorizuar sipas ligjit, me vendim të gjykatës , me marrëveshje ndërmjet kreditorit dhe debitorit, ose nga ana e vetë kreditorit. Përmbushja është e vlefshme edhe atëher kur është përmbushur nga personi i tretë ,nëse kreditori ne vecanti e ka miratuar atë ose e ka shfrytëzuar atë, (LMD i RM-së ,neni 294, al 1,2). Pagesa sipas rregullës, i kryhet kreditorit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar. Për të marrë pagesën e plotfuqishme, kreditori duhet që të posedoj aftësinë e plotë punuese.

Nëse debitori ia ka ekzekutuar pagesën kreditorit, i cili nuk e ka aftësinë e plotë punuese, do ti nënshtrohet rrezikut që të jetë i detyruar tja paguaj edhe një herë pagesën me kërkesën e përfaqësuesit të kujdestarit të kreditorit, nëse do të ndodhte që kreditori është

¹²¹ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 239.

¹²² Prof. Dr. Alajdin S Alishani , E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 670-671.

¹²³ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 239.

krejtësisht i paaftë për punë dhe e ka shpenzuar sendin e marrë. Pagesa e kreditorit të paaftë për punë do të jetë e vlefshme vetëm në atë rast, nëse lënda e pagesës do të ndodhte në pasurinë e tij, ose do ishte e dobishme për të. Gjithashtu, debitori nuk mund që tja ekzekutojë pagesën e vlefshme kreditorit mbi pasurinë e të cilit është hapur falimentimi. Falimentimi ka për pasojë që ti mirret udhëheqja e pasurisë atij personi dhe ai nuk mund as që të marrë e as që të paguajë. Pra, kreditori i vërtetë në këtë rast nuk mund që ta marrë pagesën:

- nëse debitori dhe kreditori meren vesht ashtu , psh: banka nga e cila ka marrë hua kreditori,
- nëse është caktuar sipas ligjit, psh: poseduesit e paligjshëm të letrës me vlerë,
- nëse është caktuar me vendim gjyqësorë,
- nëse është caktuar nga vetë kreditori, psh me asignacion,
- nëse personi i tretë është cedent kurse debitori nuk është i njoftuar për cedimin,
- nëse kreditori më vonë e paraqet pagimin për personin e tretë .¹²⁴

4.1.5. Deponimi i borxhit.

Debitori ka mundsëi që në mënyr të plotëfuqishme ta bëjë pagesën në gjykatë dhe të konsiderohet sikurse tia kishte bërë vetë kreditori. Ky është rasti i deponimit të borxhit. Për tu bërë deponimi i borxhit duhet të plotësohen këto kushte:

- kreditori duhet të jetë në vonesë me marrjen e borxhit,
- kur nuk dihet se ku është kreditori,
- kur kreditori është i panjohur,-kur kreditori është me paaftësi për të vepruar dhe nuk e ka përfaqësuesin e vet,
- kur është sendi i luajtshëm, i cili mund të ruhet lehtë (paratë, letrat me vlerë, sendet e çmueshme), dhe
- për deponimin e bërë debitori duhet ta njoftojë kreditorin në qoftë se di për të se vendbanimin e tij.

Deponimi bëhet në gjykatën e kompetencës lëndore në vendin e pagesës, përveç nëse arsyet e ekonomizimit ose natyrës së punës kërkojnë që deponimi të bëhet në vendin ku gjendet sendi. Përveç deponimit të rregullt në gjykatë, ekziston edhe deponimi duke ia dhënë sendin subjektit tjetër, e ky quhet : deponim me ndërmjetësim-sekuestrim. Këtu hynë rastet e deponimit të sendit të huaj në ruajtje, psh: drithërat, materiali ndërtimor. Ruajtësin-sekuestrimin duhet ta caktoj gjykata me kërkesë të debitorit, i cili ruatjen e bën në llogari dhe me shpenzime të debitorit. Parimisht , shpenzimet e deponimit të sendit të borxhit i bart debitori. Shpenzimet e deponimit në gjykatë i heq kreditori në qoftë se këto i kalojnë shpenzimet e përmbushjes së rregullt të detyrimit të debitorit. Debitori ka të drejtë ta revokojë deponimin , derisa kreditori nuk deklaron se e pranon sendin e deponuar si pagim borxhi , përkatësisht deri sa të merret vendimi gjyqësor me të cilin vendoset se kujt do ti takojë aj send.¹²⁵

4.1.6. Lënda e përmbushjes

Lënda e përmbushjes është ajo që debitori i ka borxh kreditorit. Lënda e përmbushjes inicon çështje të ndryshme rreth saj siç janë :

¹²⁴ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 240.

¹²⁵ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 267-268.

- përmbatja e detyrës ,(LMD i RM-së, neni, 296),
- zëvendësimi i përmbushjes, (LMD i RM-së neni, 297),
- dorëzimi për shitje (LMD i RM-së neni, 298),
- përmbushja e pjesëshme (LMD i RM-së neni, 299),
- detyra e dhënies së sendit të caktuar sipas llojit (LMD i RM-së neni, 300).

Këto çështje shtrojnë çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me përmbushjen e detyrimëve. Këto çështje të të përmbushjes së detyrimëve kanë vlerë të caktuar tertike dhe praktike, andaj edhe do të mundohemi ti realizojmë veç e veç. Kur diskutohet për përmbatjen e detyrës, atëherë duhet thënë se përmbushja në këtë rast përbëhet nga ekzekutimi i asaj që është përmbatja e detyrës dhe, parimisht, këtë teori nuk mund ta përmbushë me diç tjetër, as që kreditori mund të kërkojë diç tjetër, (neni 296). Pra, debitori duhet ta përmbush atë që ka borxh, sepse ai është përmbatja e detyrës së tij, kurse kreditori duhet të kërkojë ekzekutimin e lëndës së përmbushjes e jo diç tjetër. Për këtë arsye edhe thuhet se nuk ka përmbushje të plotëfuqishme në qoftë se atë që e ka dorëzuar debitori si sendin e borxhit dhe atë si të tillë e ka marrë edhe kreditori, kurse në esencë nuk është lënda e përmbushjes, atëherë edhe kreditori ka të drejtë ta kthejë atë send prapa dhe të kërkojë dorëzimin e sendit të borxhit, (neni 297).

Siç mundë të vërehet, për përmbushje të plotëfuqishme është e nevojshme që debitori të përmbush sendin e borxhit, ndërsa kreditori është i autorizuar gjithashtu të kërkojë lëndën e përmbushjes, sepse ajo është përmbatja e detyrës së debitorit. Nëse ndodh që debitori ti dorëzojë kreditorit ndonjë send ose ndonjë të drejtë tjetër që ai ta shesë dhe nga çmimi i realizuar të inkasoj kërkesën e vet, kurse pjesën e ngelur të çmimit tia dotëzojë debitorit. Kurse vet detyra shuhet në momentin kur kreditori e inkason kërkesën e vet nga shuma e realizuar te kjo shitje, (neni, 298). Siç mund të vërtetohet përmbushja e detyrës së debitorit ndonjëherë mund të bëhet edhe duke shitur sendin e debitorit dhe nga çmimi i realizuar hiqet kërkesa e kreditorit dhe shpenzimet eventuale rreth shitjes, kurse pjesa tjetër e këtij çmimi i kthehet debitorit.¹²⁶

Kreditori, sipas rregullave të përmbushjes duhet të realizoj kërkesën në tërësi. Ky realizim bëhet nëse debitori e përmbush detyrën e vet si është përmbatja e saj. Andaj, ekziston edhe rregulla se kreditori nuk është i detyruar që ta pranojë përmbushjen e pjesshme të detyrimit, përveç nëse nuk e kërkon apo nuk e imponon ndryshe natyra e detyrës, (neni, 299). Pra, këtij rregulli thotë se kreditori ekzekutimin e pjesshëm mund ta refuzojë, por do ta pranojë këtë ekzekutim nëse natyra e marrëdhënies e lejon këtë. Kreditori është i autorizuar të marrë pagesën e plotë.

Kreditori mund të refuzojë marrjen e pagesës së pjesëshme, përveç rastit kur është fjala për detyrim me para, detyrimet suksesive, në rastet kur debitori dhe kreditori merren vesh që detyrimin ta përmbushin, si psh: kontrata mbi shitjen me kredi, në kontratat mbi huanë që huaja të kthehet në pjesën alikuote.¹²⁷

-Zëvendësimi i përmbushjes (datio in solutum): në të drejtën klasike romake lejohej që palët të kontraktojnë të ashtu quajturën facultas alternative. Në rastet të tilla debitori mund të lirohej prej detyrimit, kur kreditori në vend të asaj që me të vërtetë e kishte borxh, i jepte ndonjë send tjetër, që kreditori e merrte me kusht që detyrimi të shuhet. Dhënia e këtillë e ndonjë sendi tjetër, në vend të pagimit të borxhit, quhet datio in solutum voluntaria dhe shërbente si mënyrë e shuarjes së detyrimëve ipso jure. Në të drejtën e Justinianit, përveç datio in solutum voluntaria apo marrëveshjes vullnetare të palëve për shuarjen e obligatës me të dhënë të ndonjë sendi që në të vërtetë nuk kishte objekt borxhi, ekzistonte edhe datoi in solutum necessaria. Datio in solutum necessaria parashikohej në dobi të pronarëve të tokave të ngopur me borxhe. Pronarët e tokave të

¹²⁶ Prof. Dr. Alajdin Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 675-676.

¹²⁷ Dr. Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 268.

ngopur me borxhe kishin të drejtë që në vend të pagimit të të hollave në dorë tu japin kreditorëve parcela toke, të vlerësuara me ndërgjegje zyrtarisht.¹²⁸

-Dhënia për përmbushje: ekzistonë kur debitori ia dorëzonë kreditorit ndonjë send ose i cedon kërkesën me qëllim që kreditori atë send tja shesë e ta marrë kërkesën, kështu nga ajo që ka fituar ta marrë pagesën për veti, e që tepricën eventuale tja kthejë debitorit(psh:debitori ia dorëzon kreditorit stilografin e vet që ky ta shesë dhe që shumën e marrë ta përdorë për plotësimin e kërkesave të veta nga kontrata mbi shitjen.)¹²⁹Për shembull: debitori ia dorëzon kreditorit veturën e vet që ta shes dhe që me shumën e marrë ta realizojë kërkesën e vet, kur pjesën e mbetur të çmimit tia kthejë debitorin.¹³⁰

4.1.7.Koha e përmbushjes

Kur diskutohet për vendin e përmbushjes duhet të kihet parasysh rasti:

- kur afati është caktuar për përmbushje ,
- kur ekziston mundësia e përmbushjes para afatit,
- kur kreditori e kërkon përmbushjen para afatit,
- kur kemi rastin e caktimit të afatit nga debitori ose kreditori dhe
- kur janë rastet e përmbushjes së detyrimëve në të holla.¹³¹

-Detyrimi i krijuar ndërmjet kreditori dhe debitorit duhet të ekzekutohet në afat të caktuar. Afat i pagesës është intervali kohor brenda të cilës duhet të përmbushet detyrimi.

Afatin e pagesës e caktojnë debitori dhe kreditori me marrëveshjen e tyre.

Ky afat quhet i kontraktuar, në të cilën debitori dhe kreditori duhet ti përmbahen patjetër afatit të caktuar që do të thotë se debitori nuk do të jetë i detyruar të bëjë pagesën para afatit kontraktues, kurse kreditori as që mundet ta kryejë pagesën para afatit.Koha e pagesës mund të jetë e caktuar: në mënyrë absolute- dies certus quando dhe relative.Në mënyrë absolute është e caktuar kur është e fiksuar kalendarisht, psh: 31 tetor 1998, ose në fund të nëntorit, kurse relativisht nëse lidhet me ndonjë ngjarje të caktuar ,psh :tre muaj pas martesës së kreditorit.¹³²

-Kur egziston mundësia e përmbushjes para afatit: në rastet kurë afati kohor është rënë dakord ekskluzivisht në interes të debitorit , ai ka të drejt të bëjë përmbushjen para afatit të kontraktuar ,por është i detyruar ta informoj kreditorin për qëllimin e tij .Në raste tjera kur debitori do te ofroj përmbushje para afatit ,kreditori mund të refuzoj përmbushjen , dhe gjithë ashtu mund të mbaj të drejtën e kompensimit të dëmit, nëse ai duhet ta njoftoj debitorin pa vones,(LMD-së i RM-së ,neni, 304,alinea ,1,2).Nëse debitori dhe kreditori nuk e kanë caktuar kohën e pagesës, atëherë atë ndonjëherë e bën ligji(detyra e ushqimit mbatjes paguhet suksesivisht në fillim të çdo muaji), ndërsa ndonjëherë caktohet sipas natyrës së bëmjes(blerja e drithit që korret në vitin 1969, drithi ka për tu dorëzuar pas kryerjes së korrjes).

-Kreditori ka të drejt të kërkoj përmbushjen para afatit, nëse debitori nuk e ka dhënë sigurin e premtuar ,ose sipas kërkesës së tij nuk ka plotësuar sigurin e reduktuar pa fajn etij , si dhe kur afati kohorë është rënë dakord ekskluzivisht në interes të tij. (LMD-së i RM-së ,neni, 305).Nëse koha e pagesës nuk mund të caktohet as edhe në këtë mënyrë, detyrimi arrin për

¹²⁸ Dr. Ivo Puhan, E Drejta Romake, Prishtinë,1989, fq. 397.

¹²⁹ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 242.

¹³⁰ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 269.

¹³¹ Prof.Dr. E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 683.

¹³² Dr.Sc. E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 269.

pagesë, pasi të sajohet. Kjo do të thotë praktikisht se kreditori mund të kërkojë pagesën menjëher, e gjithashtu edhe debitori mund që ta kryejë pagesën menjëher. Debitori do të jetë i detyruar që ta kryejë pagesën, kur kreditori ia tërheq vëretjen, ashtu si që është i detyruar kreditori ta marrë pagesën, kur debitori ia ofron përmbushjen. Në të kundërtën do të shkaktohet vonesa me të gjitha pasojat e dëmshme, si për debitorin, ashtu edhe për kreditorin.¹³³

-Caktimi i afatit nga debitori ose kreditori :gjatë përcaktimit të kohës për përmbushje i lihet vullnetit të kreditorit ose debitorit, ose personi tjetër, nëse personi i autorizuar nuk e ka përcaktuar afatin, urdhëron të kërkojë nga gjykata të përcaktoj një kohë të arsyeshme për të përmbushur. (LMD-së i RM-së, neni, 306).

-Nëse pagesa bëhet me ndërmjetësimin e një bankë ose shtëpi kursimi kur ajo është duke u kryer llogaria e kreditorit do të llogaritet nëse palët kontraktuese nuk e kanë caktuar ndryshe që borxhi të zgjidhet kur banka, dmth shtëpia e kursimit ku mbahet llogaria do të arihet detyrimi në para në favor të debitorit ose kreditorit ose shtëpisë së kursimit për të miratuar shumën e treguar në llogarin e kreditorit me urdhër. Nëse kontrata e përcakton pagesën me post, supozohet se palët u pajtuan që duke paguar shumën që i detyrohen debitorit me post, ka shlyer detyrimin ndaj kreditorit nëse një metodë e tillë e pagesës nuk është dakord, borxhi zgjidhet kur kreditori merr detyrimin monetar. Nëse një rregullorë ose një kontratë parashikon një pagesë me një fletëkontroll në llogari të caktuar, supozohet se palët janë pajtuar se pagesa është kryer kur debitori do të paguaj shumën që i detyrohet një kontroll përfitojnë në llogarin e shënuar. (LMD-së i RM-së, neni, 306, alinea 1, 2, 3).

4.1.8. Vendi i pagesës

Te përmbushja e detyrimëve me rëndësi është edhe vendi i përmbushjes së tyre. Për këto çështje ekzistojnë dispozita në të drejtën nacionale, (LMD i RM-së, neni 308, 309). Nga kjo rregullativë rrjedh se ekzistojnë rregulla të përgjithshme për vendin e përmbushjes së detyrimëve dhe rregulla shpëcifikë për vendin e përmbushjes së detyrimëve në të holla. Këto janë çështje që shprehin vlerën teorike dhe praktike të këtyre rregullave si dhe specifikat e tyre në raste dhe situata të ndryshme.¹³⁴ Debitori është i detyruar që detyrimi duhet të përmbushet në vendin ku është caktuar: sipas marrëveshjes së debitorit dhe kreditorit, ose sipas ligjit.

Kur vendi i përmbushjes nuk është i përcaktuar dhe nuk mund të përcaktohet sipas qëllimit të punës, natyrën e detyrimit ose rrethanave tjera përmbushja e detyrimit kryhet në vendin kur debitori në kohën e ndodhjes së obligimit kishte selinë, vendbanimin, (LMD i RM-së, neni 308, alinea 1, 2).

Nëse debitori është person juridik që ka shumë njësi në vende të ndryshme si vend i përmbushjes do të konsiderohet secila e njësisë për të kryer veprimet e domosdoshme për përmbushjen e detyrimit nëse kreditor atë rrethanë para nënshkrimit të kontratës për atë ka qenë i njohur apo patjetër duhet të jetë e njohur, (po i njëjti nenë, alinea 3).

Kur vendi i përmbushjes nuk është caktuar me punë juridike e as me ligj, ai caktohet në bazë të qëllimit të detyrimit, natyrës së detyrës dhe në bazë të rrethanave të tjera. Sipas natyrës së detyrimit, vendi i përmbushjes caktohet në këtë mënyrë:

-nëse sendi është i paluajtshëm,

-nëse vendi i përmbushjes është vendi ku ndodhet sendi i tillë-locus rei site.

¹³³ Dr. Lubisha Millosheviq, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, fq. 243.

¹³⁴ Prof. Dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2002, fq. 687.

Kur sendi është i luajtshëm, vendi i pagesës është vendi ku është lidhur kontrata. Detyrimet me para përmbushen në vendin në të cilin kreditori e ka vendbanimin, e në mungesë të vendbanimit, në vendqëndrimin e tij (LMD i RM-së, neni 309, alinea, 1). Nëse pagimi bëhet me virman, detyrimet me para bëhen në selin e organizatës tek e cila janë mjetet në para të kreditorit (LMD i RM-së, neni 309, alinea, 2). Por, nëse kreditori ndryshon vendin ku ai kishte selin e tij për vendbanimin në kohën kur u ngrit detyrimi, dhe për këtë arsye u rriten shpenzimet e përmbushjes kjo rritje bie mbi barën e kreditorit. (LMD i RM-së, neni 309, alinea, 3).

4.1.9. Efekti i pagesës

Çështja e efektit të pagesës ndërlikohet kur ndërmjet debitorit dhe kreditorit ka më shumë marrëdhënie detyrimi dhe debitori e kryen pagesën e pjesëshme me të cilën nuk i ka plotësuar të gjitha detyrat e veta. Në këtë rast shtohet çështja e llogaritjes (imputacionit) së pagesës së kryer që bëhet me marrëveshjen e debitorit dhe kreditorit. Nëse nuk ekziston marrëveshja, do të zbatohen keto rregulla:

- Në qoftë se nuk ekziston deklarata e debitorit për llogaritjen e përmbushjes, së pari përmbushen kërkesat e arritura sipas radhës për përmbushje,

- Në qoftë se njëkohësisht arrijnë më shumë detyra, së pari përmbushen detyrimet më pak të siguruara, e kur të gjitha sigurohen njësoj, së pari përmbushen ato që janë barrë më e madhe për debitorin,

- Në qoftë se detyrimet janë të barabarta në të gjitha aspektet, përmbushen sipas radhës që janë krijuar, e nëse njëkohësisht janë krijuar, atëherë ajo që është dhënë në emër të përmbushjes radhitet në të gjitha detyrimet proporcionalisht me shumën e tyre.¹³⁵

4.1.10. Vërtetimi i pagesës

Kur debitori përmbush detyrimin e vet ashtu siç është, atëherë detyrimi shuhet dhe ai lirohet nga obligimi ndaj kreditorit. Mirëpo, te përmbushja e detyrimëve për hir të sigurisë së caktuar, debitori ka të drejtë të kërkojë vërtetimin ose dëftesën nga kreditori se e ka përmbushur detyrimin e vet. Rreth vërtetimit të përmbushjes ekzistojnë rregullativa të caktuara në të drejtën nacionale, (LMD i RM-së, nenet 310, 311). Sipas rregullave të (LMD-së i RM-së neni 310, alinea, 1), ku thuhet: kush e përmbush detyrimin në tërësi ose pjesërisht ka të drejtë të kërkojë që kreditori për këtë të lëshojë vërtetimin me shpenzime të veta. Sipas kësaj dispozite, si për përmbushjen në tërësi, ashtu edhe për përmbushje të pjesshme, debitori mund të kërkojë nga kreditori vërtetimin se e ka përmbushur detyrimin e vet. Këtë obligim kreditori duhet ta bëjë në mënyrë të rregullt. Debitori që përmbushi detyrimin monetar nëpërmjet bankës ose postës, ka të drejtë të kërkojë kreditorit fletë vërtetimi me shpenzimet e veta, nëse metvertet ka ndonjë arsye, (po i njëjti nen, alinea 2). Në qoftë se është dhënë vërtetimi se tërësisht është paguar borxhi kryesor, supozohet se është paguar kamata, shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet të tjera, (po i njëjti nen, alinea 3). Kështu është sepse kur paguhet borxhi kryesor duhet të paguhet edhe borxhet aksesore. LMD i RM-së neni 310, alinea, 4, ku thuhet: në qoftë se debitori i dhënies në kohëpaskohshme, siç janë qiraja dhe kërkesat tjera që llogariten kohëpaskohe, siç janë harxhimet

¹³⁵ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Prishtinë, 2001, fq. 271.

e energjisë elektrike, të ujit ose përdorimi i telefonit, ka vërtetimin se ka paguar kërkesën arritur më vonë, supozohet se ka paguar edhe ato kërkesa që janë arritur për përmbushje më vonë .

4.2.Shuarja me zgjatjen e afatit për përmbushje

Skadimi i kohës është mënyrë vullnetare e shuarje së detyrimëve , kur me anë të kontratës është caktuar koha e zgjedhjes së detyrimit , por mund të përfshihet edhe në mënyrë kundër vullnetit të palëve kur me ligj ose me vendim të gjykatës është caktuar koha e zgjatjes së detyrimëve.Kjo mënyr e shuarje së detyrimëve vlen për detyrimet e përhershme dhe sukcesive. Pra sipas (LMD-së,RM-së, neni 346), në një marrëdhënie të përhershme afatgjatë, me një afat të caktuar ,do të përfundoj vetëm nëse është kontraktuar ose me ligjë është theksuar se edhe pas skadimit të afatit marrëdhënie detyrimore vlen edhe për një periudh të caktuar.

Këto detyrime mund të kenë afat të caktuar të zgjatjes, varësisht nga qëllimi që dëshirohet të arrihet me anë të tyre. Në atë rast se afati i zgjatjes që më parë është caktuar, ato, si rregull shuhet me skadimin e kohës. Koha e zgjatjes së detyrimit mund të caktohet me kontrat , me testament , me vendim gjyqësor dhe ligj. Me kalimin e kohës detyrimi shuhet dhe në të ardhmën nuk ekziston më.Si raste të shuarjes së detyrimëve me skadimin e kohës konsiderohen:

- Kontrata mbi marrëdhënien e nënqiragjinjëve lidhur me afat prej dy vitesh dhe pas skadimit të këtij afati, detyrimi shuhet.

- Lënësi ia le detyrimin trashëgimtarit me legat që ti paguaj ndonjë subjekt 1000 den për cdo muaj deri në moshën madhore të tij.

- Sipas ligjit ekziston detyra e vëllaut të madh që ta mbaj vëllaun e mitur deri në moshën madhore.¹³⁶

Anulimi i një marrëdhënie të përhershme borxhi kemi atëherë kur:

- nëse kohëzgjatja e marrëdhënies së borxhit nuk është e përcaktuar , secila palë mund ta përfundojë atë anulim.

- anulimi duhet ti dorëzohet palës,

- anulimi mund të jepet në cdo kohë, vetëm jo në kohë të papërshtatshme,

- ndërprerja e borxhit pushon kur skadon afati i njoftimit të përcaktuar me marrëveshje dhe nëse një afat i tillë nuk përcaktohet, me marrëveshje ,atëherë marrëdhënia përfundon pas skadimit të afatit të përcaktuar me ligj ose me zakonet,me skadimin e datës së përcaktuar,

- palët mund të bien dakord se marrëdhënia e tyre e borxhit do të pushojë së ekzistuari me dorëzimin e anulimit nëse për një rast të caktuar ligji nuk urdhëron gjë tjetër.

- kreditore ka të drejtë të kërkoj nga debitori atë cka ka poseduar para shuarjes së detyrimit me mbarimin e afatit ose anulimit.(LMD i RM-së, neni 347, alinea,1,2,3,4,5).

4.3.Shuarja me tërheqjen e vëretjes së paraqitur debitorit.

Shuarja e detyrimëve me denoncim është një prej rastëve të shuarjes së detyrimëve që shkaktohet në kundërshtim me vullnetin e debitorit dhe të kreditorit.Ky rast i shuarjes së detyrimëve sanksionohet në të drejtën nacionale.Sipas rregullave në qoftë se koha e zgjatjes së

¹³⁶ Dr.Sc. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimëve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçant, Prishtinë, 2001, fq. 285.

marrëdhënies së borxhit nuk është caktuar, çdo pjesëmarës ka të drejtë ta shuaj me denoncim. Siç mund të vërehet, këtu kemi rastin e marrëdhënies së detyrimëve që janë të paafatizuara, andaj i mundësohet si debitorit, ashtu edhe kreditorit që ta denoncoj këtë marrëdhënie të krijuar.

Denoncimi i marrëdhënies së detyrimit kur ndërmiret nga debitori ose kreditori duhet që ti dërgohet anës tjetër, nga kjo dispozitë rrjedh se kur ndërmiret e drejta në denoncimin e marrëdhënies së detyrimit nga debitori ose kreditori, atëherë pa tjetër ky vendim duhet ti dërgohet anës tjetër. Zakonisht dërgimi i denoncimit bëhet me shkrim, por mund të bëhet edhe gojarisht. Për hir të sigurisë së denoncimit me të vërtetë është bërë, duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të dërgohet në mënyrë të sigurt. Prarimisht, denoncimi mund ti jepet në çdo kohë, por nuk duhet të jepet në kohë të papërshtatshme.

4.3.1.Efektet e denoncimit:

Për të krijuar efekte denoncimi duhet të jipet në kohë të përshtatshme. Koha e përshtatshme është kur ai jipet në rrjedh normale të marrëdhënies së detyrimit dhe i jepet në suaza të rregullave të së drejtës së detyrimëve. Ai nuk duhet të jepet në kohë të papërshtatshme, sepse mund ti shkaktoj dëm palës tjetër. Kështu ndodh kur denoncimi nga lokali afarist ose nga banesa bëhet kur ekziston acari i madh, kur janë vërshimet. Marrëdhënia e denoncuar e borxhit shuhet kur skadon afati i denoncimit të caktuar sipas kontratës, kurse nëse ky afat nuk është caktuar sipas kontratës, atëherë marrëdhënia e borxhit shuhet pas skadimit të afatit të caktuar sipas ligjit. Për realizimin e denoncimit të një marrëdhënie të detyrimit duhet të caktohet afati i denoncimit. Ky afat zakonisht është 30 ditë. Por, këtë afat mund të caktohet në bazë të kontratës, mund të caktohet edhe me dispozita ligjore. Afati i denoncimit i jepet që pala tjetër të përgaditet për shuarjen e kësaj marrëdhënie të detyrimit.¹³⁷

¹³⁷ Prof.Dr. Alajdin.S.Alishani, E Drejta e Detyrimëve, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2002, fq. 711.

KREU IV

IV. EFEKTET JURIDIKE TË SHKAKTUARA NGA VONESA E DEBITORIT NË BAZË TË VENDIMËVE TË ANALIZUARA NË TERRITORIN E GJYKATES THEMELORE TË GOSTIVARIT

Në gjykatën themelore në Gostivar janë shqyrtuar shumë vendime në lidhje me vonesën e debitorit. Nga analiza e vendimëve në këtë punim janë prezentuar efektet juridike duke bërë klasifikimin e vendimëve të shqyrtuara në vite edhe atë duke filluar nga viti 2015, 2016 dhe 2017. Gjatë analizës së vendimeve kamë bërë klasifikimin e vendimeve ku kreditori ka paralajmëruar apo nuk ka debitorin për vonesë, vendime gjyqësore nga të cilat është konstatu se cilat janë të drejtat e kreditorit nga vonesa e debitorit si dhe vendime gjyqësore nga të cilat kam konstatu se cilet janë pjesëmarrës në marrdheniet juridiko obligative.

1.VENDIMET GJYQËSORE KU KREDITORI KA PARALAJMERU DHE NUK KA PARALAJMERU DEBITORIN

Nga analiza e vendimëve gjyqësore, gjithashtu kamë bërë klasifikimin vendimëve varesisht nga ajo se kreditori ka paralajmëru apo nuk ka paralajmëru debitorin në lidhje me vonesënetij për ta realizuar kërkesen e kreditorit.

Gjatë kësaj analize të vendimëve gjyqësore, numri total i vendimeve gjyqësore të shqyrtuara, që dalin nga vonesa e debitorit, duke filluar nga viti 2015-2017 është kjo përlllogaritje: Viti 2015, gjithësej numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuar: 211. Viti 2016, gjithësej numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuar: 226. Viti 2017, gjithësej numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara: 237.

Gjatë analizës së vendimëve të shqyrtuara gjyqësore, ku kreditori ka paralajmëruar debitorin për rënien në vonesë nga viti 2015-2017, janë gjithësej: 389.

Numri i vendimëve të shqyrtuara gjyqësore ku kreditori nuk ka paralajmëruar debitorin, nga viti 2015-2017, janë gjithësej: 317.

ANALIZË E VENDIMËVE GJYQËSORE					
VITET E ANALIZES TE VENDIMEVE GJYQESORE.	2015	2016	2017	2018	GHITHËSEJ
1.Nr. i vendimeve te pergjithshme	211	226	237	32	706
2.Nr i vendimeve ku kreditori ka paralajmeru debitorin	127	124	125	13	389
3.Analiz të vendimëve gjyqësore ku kreditori nuk ka paralajmëruar debitorin	84	102	112	19	317

2.TË DREJTAT E KREDITORIT NGA VONESA E DEBITORIT

Nga analiza e vendimëve gjyqësore gjithashtu kam bërë klasifikimin vendimëve varesisht nga ajo se çfare ëe drejtash kanë kreditorët në raport me debitorin.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara që dalin nga vonesa e debitorin në rastët ku debitori ka bërë pages të borxhit në tërësi, se bashku me kamaten ligjore dhe shpenzimet e procedurës , nga 2015-2017 janë shqyrtuar : 51 vendime.

-Numri i vendimeve gjyqësore të shqyrtuara në te cilat ka bërë pages të borxhit ne tërësi , shpenzimet e procedurës secila pal vet, gjate vitëve 2015-2017 ka: 32 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara në të cilat raste ka bërë pages të borxhit, shpenzimet e procedurës i padituri, pa kamat ligjore, nga 2015-2017, gjithësej janë: 22 vendime .

-Numri i vendimëve të gjyqësore të shqyrtuara në të cilat kemi pages në këste ,plus shpenzimet e procedurës, plus kamata ligjore, nga viti 2015-2017, janë gjithësej: 7 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara në të cilat paditesi ka bërë pages në këste plus shpenzimet e procedurës pa kamat ligjore, gjatë vitëve 2015-2017, janë gjithësej 33: vendime.

-Numri i vendimeve gjyqësore të shqyrtuara në të cilat ka pagës në këste sipas dakordimit të palëve, gjate vitëve 2015-2017, janë gjithesej 7: vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara nga vonesa e debitorit ku ka pasë borxh të paguar, shpenzimet e procedurës secila pal vet,gjatë viteve 2015-2017, janë shqyrtuar gjithesej: 27 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara ku debitori ka pas borxh të paguar, shpenzimet e procedurës i padituri,gjatë vitëve 2015-2017, gjithesej janë shqyrtuar: 2 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara nga vonesa e debitorit ku ka pas borxh të paguar shpenzimet e procedurës paditësi, nga viti 2015-2017, janë shqyrtuar gjithesej: 11 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara nga vonesa e debitorit ku ka pasur tërheqje të padis përshkak të kopetencës së gjykatës,gjatë viteve 2015-2017, jane shqyrtuar gjithsej: 8 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore te shqyrtuara nga vonesa e debitorit ku ka pasur tërheqje të padisë përshkakë të mos ekzistimit të firmës në regjistrin tregtar, gjate viteve 2015-2017 janë gjithesej: 3 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara nga vonesa e debitorit ku ka pasur tërheqje të padisë përshkak të mos rezencës së debitorit në procedur, shpenzimet e procedurës i padituri, gjatë vitëve 2015-2017, ka pasur gjithsej 13 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara nga vonesa e debitorit ku ka pasur Tërheqje të padisë përshkak të mos presencës së kreditorit në procedur, shpenzimet e procedurës paditësi nga viti 2015-2017, janë shqyrtuar gjithësej: 35 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara nga vonesa e debitorit ku ka pasur tërheqje të padis përshkat të mungesës së informacionit bazë, nga vitet 2015-2017, janë shqyrtuar: 4 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara nga vonesa e debitorit ku ka pasur tërheqje të padisë pasi që ka pas munges të kompletimit të dokumentacionit, nga viti 2015-2017, janë shqyrtuar gjithsej: 14 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara nga vonesa e debitorit ku ka pasur tërheqje të padisë pasi që nuk ka bërë pages të tatimit për padin, nga viti 2015-2017 jane shqyrtuar: 2 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara nga vonesa e debitorit ku ka pasur tërheqje të padisë përshkak mungesës së faktëve, shpenzimet e procedurës paditësi, nga viti 2015-2017, janë shqyrtuar gjithsej: 3 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara nga vonesa e debitorit ku ka pasur tërheqje të padisë pasi që asnjëra pal nuk mori pjesë në seancë, nga viti 2015-2017, janë shqyrtuar gjithsej: 5 vendime.

-Numri i vendimeve gjyqësore të shqyrtuara nga vonesa e debitorit ku ka pasur tërheqje të padisë përshkak borxhit të paguar, vetëm shpenzimet e procedurës dhe kamata ligjore, nga viti 2015-2017, janë shqyrtuar gjithsej: 7 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara nga vonesa e debitorit ku ka pasur tërheqje të padisë pasi që njëra pal ka ndëruar jetë, gjatë viteve 2015-2017, janë shqyrtuar gjithsej: 3 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara nga vonesa e debitorit ku ka pasur tërheqje të padisë pasi që kanë bërë ndërprerje të procedurës dhe të njëjtën nuk e kanë vazhduar për 1 vit, gjatë vitit 2015-2017, janë shqyrtuar gjithsej: 5 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara nga vonesa e debitorit ku ka pasur tërheqje të padisë pasi që i padituri e fitoi rastin, shpenzimet e procedurës paditësi, gjatë vitit 2015-2017, janë shqyrtuar gjithsej: 16 vendime.

-Numri i vendimëve gjyqësore të shqyrtuara nga vonesa e debitorit ku ka pasur tërheqje të padisë përshkak të përsëritjes së procedurës, gjatë viteve 2015-2017, janë shqyrtuar gjithsej: 2 vendime.

TE DREJTAT E KREDITORIT NE BAZE TE VENDIMEVE GHYQESORE					GJITHËEJ
1.Ka bërë pages të borxhit në tërësi ,plus kamata ligjore, plus shpenzimet e procedurës.	15	26	8	2	51
2.Ka bërë pages të borxhit në tërësi, shpenzimet e procedurës secila pal vet.	1	11	20	/	32
3.Ka bërë pages të borxhit, shpenzimet e procedurës i padituri pa kamata ligjore.	8	7	7	/	22
4.Pages me këste ,plus shpenzimet e procedurës, plus kamata ligjore .	2	4	1	/	7
5.Pages me këste plus shpenzimet e procedurës pa kamata ligjore.	17	9	6	1	33
6.Pages me këste sipas dakordimit të palëve.	1	/	6		7
7.Borxh i paguar, shpenzimet e procedurës secila pal vet.	9	10	6	2	27

8.Borxh i paguar , shpenzimet e procedurës i padituri.	1	/	1	/	2
9.Borxh i paguar shpenzimet e procedurës paditësi.	7	3	1	/	11
10.Tërheqje të padisë përshkak të kopetencës së gjykatës.	1	5	2	/	8
11.Tërheqje të padisë përshkakë të mos ekzistimit të firmës në regjistrin tregtar.	1	2	/	/	3
12.Tërheqje të padisë përshkak të mos prezencës së debitorit në procedurë, shpenzimet e procedurës i padituri.	2	4	7	/	13
13.Tërheqje të padisë përshkak të mos presencës së kreditorit në procedurë, shpenzimet e procedurës paditësi.	9	10	11	5	35
14.Tërheqje të padisë përshkat të mungesës së informacionit bazë.	1	2	1	/	4
15.Tërheqje të padisë pasi që ka pas mungës të kompletimit të dokumentacionit.	1	/	5	8	14
16.Tërheqje të padisë pasi që nuk ka bërë pages të tatimit për padinë.	2	/	/	/	2
17.Tërheqje të padisë përshkak mungesës së fakteve, shpenzimet e procedurës paditësi.	2	1	/	/	3
18.Tërheqje të padisë pasi që asnjëra palë nuk mori pjesë në seancë.	1	2	2	/	5
19.Tërheqje të padisë përshkak borxhit të paguar, vetëm shpenzimet e procedurës dhe kamata ligjore.	2	1	4	/	7
20.Tërheqje të padisë pasi që njëra palë ka ndërruar jetë.	1	1	1	/	3
21.Tërheqje të padisë pasi që kanë bërë ndërprerjen e procedurës dhe të njëjtë nuk e kanë vazhduar për 1 vit.	/	3	2	/	3
22.Tërheqje të padisë pasi që i padituri e fitoi rastin, shpenzimet e procedurës paditësi.	/	1	15	/	16

23.Tëreqje të padisë pëshkak të përsëritjes së procedurës.	/	/	2	/	2
--	---	---	---	---	---

3.PERSONAT PJESEMARES NE MARRDHENIET JURIDIKO OBLIGATIVE

Nga analiza e vendimeve gjyqesore gjithashtu kam bërë klasifikimin dhe përcaktimin e personave pjesëmarrës në marrëdhëniet juridiko obligative, edhe atë sa është numri i personave juridik dhe sa është numri i personave fizik si padites apo te paditur.

Në këtë drejtim numri i vendimeve gjyqësor të shqyptuara që shkaktohen nga vonesa e debitorit në periudhën 2015-2017 si pjesëmarrës në rolin e paditesit dhe te paditurit kanë qenë personat juridik është: 279.

Numri i vendimeve gjyqësore të shqyptuara që shkaktohen nga vonesa e debitorit në periudhën 2015-2017 si pjesëmarrës në rolin e paditesit është personi juridik kurse të paditurit kanë qenë personi fizik është: 255.

Numri i vendimeve gjyqësore të shqyptuara që shkaktohen nga vonesa e debitorit në periudhën 2015-2017 si pjesëmarrës në rolin e paditesit është personi fizik kurse te paditurit kanë qenë personi fizik është 37.

Numri i vendimeve gjyqësore të shqyptuara që shkaktohen nga vonesa e debitorit në periudhën 2015-2017 si pjesëmarrës në rolin e paditesit është personi fizik kurse të paditurit kanë qenë personi juridik është: 7 .

PERSONAT PJESMARES NE VENDIMET GJYQESORE

VITET E ANALIZES	2015	2016	2017	2018	GJITHËSEJ
1.Paditës person juridik i padituri person juridik.	133	125	124	21	403
2.Paditës person juridik i padituri person fizik.	59	80	105	11	255
3.Paditës person fizik i padituri person fizik.	15	15	7	/	37
4.Paditës person fizik i padituri person juridik.	4	6	1	/	11

PËRFUNDIMI

Marrdheniet juridiko obligative qe shkaktohen nga vonesa e debitorit gëzojnë mbrojtje juridike ne gjithë teritorin e RM-së, po ashtu edhe në gjykatën themelore te Gostivarit. Marrëdhëniet e detyrimëve mund të krijohet në raste të caktuara dhe situata të ndryshme. Ata janë te shumllojshme.

Që të realizohet kalimi i pasurosë prej një subjekti në subjektin tjetër pjesëmarësit krijojnë marrëdhënie të ndryshme të detyrimëve. Marrëdhëniet që krijohen midis tyre duhet të jenë të plotëfuqishme. Kjo do të thotë se: Detyrimet janë marrëdhënie me karakter juridik, Detyrimet janë marrëdhënie me permbajtje të caktuar, Detyrimet janë marrëdhënie me karakter pasuror, Detyrimet janë marrëdhënie me karakter relativ, Detyrimet janë marrëdhënie midis subjekteve të caktuara. Pra marrëdhëniet e detyrimëve krijohen ,përmbushen dhe shuhen vetëm ndërmjet personave , nuk barten ne persona të tjerë.

Shtetet e kanë për detyrë që me anë të legjislacionit të mbrendshëm të garantojnë mbrojtjen e drejtave dhe detyrimëve që dalin nga marrëdhënie detyrimore. Duke marrë parasish rregullat e para lidhur me marrëdhënie detyrimore nga e drejta romake si një trashëgimi më i rëndësishëm dhe më i përsosur juridik i Romës dhe përpunim i saktë i të gjitha marrëdhënieve esenciale midis pronarëve të zakonshëm te mallit: shitjes dhe blerjes, huapërdorjes, huasë, kontratës dhe detyrimëve tjera.

Për shkak të këtyre cilësive e drejta obligatore romake, edhe pse ne formë diçka të ndryshuar e të plotësuar , është recipuar në Kodin civil frëng dhe në kodet e tjera borgjeze të tipit kontinental. Republika e Maqedonisë posedon legjislacion adekuat që shqyrton marrëdhënie detyrimore te drejtat dhe detyrimet qe dalin nga ato marrëdhënie, efektet juridike te mospermbushjes etj.

Çdo marrëdhënie detyrimore që lind ndërmjet palëve te caktuara krijon efekte juridike. Pra, edhe në rastë të rënies në vones të palëve në marrëdhëniet detyrimore krijohen efekte juridike. Për këtë shkak personat pjesmarës në ato marrëdhënie dehet që në kohë ta përmbushin detyrimin e kontraktuar, që të mos bien në vones dhe te shkaktojnë efekte juridike. Që në momentin kur palët hynë në një marrëdhënie lindin edhe të drejtat dhe detyrimet. Kjo nënkupton që në marrëdhënie juridike ajo e drejtë mund të jetë objekt. Kështu, këto bartje në jetë të përditshme kryhen me punë juridike dhe me veprimin e ligjit. Këto punë juridike kontraktuale lidhen nga dy palë, të cilat kanë shfaqur vullnetin e tyre për një gjë të tillë. Ky vullnet duhet gjithmonë të shprehet me shkrimë, përndryshe kontrata do të jetë e pavlefshme . në këtë kontratë palët përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre si dhe kushtet që secili duhet ti plotësoj. Në mungesë të këtyre ,vlejnë në mënyrë subsidiare dispozitat e ligjit të marrëdhënieve të detyrimëve.

Një çështje që është dominante në RM, përfshirë edhe Gostivarin në veçanti është mos përmbushja e detyrimëve nga ana e personave që kanë hyrë ne ato marrëdhënie ne afatin e caktuar, në mënyre vullnetare, në bazë të dispozitave të kontraktuara. Dhe gjithë kjo ndikon se palet nuk jane te disiplinuar ne realizimin e detyrimeve te tyre. Edhe pse ekziston LMD, ekziston

edhe ligj per disiplin financiare, prap se prap palet nuk permbushin detyrimet e tyre, duke rënë kështu në shume raste edhe ne vonese. Dhe gjithë kjo shkakton detyrime plotesuese. Une mendoj se duhet te punohet në ndergjegjesimin e paleve duke i informuar se vonesat shkaktojne detyrime plotesuese, dhe se në marrveshje midis tyre mund ti rregullojne detyrimet në raste kur ekzistojnë arsye objektive apo subjektive. Çdo veprim tjetër krijon mundesi per realizim të dhunshem, duke narguar me nagrkesa plotësuese, për shkak të zhvillimit të procedurave gjyqësore si dhe përmbarimin me dhunë të kërësave të parealizuara.

REFERENCAT

- A. Aliu, E drejta Civile, Prishtinë. 2007
- A.Aliu, E drejta e detyrimëve, Tetovë, 2009
- A.S.Alishani, E drejta e detyrimeve-Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2002
- A.S.Alishani, Mbi disa çështje themelore të së drejtës detyrimore, Prishtinë, 1973
- A.S.Alishani, Mrrëdhëniet e së drejtës së detyrimëve me degë tjera të së drejtës, Prishtinë, 1973
- A.S.Alishani, Parimet themelore të ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimëve, Prishtinë, 2000
- A.S.Alishani, Praktikumi nga e drejta e detyrimëve, Prishtinë, 1984
- A.S.Alishani, Studime nga e drejta e detyrimëve-1, Prishtinë, 2001
- A.S.Alishani, Studime nga e drejta e detyrimëve-2, Prishtinë, 2006
- A.Jashari, Subjektet e së drejtës Afariste. Tetovë, 2009
- A.Jashari, E drejta afariste kontraktore, Tetovë, 2017
- A.Gams, Hyrje në të drejtën civile, Prishtinë, 1981
- A.Marko, E drejta romake, Tiran, 2001
- A.Borkowski, E drejta romake, Tiran, 2004
- B.Loza, Obligaciono Pravo, Sarajevo, 1981
- M.F.Manjan, Kontrata dhe detyrimi i njëansgëm, Shkup, 2013
- N.Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2001
- N.Dauti, E drejta kontraktuse-Praktikum, Prishtinë, 2003
- N.Dauti, Drejtëejtëshmëria në qarkullimin e mallrave dhe dhënien e shërbimëve,(punim doktore), Prishtinë, 2000
- D. Pop Georgiev, Obligaciono pravo, Shkup, 1985
- I.Puhan, E drejta romake, Prishtinë, 1989
- K.Dhima, Edrejta romake, Tiranë, 2007
- L.Milloshëviq, E drejta e detyrimëve, Prishtinë, 1977

BURIMET TË TJERA

Ligjet:

- 1.Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Maqedonisë
- 2.Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Kosovës
- 3.Ligji për notariat i Republikës së Maqedonisë

Burimet nga interneti:

1. www.drejtesia.gov.al
2. <http://www.pravda.gov.mk/>
3. <https://bks-ks.org/>
4. www.academia.edu
5. www.pravdiko.mk
6. www.vrhoven.sud.mk
7. www.juristi.info
8. <http://www.gjykataelarte.gov.al/>
9. <http://drejtesia.shqiptare.com>
10. <https://studioligjore.wordpress.com/>
11. <http://njohligjin.al/>
12. www.humanrights.coe.int

